



Suedi
Sverige



UNITED NATIONS
ALBANIA



RAPORT MONITORIMI

**ZBATIMI I LEGJISLACIONIT PENAL DHE PROCEDURAL PENAL NË GJYKIMIN E
VEPRAVE PENALE TË DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE
NGA GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË, FIER, DURRËS, ELBASAN,
BERAT, SHKODËR DHE VLORË**

(Periudha e monitorimit Tetor 2023- Prill 2025)

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

Tiranë 2025

Ky raport është realizuar në kuadrin e zbatimit të projektit “*Promovimi i një sistemi drejtësie në Shqipëri, të përgjegjshëm, të ndjeshëm gjinor dhe efektiv përmes monitorimit sistematik të sistemit gjyqësor dhe litigimit strategjik të çështjeve të dhunës me bazë gjinore*”, zbatuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në bashkëpunim me UN Women Albania në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “**T’i japim fund dhunës ndaj Grave**” i financuar nga Qeveria e Suedisë dhe zbatuar nga tre agjencitë e UN, UN Women, UNDP dhe UNFPA.

Mohimi i përgjegjesisë:

Analiza, opinionet dhe rekomandimet e shprehura në raport janë qëndrime të autorëve dhe nuk përfaqësojnë detyrimisht qëndrimin zyrtar të QNL-së apo të tre agjencive të UN, UN Women, UNDP dhe UNFPA.

© Të gjitha të drejtat e botimit janë të rezervuara për Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare. Asnjë pjesë nuk mund të riprodhohet pa citimin e tij.

Përgatiti raportin:

Av. Lirie Dina

Përgatiti skedën e monitorimit: Dr.Sander Simoni

Monitorues: Lime Skuka, Nadia Guni, Erisilda Shpata, Soela Kurti, Blerta Nurja, Malvina Aliaj, Arvenola Dore, Mimoza Qinami.

Përpunoi të dhënat e monitorimit: Av.Iris Aliaj.

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL)

Adresë: Rr. ‘Vaso Pasha’, P. 12, Shk. 1, Ap. 2, Tiranë, Shqipëri.

Web: www.qag-al.org

E-mail: avokatore2@yahoo.com

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTIMEVE	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
METODOLOGJIA E RAPORTIT	9
KUFIZIMET METODOLOGJIKE TË MONITORIMIT	11
KREU I - IDENTIFIKIMI I ÇËSHTJES	12
1.1 VEPRAT PENALE PËR TË CILËN AKUZOHEM I PANDEHURI NGA PROKURORIA	12
1.2 VLERËSIMI I NDRYSHIMEVE NDËRMJET KËRKESËS SË PROKURORIT PËR GJYKIM DHE VENDIMIT TË GJYQTARIT TË SEANCËS PARAPRAKE NË LIDHJE ME CILËSIMIN JURIDIK.....	15
1.3 RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË VIKTIMËS GJATË HETIMEVE PARAPRAKE DHE NË SEANCË PARAPRAKE	15
1.4 USHTRIMI I PADISË CIVILE NË PROCESIN PENAL	16
KREU II - ELEMENTË TË ÇËSHTJES E TË GJYKIMIT.....	17
2.1 PROCEDURA E GJYKIMIT TË ÇËSHTJEVE PENALE	17
2.1.1 Lloji i procedurës së gjyimit	17
2.1.2 Forma e zhvillimit të gjyimit.....	17
2.2 TË DHËNAT STATISTIKORE PËR NUMRIN E SEANCAVE QË KA ZGJATUR PROCESI GJYQËSOR	18
2.2.1 Sa seanca gjyqësore zgjati procesi gjyqësor?	18
2.2.2 Numri i seancave gjyqësore të monitoruara për çështje	19
2.3 PRANIA E MEDIAS DHE PUBLIKUT NË SALLË	19
KREU III - SUBJEKTET NE GJYKIM.....	19
3.1 NJOFTIMI I VIKTIMËS PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT	19
3.2 PRANIA E VIKTIMËS GJATË SHQYRTIMIT GJYQËSOR PENAL	20
3.3 MBROJTJA LIGJORE E VIKTIMËS NË PROCEDURAT PENALE.....	21
3.4 PROFILI VIKTIMËS.....	22
3.5 PËRFITIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE NGA VIKTIMAT E VEPRËS PENALE	22
3.6 PRANIA NË GJYKIM E TË PANDEHURIT DHE MASAT E SIGURIMIT	24
3.7 SUBJEKTET PREZENTE NË GJYKIM	25
IV. GJYKIMI.....	25
4.1 RESPEKTIMI I GARANCIVE PROCEDURALE PËR VIKTIMËN GJATË GJYKIMIT PENAL	25
4.2 RESPEKTIMI I GARANCIVE PROCEDURALE GJATË PYETJES SË VIKTIMËS	26
4.3 A ISHTE VIKTIMA GJATË GJYKIMIT NËN MASA MBROJTËSE?	27
4.4 VLERËSIMI I PËRSHTATSHMËRISË SË MASAVE MBROJTËSE	28
4.5 FORMA TË DHUNËS TË IDENTIFIKUARA GJATË GJYKIMIT PENAL.....	29
4.6 MARRËDHËNIA NDËRMJET VIKTIMËS DHE AUTORIT TË DHUNËS.....	30
4.7 PROFILI I TË PANDEHURVE	31
a)Gjinia e të pandehurve.....	32
b) Gjendja civile e të pandehurve	32
c) Gjendja gjyqësore e të pandehurve	32
d) Shtetësia e të pandehurve	33
e) Arsimi i të pandehurve	33
f) Mosha e të pandehurve.....	34
g) Profili profesional dhe statusi ekonomik i të pandehurve	34
4.8 ANALIZË MBI LLOJET E PROVAVE TË ADMINISTRUARA GJATË GJYKIMIT	35
4.9 NDRYSHIMI I QËNDRIMIT TË VIKTIMËS GJATË PROCESIT GJYQËSOR	36

V. VENDIMI I GJYKATËS	38
5.1 VENDIMMARRJA E GJYKATËS	38
<i>a) Konfirmimi i akuzës së prokurorisë në vendimarrjet e gjykatës.....</i>	<i>39</i>
<i>b) Lloji dënimit në rastet e deklarimit fajtor të të pandehurit</i>	<i>40</i>
<i>c) Alternativat e dënimit me burgim</i>	<i>40</i>
5.2 ARSYETIMI I RRETHANAVE TË VEPRËS PENALE DHE RRETHANAVE RËNDUESE TË PARASHIKUARA NË NENIN 50 KP	42
5.3 USHTRIMI I TË DREJTËS SË ANKIMIT NDAJ VENDIMIT TË GJYKATËS	42
5.4 NDIKIMI I HARTËS SË RE GJYQËSORE NË QASJEN E VIKTIMAVE TË DHF DHE DHBGJ NË DREJTËSI EFEKTIVE	43
VI. PROCESI I RREGULLT	44
6.1 VLERËSIMI I RESPEKTIMIT TË AFATEVE PROCEDURALE GJATË PROCESIT GJYQËSOR.....	44
<i>a) Respektimi i afatit për caktimin e seancës gjyqësore brenda 10 ditëve nga ardhja e çështjes për gjykim</i>	<i>44</i>
<i>b) Njoftimi palëve për datën e seancës gjyqësore të paktën 10 ditë para datës së caktuar për gjykim</i>	<i>45</i>
<i>c) Afati maksimal 15 ditor i ndërprerjes së seancës, shtyrjes së saj për arsye të veçanta</i>	<i>45</i>
<i>d) Afati maksimal procedural 1 vjeçar për përfundimin e gjykimit të çështjes i përcaktuar si afat i arsyeshëm.....</i>	<i>45</i>
<i>e) Marrja e vendimit menjëherë pas tërheqjes në dhomën e këshillimit nga gjykata dhe shpallja e tij në mënyrë të përmbledhur</i>	<i>46</i>
<i>f) Depozitimi vendimit të arsyetuar brenda 30 ditëve</i>	<i>46</i>
6.2 SHKAQET E SHTYRJES SË SEANCAVE GJYQËSORE	49
6.3 KOHËZGJATJA E PROCEDIMEVE GJYQËSORE	50
6.4 PRETENDIME TË PALËVE MBI KOHËN PËR TË PARAQITUR KËRKESA PROCEDURALE	51
6.5 VLERËSIMI I PAANSHMËRISË SË GJYQTARËVE GJATË GJYKIMIT TË ÇËSHTJEVE PENALE.....	52
VII. ETIKA E GJYQTARIT DHE SOLEMNITETI I GJYKIMIT	52
7.1 RESPEKTIMI I ETIKËS GJYQËSORE DHE SOLEMNITETIT NË GJYKIM	52
7.2 RESPEKTIMI I ORARIT TË FILLIMIT TË SEANCËS GJYQËSORE.....	53
7.3 RESPEKTIMI I/E VIKTIMËS DHE AVOKATIT/ES SË TIJ/SAJ NGA GJYQTARI/JA	54
<i>7.3.1 Qëndrimi i gjykatave ndaj viktimave.....</i>	<i>54</i>
<i>7.3.2 Qëndrimi i gjykatave ndaj avokatëve të viktimave</i>	<i>55</i>
7.4 KOHËZGJATJA E SEANCËS GJYQËSORE.....	56
7.5 NJOFTIMI I PËRFUNDIMIT TË PROCESIT GJYQËSOR	56
VIII. REFERIMI NË STANDARDET NDËRKOMBËTARE	57
8.1 REFERIMI I STANDARDEVE DHE AKTEVE NDËRKOMBËTARE NGA PALËT NË GJYKIMIN PENAL	57
8.2 REFERIMI I STANDARDEVE APO AKTEVE NDËRKOMBËTARE NGA GJYKATA NË VENDIMIN PËRFUNDIMTAR	57
IX. REKOMANDIME.....	59
X. BIBLIOGRAFIA	65

LISTA E SHKURTIMEVE

CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DHBGJ	Dhuna me bazë gjinore
DHF	Dhunë në familje
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GjShPJP	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm
GJRGI	Gjykata e Rrethit Gjyqësor
GjAJP	Gjykata e Apelit, Juridiksioni i Përgjithshëm
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KLGJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KP	Kodi Penal
KPrP	Kodi Procedurës Penale
KDPM	Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur
KVKDHF	Koordinatorit Vendor Kundër Dhunës në familje
MD	Ministria e Drejtësisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OJF	Organizata Jofitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OPGJ	Oficer i policisë gjyqësore
PMF	Punonjësi për Mbrojtjen Fëmijëve
PP	Prokuroria e Përgjithshme
QNL	Qendra për Nisma Ligjore Qytetare
UM	Urdhër Mbrojtje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje
UMPMM	Urdhri për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme
IEVP	Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
UPR	Procesi i rishikimit Periodik

Dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore vazhdojnë të përbëjnë një problematikë serioze dhe të përhapur në shoqërinë shqiptare, me pasoja të drejtpërdrejta mbi jetën, sigurinë dhe mirëqenien e viktimave. Pavarësisht zhvillimeve ligjore dhe përpjekjeve institucionale për përmirësimin e reagimit ndaj këtij fenomeni, gjetjet e raportit tregojnë se sistemi i drejtësisë përballet ende me sfida të konsiderueshme në zbatimin efektiv të të drejtave të viktimave dhe në sigurimin e mbrojtjes së plotë. Roli i drejtësisë penale është thelbësor jo vetëm për ndëshkimin e autorëve, por edhe për parandalimin, edukimin dhe mbrojtjen e viktimave, ndërkohë që pengesat aktuale kufizojnë një përgjigje të plotë dhe të ndjeshme ndaj nevojave të tyre.

Ky raport prezanton një analizë të trajtimit gjyqësor të rasteve të DHF dhe DHBGJ në Shqipëri, duke u fokusuar në zbatimin e të drejtave të viktimave gjatë gjykimit penal. Struktura e raportit është ndarë në 8 kapituj, trajton cilësimet juridike, mbrojtjen ligjore falas, shërbimet mbështetëse, respektimin e të drejtave procedurale, vendimmarrjen gjyqësore, profilin e të pandehurve, format e dhunës, marrëdhëniet viktimë–dhunues dhe mënyrën e zhvillimit të gjykimit.

Dhuna në familje vijon të paraqitet si një fenomen me bazë kryesisht gjinore, ku ushtrimi nga ana e burrave përbën një tipar të theksuar të rasteve të denoncuar dhe të ndjekura penalisht. Dhuna ndodh më së shumti në marrëdhënie martesore ose partnerësh bashkëjetues. Megjithatë, nuk përjashtohen format e dhunës në marrëdhënie të mëparshme apo të ndërprera (siç është rasti i personave të divorcuar), gjë që kërkon një vëmendje të shtuar të autoriteteve në lidhje me dhunën post-divorc apo dhunën gjatë periudhës së ndarjes së një marrëdhënieje intime.

Analiza e akuzave tregon se neni 130/a KP (dhuna në familje) përbën mbi 80% të çështjeve të hasura nga grupi i veprave objekt monitorimi, shpesh në kombinim me nenet 321 KP (*veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës*) dhe 278 KP (*mbajtje pa leje të armëve*), duke sinjalizuar një rrezikshmëri të lartë dhe tendencë për përshkallëzim të dhunës. Përqindjet e larta të dhunës së përsëritur dhe shkeljeve të urdhrave të mbrojtjes nënvizojnë efektivitetin e kufizuar të masave mbrojtëse të aplikuara dhe nevojën për forcim të zbatueshmërisë së vendimeve gjyqësore dhe angazhim ndërinstitutional për mbrojtjen e viktimave.

Monitorimi i realizuar në 7 gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm evidentoi aspekte pozitive dhe përparime në ndërgjegjësimin institucional për ndërtimin e një sistemi më të ndjeshëm gjinor. Gjykatat janë përpjekur të respektojnë garancitë procedurale të viktimave, ku viktimat janë mbështetur nga avokatë, psikologë ose punonjës socialë, dhe janë pyetur në distancë apo në seanca me dyer të mbyllura, sipas neneve 58, 58/a dhe 58/b të KPrP. Megjithatë, mungesa e praktikave të unifikuara në njoftimin e viktimave për të drejtat e tyre dhe dokumentimin e këtij procesi krijon pasiguri ligjore dhe kufizon pjesëmarrjen aktive në proces. Në disa gjykata njoftimet e të drejtave bëhen me shkrim dhe dokumentohen, ndërsa në të tjera kryhen pjesërisht ose verbalisht, pa procesverbal. Në disa raste, viktimat nuk informohen për gjendjen e procedimit dhe nuk njihen me aktet e dosjes hetimore. Një shqetësim i përsëritur është edhe mos njoftimi për lirin e autorit të dhunës, duke i ekspozuar viktimat ndaj rrezikut të rikthimit të dhunës.

Monitorimi evidenton se përfaqësimi ligjor i viktimave është jashtëzakonisht shumë i ulët. Përqindja e ulët e aplikimeve për ndihmë ligjore falas tregon një hendek midis së drejtës ligjore të garantuar dhe aksesit real në këtë shërbim. Kjo situatë mund të lidhet me mungesën e informacionit ose mosfunksionim të referimit institucional. Kjo gjetje nënvizon rëndësinë e informimit dhe orientimit të viktimave drejt skemës së ndihmës ligjore falas nga ana e gjykatave dhe prokurorive.

Dhuna psikologjike në proceset penale shpesh nuk vlerësohet me ekspert psikolog, duke çuar në nënvlerësimin e pasojave emocionale tek viktimat dhe përcaktimin jo proporcional të masës së dënimit. Ndërsa mungesa e praktikës për ngritjen e padisë civile në procesin penal kufizon

ushtrimin e së drejtës për kompensim të dëmit material dhe jomaterial. Masat mbrojtëse, megjithëse shpesh efektive, në rreth 5.8% të rasteve nuk kanë qenë të mjaftueshme, duke ekspozuar viktimat ndaj rrezikut, sidomos kur dhunuesit kanë histori dhune të përsëritur, probleme të shëndetit mendor ose varësi ndaj alkoolit apo substancave narkotike. Shkeljet e urdhrave të mbrojtjes evidentojnë nevojën për monitorim më rigoroz të zbatimit dhe ndëshkim të moszbatimit të vendimeve gjyqësore për lëshimin e UMM/UM.

Monitorimi ka zbuluar mangësi në respektimin e afateve procedurale. Janë konstatuar vonesa të përsëritura në fillimin e seancave ku palët presin në salla të mbipopulluara për një kohë të pacaktuar (*nga 6 min deri në 2 orë*), pa asnjë informacion zyrtar mbi statusin e seancës (*p.sh., seancat janë me vonesë, shtyrë ose kur mungon gjyqtari çështjes*). Ka ndodhur që palët kanë vijuar të presin në gjykatë për zhvillimin e seancës gjyqësore, ndërkohë që seanca ishte shtyrë për mungesë të gjyqtarit, pa qenë në dijeni të këtij fakti. Pavarësisht përpjekjeve të gjykatave për të menaxhuar kalendarët gjyqësorë dhe burimet e kufizuara, vonesat mbeten një dukuri e shpeshtë që ndikojnë negativisht në përvojën e përdoruesve të drejtësisë. Ka disa faktorët që kanë afektuar drejtpërdrejt në ecurinë e proceseve gjyqësore dhe rrjedhimisht në mos respektimin e afateve procedurale: *ngarkesa e lartë e punës, mungesa e burimeve të mjaftueshme njerëzore, transferimet dhe efektet e procesit të rivlerësimit kalimtar*. Si pasojë, zvarritja e proceseve cenon jo vetëm efikasitetin e drejtësisë, por edhe besimin e viktimave tek institucionet. Vështirësitë në kontaktimin e viktimës përmes adresave të pasakta kanë rezultuar në vonesa në procesin gjyqësor, duke treguar nevojën për përmirësim të sistemit të adresave.

Një shqetësim i veçantë lidhet me kushtet fizike të sallave të gjykimit, ku mungesa e hapësirave adekuate ka krijuar situata që cenojnë sigurinë dhe lirinë e shprehjes së viktimave gjatë dëshmisë, pasi ato qëndrojnë shumë afër të pandehurve. Numri i sallave nuk përmbush nevojat e gjykatave ndaj shpesh seancat zhvillohen në zyrat e gjyqtarëve, duke kërkuar domosdoshmërisht përmirësimin e infrastrukturës dhe respektimin e standardeve të sigurisë dhe dinjitetit në procesin gjyqësor.

Gjetjet tregojnë se mungesa e informimit dhe koordinimit ndërinstitutional ka kufizuar qasjen e viktimave në shërbime thelbësore mbështetëse, duke evidentuar nevojën për forcimin e bashkëpunimit mes gjykatave, prokurorive, njërive të mbrojtjes sociale dhe organizatave joqeveritare. Krijimi i një liste me kontaktet e pikave fokale të strukturave që ofrojnë shërbime mbështetëse për viktimat do të ndihmonte në përmirësimin e bashkëpunimit dhe do të lehtësonte referimin e rasteve në mënyrë të shpejtë, të koordinuar dhe efektive. Një rrjet funksional referimi dhe mbështetjeje është thelbësor për siguri fizike, rikuperim emocional dhe integrim social të viktimave.

Është vënë re se një pjesë e konsiderueshme e viktimave ndryshon qëndrimin gjatë procesit gjyqësor duke paraqitur kërkesa: për pushim të çështjes, dënime më të lehta, deklarata për falje dhe normalizim të marrëdhënieve, minimizim të aktit të dhunës. Ky ndryshim buron nga një ndërthurje faktorësh socialë, ekonomikë dhe emocionalë, përfshirë varësinë ekonomike, lidhjet familjare, presionin e mjedisit dhe dëshirën për ruajtjen e kohezionit familjar. Ky fenomen kërkon një trajtim të kujdesshëm që të balancojë ndjeshmërinë ndaj rrethanave familjare me nevojën për ndëshkim të drejtë dhe proporcional të veprimeve dhunuese.

Gjetjet nënvizojnë se zbatimi i hartës së re gjyqësore ka rritur distancat gjeografike dhe kostot për viktimat e DHF dhe DHBGJ, duke vështirësuar ndjekjen e vazhdueshme të proceseve gjyqësore dhe duke çuar në mos-raportimin të dhunës ose heqjen dorë nga ndjekja penale për arsye ekonomike dhe sociale. Ky realitet prek veçanërisht gratë larg zonave urbane edhe larg selive të gjykatave, duke thelluar pabarazinë në aksesin në drejtësi. Ndaj kërkohet një vlerësim i ndikimit të hartës së re gjyqësore në aksesin e grupeve vulnerabël në sistemin e drejtësisë dhe masa komplementare për të garantuar akses të barabartë, të shpejtë dhe efektiv.

Gjetjet e monitorimit nxjerrin në pah nevojën për forcimin e koordinimit ndërinstitucional, zbatimin efektiv të urdhrave të mbrojtjes dhe mbështetjen e plotë të DHF dhe DHBGJ. Rekomandohet përmirësimi i funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit dhe emërimi i Koordinatorëve Vendorë kundër Dhunës në Familje në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe zhvillimi i programeve rehabilituese për dhunuesit, për të garantuar mbrojtje, parandalim dhe trajtim gjithëpërfshirës të rasteve. Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet gjykatave, prokurorive, policisë dhe strukturave sociale mbetet kyç për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe reagimin efektiv ndaj rasteve me rrezik të lartë.

Garantimi i të drejtave të viktimës kërkon informim të plotë dhe të qartë të të drejtave procedurale gjatë gjithë procedurës penale, përfshirë njohjen me aktet e dosjes, njoftimin për lirim të pandehurit dhe aksesin në mbrojtje ligjore falas. Rekomandohet unifikimi i praktikave gjyqësore për njoftimin e të drejtave viktimës, forcimi i mekanizmave të mbikëqyrjes së skemës së ndihmës juridike falas. Përveç kësaj, zgjerimi i gamës dhe shtrirja gjeografike e shërbimeve mbështetëse për viktimat, si dhe krijimi i një liste të përditësuar të pikave fokale të strukturave që ofrojnë shërbime mbështetëse për viktimat dhe për autorët e dhunës është i domosdoshëm për të rritur aksesin e viktimave dhe për të siguruar një trajtim gjithëpërfshirës.

Përmirësimi i infrastrukturës gjyqësore, digjitalizimi i shërbimeve dhe respektimi i afateve procedurale janë të domosdoshme për rritjen e efikasitetit të gjykatave. Trajnimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve mbi standardet kombëtare dhe ndërkombëtare është i nevojshëm për vendimmarrje të drejtë dhe argumentim juridik sa më të mirë. Veçanërisht duhet adresuar ndikimi i hartës së re gjyqësore mbi aksesin e viktimave nga zonat larg selive të gjykatave dhe barrierat gjuhësore për komunitetet vulnerabël, duke siguruar akses të barabartë dhe gjithëpërfshirës në drejtësi.

Në përfundim, raporti evidenton përparime të dukshme në respektimin e të drejtave të viktimave, por ende mbeten boshllëqe që kërkojnë vëmendje të vazhdueshme për tu adresuar në praktikë. Qëllimi është të kontribuojë në përmirësimin e reagimit institucional ndaj DHF dhe DHBGJ, duke forcuar kapacitetet dhe ndjeshmërinë gjinore të aktorëve ligjorë, dhe duke garantuar një sistem drejtësie të barabartë, të ndjeshëm dhe efektiv për të gjitha viktimat.

METODOLOGJIA E RAPORTIT

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, në kuadër të projektit “*Promovimi i një sistemi drejtësie në Shqipëri të përgjegjshëm, të ndjeshëm gjinor dhe efektiv përmes monitorimit sistematik të sistemit gjyqësor dhe litigimit strategjik të çështjeve të dhunës me bazë gjinore*”, ka ndërmarrë një proces monitorimi pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, Fier, Durrës, Elbasan, Berat, Shkodër dhe Vlorë. Ky projekt zhvillohet në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “*T’i japim fund dhunës ndaj Grave*”, i financuar nga Qeveria e Suedisë dhe zbatuar nga tre agjencitë e UN, UN Women, UNDP dhe UNFPA.

Ky monitorim synon të vlerësojë zbatimin e legjislacionit penal material dhe procedural penal në gjykimin e veprave penale që lidhen me dhunën në familje dhe dhunës me bazë gjinore në 7 (shtatë) gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të përzgjedhura për këtë nismë. Për arritjen e këtij synimi është përdorur metoda e monitorimit të seancave gjyqësore pranë GjShPJP duke vëzhguar drejtpërdrejtë proceset gjyqësore në këto gjykata, si dhe analizimi i disa vendimeve gjyqësore, në rastet kur ka qenë e mundur aksesimi i tyre. Fokusi i monitorimit ka qenë monitorimi i çështjeve gjyqësore penale ku gjykohen veprat penale si: dhuna në familje e parashikuar në nenin 130/a KP; dhuna seksuale e parashikuar në nenet 100 – 108/a KP; si dhe përndjekja e parashikuar në nenin 120/a KP. Objektivat kryesorë të monitorimit konsistojnë në vlerësimin e aksesit në drejtësi për viktimat e veprave penale që lidhen me DHF dhe DHBGJ; identifikimi i boshllëqeve në zbatimin e të drejtave procedurale të viktimës në procesin penal me qëllim promovimin e një sistemi drejtësie të drejtë, të ndjeshëm në aspektin gjinor, të përgjegjshëm dhe efektiv; identifikimi e promovimi i praktikave gjyqësore pozitive dhe efektive të zbatuara nga gjykata të veçanta; nxjerrja e rekomandimeve të mbështetura në gjetjet faktike për forcimin e mekanizmave mbrojtës dhe përmirësimin e zbatimit të legjislacionit kundër DHF e DHBGJ në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në funksion të këtij qëllimi, QNL i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor me kërkesë për akses në monitorimin e seancave gjyqësore pranë 7 gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, dhomave penale, sipas objektit të projektit. Në përgjigje të kësaj kërkesë, KLGJ ka njoftuar gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm mbi projektin që po zbatohet nga QNL dhe iu është kërkuar krijimi i aksesit dhe lehtësive për monitoruesit e autorizuar nga QNL pranë secilës nga gjykatat. Bashkëpunimi i ngushtë dhe konstruktiv me KLGJ-në, kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët ka qenë një faktor shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e procesit të monitorimit.

Monitorimi është realizuar në bazë të një skede monitorimi të përpiluar nga z. Sandër Simoni, Gjyqtar pranë Gjykatës së Lartë. Skeda përbëhet nga 64 pyetje dhe është e organizuar në 8 rubrika: (i) *identifikimi i çështjes*; (ii) *elementë të çështjes e të gjykimit*; (iii) *subjektet në gjykim*; (iv) *gjykimi*; (v) *vendimi i gjykatës*; (vi) *procesi i rregullt*; (vii) *etika e gjyqtarit dhe solemniteti i gjykimit*; (viii) *referimi në standardet ndërkombëtare*.

Skeda e monitorimit është hartuar në mënyrë që të sigurojë një qasje të kombinuar duke përfshirë të dhëna juridike dhe sociale, me qëllim evidentimin e elementeve kyç që lidhen me trajtimin e viktimave, respektimin e të drejtave të tyre procedurale, praninë në gjykim, aksesin në mbrojtje ligjore falas dhe shërbime mbështetëse, marrëdhënien me të pandehurin, provat e administruara dhe vendimmarrjen gjyqësore. Gjithashtu, janë analizuar vendime gjyqësore aty ku është bërë i mundur aksesimi i tyre, me synim thellimin e kuptimit mbi arsyetimin juridik të gjykatave në çështjet e dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore.

Për realizimin e këtij monitorimi janë angazhuar si monitoruese juriste dhe avokate me përvojë në fushën e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së viktimave të dhunës, pjesë e QNL dhe të organizatave partnere të shoqërisë civile, anëtare të rrjetit të monitorimit kundër dhunës me bazë gjinore. Roli dhe kontributi i këtyre profesionisteve ka qenë thelbësor në sigurimin e një procesi

monitorimi të besueshëm dhe me standarde të larta etike e metodologjike. Monitorueset e caktuara pranë gjykatave janë organizuar si më poshtë:

GjShPJP	Monitoruese	Pozicioni	Organizata
Tiranë	Lirie Dina Lime Skuka Nadia Guni	Avokate Juriste Juriste	Qendra për Nisma Ligjore Qytetare
Fier	Arvenola Dore	Avokate	Dhoma Vendore e Avokatisë Fier
Durrës	Erisilda Shpata	Avokate	Shoqata “Gender, Page e Siguri”
Elbasan	Soela Kurti	Avokate	“Forumi i Gruas Elbasan”
Berat	Mimoza Qinami	Avokate	“Mbrotjtje e të drejtave të grave urbane e rurale – Berat” (MDG)
Shkodër	Blerta Nurja	Avokate	“Gruaja tek Gruaja” Shkodër
Vlorë	Malvina Mejdiaj	Avokate	Qendra Psiko-Sociale “Vatra”

Të gjitha monitorueset janë trajnuar paraprakisht mbi metodologjinë dhe instrumentet e monitorimit. Gjatë monitorimit ato kanë qenë të pranishme në sallat e gjykimit ku kanë mbledhur të dhënat bazuar në informacionin e marrë gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, çështjeve të biseduara nga palët në deklaratimet/kërkesat/prendimet e palëve, veprimet procedurale të ndërmarra nga gjykata, si dhe dinamikën e gjykimit. Prania e tyre në sallat e gjykimit është bërë në përputhje të plotë me rregulloret dhe autorizimet përkatëse, dhe mbledhja e të dhënave është kryer në mënyrë diskrete e profesionale, duke respektuar integritetin e procesit dhe palëve të përfshira.

Gjatë periudhës dyvjeçare të monitorimit (*tetor 2023 – prill 2025*) janë monitoruar gjithsej 327 çështje penale të shpërndara si në tabelën më poshtë:

Numri i çështjeve të monitoruara							
	GjShPJP Tiranë	GjShPJP Durrës	GjShPJP Vlorë	GjShPJP Fier	GjShPJP Berat	GjShPJP Elbasan	GjShPJP Shkodër
Nr. çështjeve sipas gjykatave	94	46	43	42	38	36	28
Numri Total i çështjeve	327 çështje penale						

Për secilën nga çështjet mund të jenë monitoruar një ose disa seanca gjyqësore. Në total, gjatë kësaj periudhe dyvjeçare janë monitoruar 509 seanca gjyqësore, të shpërndara sipas gjykatave si në tabelën më poshtë:

Numri i seancave të monitoruara							
	GjShPJP Tiranë	GjShPJP Durrës	GjShPJP Vlorë	GjShPJP Fier	GjShPJP Berat	GjShPJP Elbasan	GjShPJP Shkodër
Nr. seancave sipas gjykatave	114	51	72	72	73	51	76
Numri Total i seancave	509 seanca						

Nga totali i seancave të planifikuara për t’u monitoruar në GjShPJP Durrës dhe GjShPJP Elbasan, për shkak të pamundësive objektive për t’u zhvilluar në këto gjykata, përkatësisht 21 dhe 20 seanca janë zhvilluar në GjShPJP Tiranë.

Të dhënat e mbledhura nga të gjitha skedat e monitorimit të plotësuar nga monitorueset janë hedhur në një databazë të dhënash sipas qyteteve nga Av. Iris Aliaj. Më tej të dhënat janë përpunuar dhe analizuar për shkrimin e raportit. Në fillim të muajit qershor 2025, QNL ka

organizuar një tryezë konsultative me përfaqësues të institucioneve të drejtësisë (KLGJ, KLP, MD, Avokati Popullit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit), organizatave të shoqërisë civile, gjyqtarëve, avokatëve, OPGJ, punonjës social, gazetarëve dhe përfaqësuesve të UN Women, me qëllim validimin e gjetjeve paraprake dhe diskutimin mbi rekomandimet.

Ky raport synon të shërbejë si një instrument profesional për të nxitur reflektim dhe përmirësim të vazhdueshëm të sistemit të drejtësisë penale në trajtimin e rasteve të DHF dhe DHBGJ, në përputhje me detyrimet kushtetuese dhe ndërkombëtare që rrjedhin nga konventat e nënshkruara nga shteti shqiptar. Gjetjet dhe rekomandimet që rrjedhin prej tij janë hartuar me vëmendje të posaçme dhe në frymën e një bashkëpunimi institucional konstruktiv.

KUFIZIMET METODOLOGJIKE TË MONITORIMIT

Përpara prezantimit të gjetjeve të raportit, është me rëndësi të nënvizohet se ky monitorim është zhvilluar nëpërmjet vëzhgimit të drejtpërdrejtë të seancave gjyqësore dhe për këtë arsye përmban disa kufizime metodologjike që duhet të merren parasysh gjatë interpretimit të të dhënave dhe konkluzioneve të raportit.

Duke qenë se monitorimi është bazuar ekskluzivisht në çfarë është shfaqur dhe diskutuar gjatë seancave gjyqësore, të dhënat e mbledhura pasqyrojnë vetëm zhvillimet dhe informacionin e komunikuar brenda këtyre seancave të monitoruara. Si rrjedhojë, çdo informacion që nuk është bërë objekt diskutimi gjatë seancës nuk ka qenë i disponueshëm për monitoruesit dhe për pasojë, nuk është reflektuar në këtë raport.

Gjithashtu, për shkak të natyrës dhe dinamikës së proceseve gjyqësore për disa çështje janë ndjekur një ose disa seanca gjyqësore. Kjo nënkupton që disa elementë të rëndësishëm mund të kenë munguar në seancat e monitoruara, ndërkohë që mund të jenë trajtuar në seanca të mëvonshme të pa monitoruara.

Për ilustrim, në një seancë të monitoruar mund të jetë konstatuar mungesa e mbrojtësit ligjor të viktimës, ndërsa në një seancë tjetër të po të njëjtës çështje, që nuk është ndjekur nga monitoruesit, mund të jetë siguruar mbrojtës ligjor. Po ashtu, prania ose mungesa e viktimës në një seancë nuk mund të interpretohet si e pandryshueshme përgjatë gjithë gjykimit, pasi në seanca të tjera të mëvonshme ajo mund të ketë qenë e pranishme.

Në disa raste, seanca e monitoruar ka përkuar me një fazë të avancuar të procesit gjyqësor, siç është seanca ku paraqiten konkluzionet përfundimtare dhe shpallet vendimi. Për pasojë, të dhënat e përfituara nga këto seanca kanë qenë të kufizuara sa i përket informacionit mbi zhvillimin e mëparshëm të gjykimit të çështjes, veprimet procedurale të ndërmarra gjatë fazave të hershme të shqyrtimit gjyqësor dhe garantimin e të drejtave procedurale të palëve në të gjitha fazat e procesit.

Për këtë arsye, është e rëndësishme të theksohet se përfundimet e raportit janë formuluar mbi bazën e informacionit të mbledhur vetëm nga seancat gjyqësore të monitoruara. Çdo informacion jashtë seancës (*si p.sh. dokumentacioni procedural apo zhvillimet në fazat hetimore*) nuk ka qenë i aksesueshëm për monitoruesit dhe për rrjedhojë nuk përfshihet në analizë. Ky raport nuk përfshin monitorim të fazës së hetimeve paraprake, e cila nuk ka qenë objekt monitorimi, dhe nuk pretendon të japë një pasqyrë të plotë për çdo çështje gjyqësore në tërësinë e saj, por vetëm për as sa ka qenë e mundur të vëzhgohet dhe monitorohet në seancën gjyqësore ku monitoruesja ka qenë prezente.

Në këtë kontekst, çdo interpretim i gjetjeve duhet të bëhet duke marrë në konsideratë këto kufizime metodologjike, dhe duke pasur parasysh që të dhënat e përfshira në këtë raport pasqyrojnë gjendjen e vërejtur në momentin dhe në kuadrin e seancave të monitoruara.

KREU I - IDENTIFIKIMI I ÇËSHTJES

1.1 Vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri nga prokuroria

Gjatë periudhës dyvjeçare të monitorimit sistematik (*tetor 2023 - prill 2025*), mbi bazën e të dhënave të mbledhura nga shtatë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, dhoma penale, është konstatuar se të pandehurit janë akuzuar në disa raste vetëm për një nga veprat penale objekt monitorimi: *Dhunë në familje (neni 130/a)*, *Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur (neni 100)*, *Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç (neni 101)*, *Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura (neni 102)*, *Marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur (neni 102/a)*, *Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur (neni 103)*, *Vepra të turpshme (neni 108)*, *Ngacmimi seksual (neni 108/a)*. Në raste të tjera akuza përbëhet nga kombinime të veprave të ndryshme me veprat objekt monitorimi, që përfshijnë: *Plagosja e rëndë me dashje (neni 88)*, *Shkaktimi i vetëvrasjes (neni 99)*, *Heqja e paligjshme e lirisë (neni 110)*, *Përndjekje (neni 121/a)*, *Fyerja (neni 119)*, *Shpifja (neni 120)*, *Keqtrajtimi i të miturit (neni 124/b)*, *Shkatërrimi i pronës (neni 150)*, *Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin (neni 197)*, *Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik (neni 236)*, *Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit (neni 278)*, *Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive (neni 280)*, *Prodhim dhe shitja e narkotikëve (neni 283)*, *Kanosja për të mos kallëzuar (neni 311)*, *Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit (neni 312)*, *Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës (neni 321)*.

Veprat penale më të shpeshta të hasura gjatë monitorimit

Nga analiza individuale e të gjitha akuzave të ngritura nga prokuroria, *duke i përlllogaritur veprat penale të ndara nga kombinimet e bëra në akuzë*, rezulton se veprat penale për të cilat janë akuzuar më shpesh të pandehurit janë:

(i) Dhuna në familje (neni 130/a KP) përfaqëson **80.15%** të të gjitha çështjeve të monitoruara. Pra, përfaqëson pjesën më të madhe të çështjeve të trajtuara nga gjykata në gamën e veprave penale objekt monitorimi. Kjo përqindje dominuese është tregues i nevojës për ndërhyrje të qëndrueshme me masa parandaluese dhe njëkohësisht të koordinuara institucionalisht në trajtimin e fenomenit, si dhe përmirësim të efektivitetit të mekanizmave ekzistues të mbrojtjes.

(ii) Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës (neni 321 KP) përfaqëson **5.03%** të të gjitha çështjeve të monitoruara. Kjo vepër penale renditet e dyta për nga shpeshtësia e akuzave të dërguara për gjykim nga prokuroria në gjykatë, pas nenit 130/a KP. Neni 321 KP nënkupton vështirësi të vazhdueshme në zbatimin efektiv të vendimeve gjyqësore të formës së prerë që lidhen me lëshimin e UMM dhe UM, duke ngritur shqetësime për efektivitetin e autoritetit gjyqësor e të vendimeve gjyqësore në rastet e shkeljes së UMM dhe UM.

(iii) Përndjekja (neni 121/a KP) përfaqëson **3.02%** të të gjitha çështjeve të monitoruara. Kjo vepër renditet e treta për nga shpeshtësia e akuzave të dërguara për gjykim nga prokuroria në gjykatë. Ndonëse mbetet një vepër penale me përqindje më të ulët krahasuar me veprat të cilat kanë një përhapje më shqetësuese, ajo përbën një formë të dëmshme të dhunës psikologjike ndaj viktimës, shpesh e nënvlerësuar, që meriton vëmendje më të madhe institucionale, si në aspektin e parandalimit, ashtu edhe në ndërhyrjen e hershme.


(iv) Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur (neni 100 KP) përfaqëson **1.01%** të të gjitha çështjeve të monitoruara, ndërsa vepra të tjera me natyrë të ngjashme, ndonëse në përqindje të ulëta, mbartin rrezikshmëri të lartë dhe ndikim të thellë mbi të drejtat e viktimave.

Dominimi i veprës penale të DHF dëshmon për një sfidë të vazhdueshme në parandalimin e DHF dhe mbrojtjes efektive të viktimave. Ekziston një tendencë e përsëritjes së veprave penale

nga të njëjtët autorë në disa raste, gjë që sugjeron një mungesë të efektivitetit të masave parandaluese në këto raste (*si urdhrat e mbrojtjes apo dënimet alternative*). Ushtrimi i dhunës pas lëshimit të UMM/UM nga gjykata, paralajmëron një risk të lartë të përsëritjes së dhunës, pasi UMM/UM nuk ka ndikuar për të frenuar autorin. Kjo kërkon rishikim të efektivitetit të instrumenteve të parandalimit të DHF dhe mbrojtjes së viktimave me mekanizma më të fuqishëm të zbatimit të urdhrave të mbrojtjes.

Pavarësisht përqindjes së ulët, veprat penale ndaj të miturve dhe personave të pambrojtur ose të natyrës seksuale kërkojnë vëmendje të veçantë dhe përgjigje të specializuara. Vepra të tilla përbëjnë raste që kërkojnë një qasje të diferencuar, të cilat mund të sinjalizojë nën raportim apo vështirësi në evidentim dhe apo sfida në ndjekjen penale të këtyre rasteve. Referuar Statistikave të INSTAT¹ për Krimet dhe Drejtësinë Penale për vitin 2024, konstatohet se krimet seksuale kanë shënuar një rritje krahasuar me vitin 2023. Kjo rritje tregon një sfidë serioze për sistemin ligjor dhe institucionet përkatëse në parandalim, duke kërkuar mekanizma më të fuqishëm përkrahje për viktimat dhe masa preventive të konkretizuara.

Aplikimi i dispozitave të nenit 130/a të KP



Nga analiza e të gjithë akuzave të ngritura nga prokuroria, duke i përlllogaritur sipas kombinimeve të veprave penale me dispozitat e nenit 130/a KP, bazuar në grafikun e mësipërm vërehet se:

(i) Neni 130/a/1 KP, i kombinuar ose jo me vepra të tjera penale (*që përfshin dhunë fizike/psikologjike ndaj familjarëve*) rezulton të jetë neni më i aplikuar, në total me **45.38%** të të gjitha çështjeve të monitoruara. Pas tij, më të përhapura janë:

(ii) Neni 130/a/4 KP, i kombinuar ose jo me vepra të tjera penale (*që përfshin kryerjen e dhunës në rrethana të posaçme, si përsëritje ose prani të fëmijëve*) përbën në total **36.71%** të të gjitha çështjeve të monitoruara. Kjo përqindje e lartë sinjalizon për një gravitet më të lartë të situatës dhe për nevojën e një qasje më të thelluar mbi cilësinë e ndërhyrjes dhe mbështetjes ndaj viktimave në rastet komplekse.

¹ <https://www.instat.gov.al/media/qdhdhy452/press-release-krimet-2025.pdf>

(iii) **Neni 130/a/3 KP**, i kombinuar ose jo me vepra të tjera penale (*që lidhet me veprat e shoqëruara me plagosje me dashje*) përbën në total **6.65%** të të gjitha çështjeve të monitoruara.

(iv) **Neni 130/a/2 KP**, i kombinuar ose jo me vepra të tjera penale (*që lidhet me rastet e kanosjeve serioze*) përbën në total **4.34%** të të gjitha çështjeve të monitoruara.

Këto të dhëna dëshmojnë për një përhapje të dukshme të dhunës së përsëritur dhe natyrës së rënduar brenda në ambientin familjar dhe theksojnë nevojën për politika më të targetuara në parandalimin e rasteve.

Kombinime të shpeshta të nenit 130/a me vepra të tjera penale

Nga analiza e të gjithë akuzave të ngritura nga prokuroria, duke i përlogaritur sipas kombinimeve të veprave penale të dërguara për gjykim në gjykatë, neni 130/a KP është shoqëruar me vepra penale të ndryshme, që përfshijnë: nenin 101 KP, 124/b KP, 150 KP, 197 KP, 236 KP, 278 KP, 280 KP, 283 KP, 311 KP, 312 KP ose nenin 321 KP. Neni 130/a KP shoqërohet më shpesh me këto vepra penale:

(i) **Neni 321 (Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës)** është i pranishëm përkrah nenit 130/a KP në **44.4%** të të gjitha çështjeve të monitoruara. Kjo nënkupton shkeljen e vendimeve gjyqësore civile të lëshimit të UMM/UM. Prania e përsëritur e nenit 321 KP në kombinim me nenin 130/a KP sugjeron: një mospërfillje të urdhrave të mbrojtjes e të autoritetit gjyqësor; një risk të lartë të përsëritjes së dhunës, pasi UM/UMM nuk ka ndikuar për të frenuar autorin. Për rrjedhojë lind nevoja për masa më të forta ndëshkuese, mbrojtëse ose sigurimi, si arrest me burg, arrest shtëpie, apo largim të menjëhershëm të dhunuesit nga viktimat. Për sa kohë që masat mbrojtëse të ndërmarra në referim të nenit 10 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 "*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*", të ndryshuar, kanë pasur një ndikim të dobët në ndalimin e DHF sugjerohet përzgjedhja e masave më të forta të parashikuara në këtë nen. Ky është një tregues se ka vend për forcimin e zbatueshmërisë së vendimeve dhe monitorim më strikt të zbatimit të vendimeve nga ana e autoriteteve përgjegjëse.

(ii) **Neni 278 (Mbajtja pa leje e armëve)** është i pranishëm përkrah nenit 130/a KP në **13.9%** të të gjitha çështjeve të monitoruara. Prania e njëkohshme e këtyre dy veprave penale në akuzë ngre çështje me rëndësi të posaçme në lidhje me rrezikshmërinë penale të të pandehurve dhe sigurinë e viktimave të DHF. Në veçanti, posedimi i paligjshëm i armëve nga një i dyshuar për dhunë në ambientet familjare përforcon ndjeshëm potencialin për shkallëzim të dhunës në forma të rënda dhe të parikuperueshme; përbën një rrezik të shtuar për jetën dhe shëndetin e viktimave, veçanërisht në kontekstet kur ekziston histori e dhunës së përsëritur apo shkelje të masave mbrojtëse; dhe kërkon një qasje më të ndjeshme nga autoritetet gjyqësore dhe strukturat mbështetëse, në trajtimin dhe vlerësimin e rrezikut në këto raste.

Edhe pse përqindja prej 13.9% mund të interpretohet si numerikisht modeste në pamje të parë, duhet theksuar se në kontekstin e dhunës në familje, ky tregues paraqet një rrezik alarmues për sigurinë individuale dhe publike. Kombinimi i dhunës me posedimin e paligjshëm të armëve nënkupton një nivel të lartë të rrezikshmërisë për veprime të dhunshme ekstreme, që mund të rezultojnë në pasoja të pakthyeshme për viktimat dhe anëtarët e tjerë të familjes. Për pasojë, ky është një indikator që meriton vëmendje të shtuar, jo vetëm në fazën e ndjekjes penale, por sidomos në vlerësimin e rrezikut gjatë fazës gjyqësore; vendimmarrjen mbi masat e sigurisë personale; dhe zbatimin e masave mbrojtëse.

(iii) **Neni 150 (Shkatërrimi i pronës)** është i pranishëm përkrah nenit 130/a KP në **13.9%** të të gjitha çështjeve të monitoruara.

Këto kombinime sinjalizojnë për një rrezikshmëri të shtuar, tendencë të përshkallëzimit të dhunës, si dhe ndikimin e kufizuar të ndërhyrjeve parandaluese ekzistuese. Kjo situatë reflekton nevojën për vlerësim të thelluar të riskut. Në përfundim, të dhënat e mësipërme nënvizojnë

rëndësinë e trajtimit të DHF si një çështje që kërkon angazhim të qëndrueshëm, ndërdisiplinor dhe institucional, për të garantuar sigurinë e viktimave dhe për të ndërtuar një sistem drejtësie më efektiv dhe më të ndjeshëm.

1.2 Vlerësimi i ndryshimeve ndërmjet kërkesës së prokurorit për gjykim dhe vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake në lidhje me cilësimin juridik

Neni 332/d i KPrP parashikon rastet në të cilat gjyqtari i seancës paraprake mund të konstatojë nevojën për saktësim ose ndryshim të akuzës. Nga analiza e të dhënave del se në 3.47% të çështjeve të monitoruara në të shtatë gjykatat e shkallës së parë është konstatuar ndryshim në cilësimin juridik nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake, në përputhje me nenin 332/d të KPrP, si:

- Gjykata nuk ka pranuar kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes por ka vendosur kthimin e çështjes për rihetim, duke orientuar prokurorinë të formulojë akuzën sipas nenit 130/a/1 KP apo 124/b KP.
- Gjykata ka ftuar prokurorin të saktësojë cilësimin juridik, duke e rikualifikuar atë nga neni 130/a/4 në 130/a/1 KP, apo e kundërta. Ose nga 130/a/1 në 130/a/2, për shkak se dhuna ishte shoqëruar me veprime të rënda kërcënuese, si përdorimi i thikës.
- Gjykata ka kërkuar përfshirjen në akuzë edhe të veprës penale “*Shkatërrimi i pronës*” (neni 150 KP) bazuar në rrethanat konkrete të çështjes.
- Është ndryshuar cilësimi juridik nga “*Kanosje*” në “*Dhunë në familje*”.

1.3 Respektimi i të drejtave të viktimës gjatë hetimeve paraprake dhe në seancë paraprake

Ky nënkaptull i është dedikuar respektimit të të drejtave të viktimës në fazën e hetimeve paraprake dhe në seancën paraprake (bazuar në nenet 58, 58/a dhe 58/b KPrP. Viktima e një vepre penale gëzon një sërë të drejtash procedurale që synojnë garantimin e mbrojtjes ligjore, informimit të plotë dhe përfshirjes së saj aktive në procesin penal.

Nga informacionet e marra nga viktimat e veprave penale rezulton se në 9.23% të rasteve nuk janë garantuar të drejtat viktimës gjatë hetimeve paraprake. P.sh. në Vlorë janë ngritur pretendime se ka pasur raste që viktimës nuk i është njoftuar letra e të drejtave nga ana e prokurorit, nuk janë informuar mbi gjendjen dhe ecurinë e procedimit, si dhe nuk kanë mundur të njihen me aktet e provat e dosjes hetimore, mos njoftimin për lirin nga burgu të dhunuesit. Në GjShPJP Tiranë në një rast nuk rezultoi të jetë bërë një vlerësim psikologjik i viktimës së mitur nga prokuroria gjatë fazës së hetimeve paraprake. Gjithashtu, viktima dhe avokatja e saj nuk ishin njohur me aktet e fashikullit hetimor. Për shkak se faza e hetimeve paraprake nuk ka qenë objekt monitorimi, nuk disponohen të dhëna të konstatuara nga vetë monitoruesit, ndaj konkluzioni i mësipërm bazohet vetëm në rrëfimet e viktimave.

Duke qenë se nuk janë monitoruar të gjitha çështjet në seancën paraprake, është e vështirë të nxjerrim konkluzione të plota lidhur me pretendimet që mund të ketë paraqitur viktimat në këtë fazë për mos respektim të të drejtave. Megjithatë mund të ndajmë disa shembuj:

Në GjShPJP Fier në 2 raste viktimat kanë qenë të moshës së mitur dhe atyre nuk iu është caktuar një avokat kryesisht nga gjykata. Ndërsa në rastet kur viktimat nuk kanë pasur mbrojtje ligjore, nuk janë orientuar nga gjykata drejt përfitimit të ndihmës ligjore falas të garantuar nga shteti. Në GjShPJP Tiranë nuk rezultoi të jetë bërë një vlerësim psikologjik i viktimës së mitur. Në GjShPJP Vlorë – pretendim për mos njoftim të letrës së të drejtave. Ndërkohë një numër i lartë i viktimave nuk kanë paraqitur pretendime lidhur me mosrespektimin e të drejtave. Mungesa e pretendimeve mund të jetë pasojë e mungesës së informimit mbi të drejtat procedurale ose viktima nuk ka qenë prezent në gjykim.

Sa i përket njoftimit të të drejtave të viktimës së veprës penale nga organi procedues gjatë fazës së gjykimit, konstatohet se praktikat e ndjekura në gjykatat e monitoruara janë të

ndryshme. Referuar nenit 58, paragrafi 2 të KPrP, organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre.

Në GjShPJP Durrës dhe Elbasan është vërejtur se, në të gjitha rastet, bashkëlidhur me fletë-thirrjen, viktimës i dërgohet edhe letra e të drejtave, duke përmbushur në këtë mënyrë kërkesat ligjore për informimin e saj në kohë të përshtatshme. [Praktikë pozitive]

Në GjShPJP Shkodër viktimës i bëhet komunikimi me shkrim i të drejtave në fillim të seancës gjyqësore. Ky komunikim dokumentohet përmes një procesverbali që nënshkruhet nga vetë viktimja, si dëshmi e marrjes dijeni mbi përmbajtjen e të drejtave. [Praktikë pozitive]

Në GjShPJP Tiranë kjo praktikë nuk është e konsoliduar, ajo aplikohet në mënyrë sporadike nga një numër i kufizuar gjyqtarësh dhe nuk përfaqëson një standard të përgjithshëm institucional. Në pjesën më të madhe të rasteve, në këtë gjykatë, informimi i viktimës për të drejtat e saj bëhet vetëm në mënyrë verbale në fillim të seancës gjyqësore, pa u dokumentuar përmes ndonjë procesverbali apo formulari për njoftimin e tyre, të firmosur nga vetë viktimja.

Në Gjykatat e Fierit, Beratit dhe Vlorës, letra e të drejtave nuk komunikohet nga gjykata, me arsyetimin se kjo detyrë konsiderohet e përmbushur nga prokuroria gjatë fazës së hetimeve paraprake. Në këto gjykata informimi i viktimës mbi të drejtat e saj në procesin penal bëhet vetëm në mënyrë verbale në fillim të seancës.

Kështu, mungon një praktikë e unifikuar e dokumentuar për njoftimin e viktimës për të drejtat e saj në të gjitha gjykatat e monitoruara, siç parashikohet në nenin 58, paragrafi 2 të KPrP. Kjo mospërputhje në praktikat gjyqësore në njoftimin e të drejtave krijonë pasiguri dhe vështirësi në garantimin e të drejtave e garancive procedurale të viktimës. Si pasojë, pozita procedurale e viktimës mbetet e dobësuar: mungesa e informacionit ligjor kufizon pjesëmarrjen në proces dhe ndikon negativisht në ushtrimin efektiv të të drejtave të garantuara me ligj. Kjo situatë kërkon standardizimi e informimit të viktimës për të drejtat e saj procedurale, si një parakusht thelbësor për garantimin e një procesi të drejtë dhe gjithëpërfshirës.

Sa i përket njoftimit për lirimin e dhunuesit, në kundërshtim me nenin 58, paragrafi 1, germa “e” të KPrP, rezulton se viktimja e veprës penale nuk njoftohet në çdo rast për lirimin e të dhunuesit. Viktimja ndodh që përballat rastësisht në rrugë me dhunuesin pas lirimit nga burgu, ose ritakohet me të vetëm kur ai mbërrin në shtëpinë e përbashkët pas daljes nga burgu. Ky problem del në të gjitha qytetet e monitoruara, duke ngritur shqetësimin për ekspozimin e viktimës ndaj rrezikut të dhunës potenciale.

Sa i përket informimit të viktimës mbi ecurinë dhe rezultatin e hetimeve paraprake, sipas nenit 58 KPrP, viktimja e një veprë penale ka të drejtë të njoftohet për ecurinë/gjendjen e procedimit dhe përfundimin e hetimeve paraprake. Nga vëzhgimet kuptojmë se në 9.76% të viktimave nuk janë informuar për ecurinë dhe rezultatin e hetimeve paraprake. Prokuroria nuk e ka përmbushur këtë detyrim ligjor për të ofruar informacion në kohë. *Në kundërshtim me nenin 58, paragrafi 1, germa “d” të KPrP, viktimat hasin vështirësi për të marrë informacion mbi gjendjen e procedimit dhe të njihen me aktet e provat e dosjes hetimore nga ana e prokurorisë.*

Gjetjet e këtij seksioni nxjerrin në pah se, megjithëse në shumicën e rasteve të drejtat e viktimës janë respektuar, ka ende boshllëqe në mbrojtjen e tyre efektive gjatë hetimeve paraprake. Një implementim më konsistent i standardeve ligjore dhe i praktikave të mira mbetet i nevojshëm për të garantuar pjesëmarrje të barabartë dhe të informuar të viktimës në procesin penal.

1.4 Ushtrimi i padisë civile në procesin penal

Një prej të drejtave të parashikuara në ligj për viktimat e veprave penale, është mundësia për të kërkuar kompensim të dëmit përmes padisë civile të ngritur brenda procesit penal (neni 58, pika 1, germa “g”; 61; 62 të KPrP). Të dhënat e mbledhura gjatë monitorimit tregojnë se vetëm në një rast në GjShPJP Tiranë është regjistruar ngritja e një padie civile në kuadër të procesit penal,

por nuk ka informacion për objektin e padisë civile dhe vendimmarrjen e gjykatës në lidhje me të. Në këtë rast viktimë ka pasur ndihmën juridike të nevojshme për hartimin e ngritjen e padisë civile. Në të gjitha rastet e tjera, ky mekanizëm ligjor mbetet i papërdorur. Në gjykatën e Fierit, në të paktën katër raste të monitoruara, u evidentua mungesë e qartë e informimit mbi këtë të drejtë.

Mungesë e praktikës për të ngritur padi civile në gjykimin penal reflekton:


- (i) Mungesë informacioni për të drejtën për të kërkuar kompensim në procesin penal;
- (ii) Mos përfaqësimi ligjor për viktimën, e lidhur me vështirësi ekonomike dhe pamundësisë për të marrë ndihmë juridike falas;
- (iii) Mungesa e një praktike të konsoliduar të përdorimit të padisë civile në procesin penal në rastet e DHF dhe DHBGJ, pavarësisht dispozitave ligjore që e lejojnë një gjë të tillë.

Mospërdorimi i këtij mjeti kufizon aksesin efektiv të viktimës në drejtësi, veçanërisht në raport me të drejtën për kompensim të dëmit jomaterial dhe material të pësuar si rezultat i dhunës.

KREU II - ELEMENTË TË ÇËSHTJES E TË GJYKIMIT

2.1 Procedura e gjyimit të çështjeve penale

2.1.1 Lloji i procedurës së gjyimit



Gjatë monitorimit të gjykimeve penale është konstatuar se forma më e përdorur e procedurës së gjyimit ka qenë gjykimi i shkurtuar², i parashikuar nga nenet 403 e vijues të KPrP, i cili është aplikuar në 66.97% të rasteve. Gjykimi i zakonshëm, i bazuar në nenet 333 dhe 339 e vijues të KPrP, është ndjekur në 24.16% të rasteve. Forma të tjera, si gjykimi me marrëveshje për pranim fajësie (1.22%), gjykimi i drejtpërdrejtë (0.61%) dhe urdhri penal (0.30%), rezultojnë të jenë përdorur në më pak raste. Për pjesën tjetër të çështjeve nuk ka informacion mbi procedurat e gjyimit të zhvilluar. Kjo shpërndarje pasqyron përhapjen e praktikës së gjyimit të shkurtuar.

2.1.2 Forma e zhvillimit të gjyimit

Lidhur me formën e zhvillimit të gjyimit, në 69.73% të rasteve të monitoruara gjykimet janë zhvilluar me dyer të hapura, konform nenit 339 të KPrP. Ndërkohë, në 25.22% të rasteve u aplikua gjykimi me dyer të mbyllura, në përputhje me nenin 340 të KPrP, praktikë kjo që kryesisht

² Gjykimi i shkurtuar është një gjykim i posaçëm ku i pandehuri kërkon që gjykata të gjykojë çështjen në gjendjen që janë aktet dhe të marrë vendim vetëm duke u bazuar në dokumentet dhe provat që janë mbledhur gjatë hetimit, pa zhvilluar një gjykim të plotë me dëshmitarë, ekspertë dhe prova të reja. Me këtë zgjedhje, i pandehuri heq dorë nga disa të drejta që do të kishte në një proces të zakonshëm (p.sh. të thërrasë dëshmitarë, të kërkojë prova të reja ose ekspertime). Në këmbim, nëse shpallet fajtor, gjykata i jep një dënim më të ulët se zakonisht (ulet me 1/3). Ky lloj gjykimi zgjat më pak në kohë krahasuar me gjykimin e zakonshëm.

aplikohet në rastet ku cenohen të dhënat personale të viktimave, veçanërisht kur viktimat janë të mitur ose në rrethana të tjera të ndjeshme.




Pezullimet apo ndërprerjet e procedurave rezultojnë të kenë qenë tepër të kufizuara sipas të dhënave të mbledhura. Përdorimi i shpeshtë i procedurave të gjykimit me dyer të mbyllura për raste sensitive tregon që gjykata është e ndjeshme e kujdesshme për të garantuar mbrojtjen e integritetit të viktimës dhe shmangien e ekspozimit të panevojshëm në ambiente publike.

2.2 Të dhënat statistikore për numrin e seancave që ka zgjatur procesi gjyqësor

2.2.1 Sa seanca gjyqësore zgjati procesi gjyqësor?

Monitorimi evidentoi numrin e seancave të realizuara për secilën çështje penale të përfshirë në monitorim. Ky tregues reflekton kohën e trajtimit gjyqësor të çështjeve penale që përfshijnë viktima të DHF dhe DHBGJ. Megjithatë, vlerësimi i kohëzgjatjes duhet të lexohet me kujdes, duke marrë parasysh se çdo çështje ka specifikat e saj procedurale e faktike, si dhe kompleksitetin e saj.

Nga 327 çështje të raportuara në total, shumica janë përmbyllur brenda 1 ose 2 seancave gjyqësore, ndërsa një pjesë ka vijuar me më shumë seanca, deri në 24 seanca në një rast të veçantë.



Konkretisht 24.16% e çështjeve janë trajtuar brenda një seance; 36.09% e çështjeve brenda 2- 4 seancave.

Në disa gjykata proceset gjyqësore janë karakterizuar nga një efikasitet i dukshëm procedural. Kështu, në GjShPJP Vlorë, Tiranë, Elbasan, Durrës dhe Berat, shumica e çështjeve të monitoruara janë përmbyllur brenda 1-2 seanca gjyqësore. Kjo praktikë është pozitive dhe sugjeron respektimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Meriton të theksohet kjo gjetje për ndikimin që mund të ketë në ruajtjen e stabilitetit emocional dhe psikologjik të viktimave, si dhe për shmangien e vonësive të panevojshme procedurale. [Praktikë pozitive]


Rreth 14.37% të çështjeve u trajtuan brenda 5-10 seanca, ndërsa 3.36% kanë zgjatur më shumë se 10 seanca, duke treguar nevojën për vlerësim të arsyeve të zgjatjes së procedurave. Nëpërmjet këtij raporti është e vështirë të nxjerrim konkluzione në lidhje me seancat e shumëta që kanë sjellë një kohëzgjatje relativisht të gjatë të gjykimit për shkak se janë të rralla rastet ku mund të jenë monitoruar të gjitha seancat që ka zgjatur ajo çështje.

Në 22.02% të çështjeve mungon informacion për numrin e seancave të zhvilluara për shkak të mos ndjekjes së gjykimit në të gjitha seancat gjyqësore deri në fund. Kohëzgjatja e këtyre proceseve gjyqësore përbën një tregues të rëndësishëm të efikasitetit institucional, ku praktikat

pozitive janë të vlerësuara, ndërsa rastet e zgjatura kërkojnë analizë dhe ndërhyrje për përmirësim, në funksion të garantimit të një drejtësie efektive dhe të aksesueshme për viktimat.

2.2.2 Numri i seancave gjyqësore të monitoruara për çështje

Ky seksion paraqet frekuencën e ndjekjes së një çështjeje, ku për secilën mund të jenë monitoruar një ose disa seanca gjyqësore.



Në një përqindje të konsiderueshme të çështjeve të monitoruara (mbi 62.38%), u ndoq vetëm një seancë gjyqësore. Në 22.63% të çështjeve janë ndjekur 2 seanca për të njëjtën çështje gjyqësore. Në 8.87% të çështjeve janë ndjekur 3-4 seanca për të njëjtën çështje gjyqësore; në raste sporadike që përbëjnë 2.14% të çështjeve janë ndjekur mbi 5 ose më shumë seanca për të njëjtën çështje gjyqësore. Në një numër të kufizuar çështjesh (3.98%), nuk ka qenë e mundur të identifikohet qartësisht se sa seanca janë ndjekur nga monitoruesit.

2.3 Prania e medias dhe publikut në sallë

Gjatë monitorimit të seancave gjyqësore u vu re se prania e medias dhe publikut në sallën e gjykatës ishte e kufizuar. Në 1.22% të rasteve u konstatua prani e medias ose publikut, ndërkohë që në 98.78% të seancave nuk ishte i pranishëm asnjë përfaqësues i medias apo publiku.



Konkretisht, prania e medias dhe publikut u regjistrua në GjShPJP Elbasan (2 raste), Fier (1 rast) dhe Berat (1 rast).

KREU III - SUBJEKTET NE GJYKIM

3.1 Njoftimi i viktimës për zhvillimin e gjykimit



Në kuadër të vlerësimit të respektimit të të drejtave procedurale të viktimës në procesin penal, një nga aspektet kyçe të monitorimit ka qenë verifikimi i njoftimit të saj për datën e gjykimit,

në përputhje me nenin 137 KPrP. Të dhënat e mbledhura tregojnë se në 93.4% të rasteve gjykatat kanë realizuar njoftimin e viktimës. Në 2.37% të rasteve viktimë nuk ka marrë dijeni për datën e seancës, ndërsa në 4.22% të rasteve nuk mund të përcaktohej për shkak të mungesës së të dhënave.


Jo në pak raste hasen vështirësi për të kontaktuar viktimën në adresën e deklaruar në aktet procedurale. Fletëthirrjet e dërguara nga gjykata rezultojnë me shënime të tilla si *“i/e larguar”*, *“nuk gjendet”*, apo *“adresë e pasaktë”*, duke pamundësuar marrjen e dijenisë për datën e seancës. Kjo situatë shkakton vonesa në procesin gjyqësor deri në sigurimin e një njoftimi efektiv. Adresat jo të përditësuara krijojnë pengesa në procesin e njoftimit, por edhe eklipsojnë të drejtën e viktimës për tu informuar dhe marrë pjesë në gjykim.

Në disa raste të veçanta, për shkak të pamundësisë për të kontaktuar viktimën, është aplikuar shpallja publike. Nga ana tjetër, vërehen edhe raste kur viktimë është njoftuar në mënyrë të rregullt, por nuk është paraqitur në seancën gjyqësore me vullnetin e saj të lirë. Kjo mungesë prezence nuk duhet interpretuar si mungesë interesi, por më tepër si një vendimmarrje për të shmangur përjetime emocionale të rënda dhe rikthimin e traumës së shkaktuar nga ngjarjet e dhunshme. Ky qëndrim pasiv shpesh përbën një mekanizëm vetëmbrojtës nga ana e viktimës, i cili duhet kuptuar dhe trajtuar me ndjeshmëri nga organet procedurale.

Në përfundim, mospjesëmarrja e viktimës në procesin gjyqësor ndikohet nga faktorë të shumtë: mungesë informacioni nëse prezenca e saj në gjykim është e detyrueshme apo jo, paqartësi mbi të drejtat procedurale, distancim për shkak të përjetimeve emocionale, frikë ose pasiguri personale, si dhe vështirësi në lokalizim për shkak të pasaktësisë së adresave. Këto gjetje nënvizojnë nevojën për përmirësimin e sistemit të adresave.

3.2 Prania e viktimës gjatë shqyrtimit gjyqësor penal

Gjatë monitorimit të çështjeve gjyqësore penale të shqyrtuara nga gjykatat është analizuar edhe prania e viktimës në seancat gjyqësore. Të dhënat tregojnë se në 50.66% të rasteve viktimë nuk ka qenë e pranishme në gjykim, ndërkohë që në 44.59% të çështjeve është konstatuar prania e saj. Në 4.75% të rasteve nuk kishte informacion për këtë aspekt.



Në disa prej çështjeve është vërejtur se viktimë ka qenë e pranishme vetëm në një ose dy seanca, dhe jo përgjatë gjithë procesit gjyqësor. Në raste të tjera, pjesëmarrja e saj është kufizuar vetëm në seancat e para apo përfundimtare, çka mund të ketë ndikuar në ushtrimin efektiv të të drejtave të saj gjatë procesit penal.

Përfaqësimi i viktimës në rastet e mos prezencës së saj gjatë gjyqimit

Një element i rëndësishëm është niveli i përfaqësimit të saj në rastet kur ajo nuk ka qenë e pranishme fizikisht në seancë. Të dhënat tregojnë se vetëm në 18.2% të rasteve kur viktimë nuk ka qenë e pranishme në gjykim ajo është përfaqësuar me një mbrojtësi ligjor. Në gjykatën e Durrësit, është evidentuar se gjykata nuk ka informuar për të drejtën e viktimës për të marrë pjesë në procesin gjyqësor vetë apo përmes një mbrojtësi. Mos informimi mund të ndikojë negativisht në vendimmarrjen e viktimës për të qenë aktive në proces.

3.3 Mbrojtja ligjore e viktimës në procedurat penale


Aplikimi i skemës së ndihmës ligjore falas për viktimat

Megjithëse legjislacioni në fuqi, përfshirë ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, parashikon të drejtën e viktimave të krimit për të përfituar mbrojtje ligjore falas, vetëm 4.22% e viktimave kanë paraqitur kërkesa për të përfituar ndihmë ligjore falas (nga të cilat, 5 aplikime – në GjShPJP Vlorë, 1 - GjShPJP Elbasan, 8 - GjShPJP Durrës, 2 - GjShPJP Shkodër). Në një rast në GjShPJP Vlorë viktimat fillimisht ka kërkuar ndihmë ligjore falas por më pas është tërhequr nga kërkesa. Ndërsa në 85.75% të rasteve nuk është bërë asnjë aplikim i tillë. Në 10.03% të viktimave nuk ka të dhëna nëse kanë aplikuar për të përfituar ndihmën ligjore falas.

Gjatë monitorimit në GjShPJP Durrës u evidentua një rast në të cilin viktimat akuzuese ishte e pa përfaqësuar nga një mbrojtës ligjor. Edhe pse ajo deklaroi se nuk kishte mundësi financiare për të angazhuar një avokat, gjykata, në mënyrë të përsëritur, i kërkoi që të paraqitej me mbrojtës në seancën pasardhëse. Megjithatë, viktimat nuk u orientua nga gjykata për të aplikuar për mbrojtës ligjor falas. Ky qëndrim është hasur dhe në raste të tjera, duke cenuar të drejtën e viktimës për akses efektiv në drejtësi dhe mbrojtje të barabartë në procesin penal.

Përqindja e ulët e aplikimeve për ndihmë juridike falas tregon një hendek midis së drejtës ligjore të garantuar dhe aksesit real në këtë shërbim. Kjo situatë mund të lidhet me mungesën e informacionit, vështirësitë në procesin e aplikimit, ose mosfunksionim të referimit institucional.

Mbrojtja ligjore e viktimës



Gjatë këtij monitorimi është vërejtur se një përqindje shumë e ulët e viktimave janë përfaqësuar me avokat gjatë procesit gjyqësor. Vetëm 10.03% e viktimave kanë zgjedhur të kenë përfaqësim përmes një avokati privat, ndërkohë që në 6.6% të rasteve mbrojtja ligjore është ofruar përmes një avokati të caktuar kryesisht nga gjykata. Më tej, vetëm 0.53% e viktimave kanë përfituar mbrojtje përmes skemës së ndihmës juridike falas të garantuar nga shteti, dhe në një përqindje po ashtu të ulët (1.06%) mbrojtja është ofruar nga përfaqësues të shoqërisë civile.

Ndërsa 76.52% e viktimave nuk kanë qenë të përfaqësuar me asnjë formë mbrojtjeje ligjore. Në 5.28% të rasteve mungonin të dhënat për ekzistencën e përfaqësimit ligjor.

Monitorimi ka treguar se mbrojtja juridike e të miturve, në raste sporadike, nuk garantohet në mënyrë sistematike. Në GjShPJP Fier nuk u caktua mbrojtës kryesisht për viktimat e mitura (11 dhe 13 vjeç), si dhe mungonte përfaqësuesi nga NJMF. Gjykata kishte lejuar që përfaqësimi të bëhej vetëm nga nëna e tyre. Kjo praktikë nuk zëvendëson rolin e mbrojtësit ligjor, i cili, sipas kërkesave të nenit 58 KPrP, Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe KDPM, duhet të jetë një avokat i specializuar në mbrojtjen e të miturve. Mungesa e përfaqësimit profesional në këto raste përbën një cenim të të drejtave procedurale të të miturit në sistemin e drejtësisë.


Në një rast të veçantë në gjykatën e Fierit, u identifikua se viktimat (nënë dhe bijë) ishin persona me probleme të shëndetit mendor. Gjatë seancës së monitoruar, përveç pranisë së tyre, në sallë u konstatua edhe prania e një avokati mbrojtës të caktuar nga gjykata. [Praktikë pozitive]

Bazuar në gjetjet e mësipërme, sugjerojmë forcimin e mekanizmave të informimit, referimit dhe caktimit të mbrojtjes ligjore falas për viktimat, si dhe garantimi i një mbrojtje efektive, veçanërisht në rastet që përfshijnë të mitur. Kjo do të kontribuonte jo vetëm në përmirësimin e aksesit në drejtësi për viktimat, por edhe në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga parimet e drejtësisë së ndjeshme dhe mbrojtjes gjithëpërfshirëse të viktimës në procesin penal. Të dhënat e më sipërme duhen interpretuar me kujdes, për shkak se mbrojtja ligjore mund të jetë siguruar në seanca të radhës, që nuk janë monitoruar.

Në analizën statistikore të përgatitur nga DNJF, mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti për periudhën janar - qershor 2025³, rezultoi se gjatë kësaj periudhe kanë përfituar ndihmë juridike dytësore gjithsej 84 viktima të DHF. Ndërkohë, për këtë periudhë nuk rezultoi të ketë përfitues nga kategoritë e viktimave të abuzimit seksual, trafikimit të qenieve njerëzore apo të miturve. Të dhënat e raportuara aktualisht identifikojnë në mënyrë të përgjithshme vetëm kategorinë e përfituesit, pa saktësuar natyrën e çështjes për të cilën është ofruar ndihma juridike dytësore. Kështu, mbetet e paqartë nëse ndihma është ofruar për përfaqësim në procese gjyqësore civile të lidhura me lëshimin e UM/UMM apo në procese penale të lidhura drejtpërdrejt me DHF dhe DHBGJ. Këto të dhëna statistikore të DNJF mund të orientojnë se ndihma ligjore falas mund të jetë përfituar për çështje të tjera të së drejtës familjare, si zgjidhja e martesës, detyrimi ushqimor apo kujdestaria mbi fëmijët. Për rrjedhojë, nuk është e mundur të vlerësohet në mënyrë të saktë se sa viktima të DHF janë përfaqësuar realisht dhe në mënyrë të garantuar me avokat në një proces penal që ka për objekt DHF apo DHBGJ.

3.4 Profili viktimës

Nga 379 viktima të identifikuar në total në çështjet e monitoruara, 3 prej tyre ishin të diagnostikuara me çrregullime të shëndetit mendor. Ndërkohë, për 20 raste të tjera, mungonte informacioni për të bërë një vlerësim të saktë në lidhje me këtë aspekt.



Nga analiza e të dhënave të mbledhura, rezultoi se në 8.71% të çështjeve të monitoruara viktimat ishin të mitur. Këto raste janë shpërndarë në disa gjykata, me një përqendrim më të lartë në GjShPJP Fier dhe Elbasan. Në 84.96% të çështjeve, viktimat ishin persona madhorë, ndërsa për 6.33% të rasteve nuk mund të identifikohet moshë e saktë të viktimës.


Vihet re se dhuna ushqehet kryesisht brenda rrethit të ngushtë familjar, në shumicën e rasteve ajo manifestohet në formën e ushtrimit të dhunës nga bashkëshorti ndaj bashkëshortes, ish-bashkëshorti ndaj ish-bashkëshortes, bashkëjetuesi ndaj bashkëjetueses, më tej prind-fëmijë ose e kundërta, ndaj gjyshërve apo ndaj nipërve e mbesave.

3.5 Përfitimi i shërbimeve mbështetëse nga viktimat e veprës penale

Legjislacioni shqiptar parashikon një sërë të drejtash për viktimat e DHF dhe DHBGJ, të cilat synojnë sigurimin e një mbrojtjeje të plotë përmes mekanizmave të ndihmës psikologjike, mjekësore, sociale dhe ligjore. Sipas nenit 58 të KPrP, ligjit nr. 18/2017 *“Për të drejtat dhe*

³ <https://ndihmajuridike.gov.al/ep-content/uploads/2025/07/06.-Analiza-Statistikore-Qershor-2025.pdf>

mbrojtjen e fëmijëve”, KDPM, si dhe ligjit për ndihmën juridike falas, viktimat kanë të drejtë të informohen dhe të përfitojnë nga shërbime mbështetëse të ofruara nga shteti ose organizata jofitimprurëse. Ky kuadër synon jo vetëm trajtimin e menjëhershëm të pasojave të dhunës, por edhe suportin për rikuperim të qëndrueshëm.



Të dhënat e mbledhura nga monitorimi demonstrojnë se në 57% të rasteve nuk u deklarua asnjë masë ndihmëse në favor të viktimave të DHF dhe DHBGJ. Megjithatë, ky rezultat duhet interpretuar me kujdes, pasi mos referimi i masave mbështetëse në seancat gjyqësore nuk nënkupton domosdoshmërisht që viktimat nuk kanë përfituar shërbime të tilla. Është e mundur që viktimat të kenë marrë shërbime mbështetëse, por nuk janë deklaruar në seancën e monitoruar.

Në rreth 43 % të rasteve është evidentuar se viktimat kanë përfituar një ose më shumë forma mbështetjeje, përfshirë: *kujdes mjekësor (12.5%)*, *ndihmë psikologjike (11.16%)*, *këshillim (8.48%)*, *shërbimet nga autoritetet shtetërore (2.01%)* dhe *OJF-të (8.26%)*. Në 0.22% të rasteve nuk është i qartë shërbimi i përfituar. Në GjShPJP Fier, në një rast viktimës i është ofruar ndihmë psiko-sociale nga NJMF, por nga hezitimi i familjarëve e viktimës, kjo ndihmë nuk është pranuar.


Gjithsesi, në një pjesë të konsiderueshme të çështjeve, mos informimi nga prokuroria e gjykata dhe mos koordinimi ndërinstitucional ka ndikuar negativisht në qasjen e viktimave në shërbime thelbësore si ndihma psikologjike, mbrojtja ligjore, këshillimi etj.,

Në vijim të diskutimeve të zhvilluara gjatë tryezës së përbashkët të organizuar nga QNL, me pjesëmarrjen e ekspertëve të fushës, përfaqësuesve të sistemit gjyqësor, institucioneve publike dhe OJF-ve, u evidentua një shqetësim i rëndësishëm i ngritur nga gjyqtarja e GjShPJP Tiranë, e cila lidhet me mungesën e një liste zyrtare të përditësuar me kontakte të institucioneve që ofrojnë shërbime mbështetëse për viktimat e DHF dhe DHBGJ. Sipas gjyqtarës, një listë e tillë do të shërbente si një mjet orientues, jo vetëm për referimin e rasteve nga ana e gjykatës në drejtim të strukturave përkatëse mbështetëse, por do të ndihmonte gjithashtu që vetë viktimat të informoheshin qartë dhe në mënyrë të strukturuar se ku mund të drejtoheshin për të marrë ndihmën e nevojshme, sipas nevojave të tyre specifike – qoftë në aspektin psiko-social, ligjor apo të strehimit emergjent etj.,. Kjo listë do të duhej të përmbante kontaktete e pikave fokale të secilit institucion, duke përfshirë gjykatat, prokuroritë, polici, NJVV, KVKDHF, NJMF, OJF-të, si dhe çdo strukturë të angazhuara në fushën e mbrojtjes së viktimave. Një dokument i tillë, nëse do të shpërndahej tek organet proceduese, sidomos prokurorët e gjyqtarët që trajtojnë çështje të DHF e DHBGJ, do të kishte lehtësonte ndjeshëm bashkëpunimin ndërinstitucional dhe rrjedhimisht, edhe qasjen e viktimave në mbështetje të shpejtë, gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar.

Në përmbyllje, qasja ndaj viktimës duhet të orientohet drejt krijimit të një rrjeti funksional mbështetjeje, referimi e monitorimi, që garanton jo vetëm siguri fizike, por edhe rikuperim emocional dhe integritet social. Kjo kërkon përkushtim të vazhdueshëm institucional dhe


bashkëpunim ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë në sistemin e drejtësisë penale dhe mbrojtjes sociale. Në këtë kuadër, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 parashikon një sërë objektivash që mbështesin këtë qasje, duke përfshirë forcimin e ndëshkueshmërisë dhe rehabilitimin e dhunuesve, zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat, etj. Strategjia përmban një qasje gjithëpërfshirëse, në harmoni me rekomandimet e këtij raporti, duke synuar përmirësim të legjislacionit, zbatimit të tij në praktikë, forcimit të shërbimeve mbështetëse dhe zbatimit të programeve rehabilituese për dhunuesit.

3.6 Prania në gjykim e të pandehurit dhe masat e sigurimit



Nga monitorimi shihet se në 82.95% të rasteve i pandehuri ka qenë i pranishëm në sallën e gjykit. Në 12.43% të rasteve ka munguar.


Gjykimi i të pandehurit nën një masë sigurie



Të dhënat e grumbulluara gjatë monitorimit tregojnë se në 66.18% të rasteve i pandehuri është gjykuar duke qenë nën një masë sigurie personale. Në 24.57% të rasteve, gjykimi është zhvilluar pa një masë sigurie të caktuar ndaj të pandehurit. Në 9.25% të rasteve nuk ishte e qartë nëse kishte ose jo një masë sigurimi në fuqi, ose seanca nuk trajtonte drejtpërdrejt këtë pikë.

Masat e sigurimit personal të aplikuara ndaj të pandehurit


Gjatë monitorimit nëpër gjykata u analizua edhe natyra e masave të sigurimit personal të vendosura ndaj të pandehurve në momentin e zhvillimit të gjykit. Në 55.33% të çështjeve të monitoruara – i pandehuri është gjykuar duke qenë nën masën e arrestit në burg, të parashikuar nga neni 238 i KPrP. Masa e arrestit në shtëpi është përdorur në 3.17% të rasteve, ndërsa masa e shtrimit të përkohshëm në spital psikiatrik është vërejtur në 3.46% të çështjeve.



Nga ana tjetër, detyrimi për t'u paraqitur pranë policisë gjyqësore, si një masë më e butë sigurimi e parashikuar në nenin 234 KPrP, është konstatuar në 5.19% të rasteve. Në 0.29% të rasteve është aplikuar masa e ndalimit dhe detyrimit të qëndrimit në një vend të caktuar (neni 235

KPrP), ndërsa nuk janë regjistruar masa sigurimi të tipit ndalim i daljes jashtë shtetit (neni 233 KPrP) apo garanci pasurore (neni 236 KPrP), çka mund të jetë rezultat i rrethanave specifike të çështjeve të trajtuara ose i tipologjisë së të pandehurve përkatës. Për pjesën e mbetur nuk ka qenë në fuqi asnjë masë sigurimi në momentin e zhvillimit të seancës gjyqësore, ose të dhënat për këtë element rezultojnë të pamjaftueshme për të vlerësuar këtë aspekt qartësisht.

3.7 Subjektet prezente në gjykim



Gjatë monitorimit del se prokurori ka qenë i pranishëm në pjesën më të madhe të çështjeve të ndjekura (78.1%). Megjithatë, në disa raste është dalluar mungesa e tij në seanca, çka ka sjellë shtyrje të procesit gjyqësor. Pjesëmarrja e profesionistëve të shërbimeve mbështetëse – si psikologët, punonjësit socialë apo përfaqësuesit e NJMF ka rezultuar e ulët për shkak se ka pasur pak viktimë të mitura. Në vetëm 4.11% të rasteve është konstatuar prania e psikologut ose punonjësit social. Në 2.31% të rasteve ka qenë prezent prindi, ndërsa në 0.77% të rasteve ka qenë prezent kujdestari ligjor i të miturit. Gjithashtu, në 2.57% të rasteve në proces kanë marrë pjesë ekspertë, kryesisht psikiatriko-ligjorë, veçanërisht në çështje ku vlerësimi i gjendjes psikologjike të të pandehurit apo viktimës ishte i nevojshëm për sqarimin e rrethanave të veprës. Prania e dëshmitarëve u konstatua në rreth 7.7% të çështjeve, ndërsa nuk është regjistruar prania e përkthyesve, çka nënkupton se nuk janë hasur raste që kërkonin përfshirjen e tyre.

IV. GJYKIMI

4.1 Respektimi i garancive procedurale për viktimën gjatë gjyimit penal

Në përgjithësi gjykatat janë përpjekur të respektojnë garancitë procedurale për viktimën në rastet kur ka qenë prezent në gjykim: *viktimë u ndihmua nga mbrojtësi ligjor; u asistua nga një psikolog apo punonjës social; u shoqërua nga një person i besuar/familjar në vendin e dëshmitarit; u dëgjua në distancë me mjete audiovizive ose videokonferencë; ishte e pozicionuar në distancë të përshtatshme me të akuzuarin në sallën e gjyimit, i është mundësuar pjesëmarrja aktive në proces duke i dhënë kohën e nevojshme për të shprehur lirshëm.*

Në një numër të kufizuar rastesh (rreth 4.13%) u konstatuan mangësi që mund të përbëjnë cenim të garancive procedurale, *si pozicionimin e papërshtatshëm fizik në sallën e gjyimit, përfaqësimi i viktimës së mitur vetëm nga prindi, mos dhënia e kohës së mjaftueshme për të siguruar prova, mos shoqërimin nga një person i besuar.*

Mungesa e ambienteve të përshtatshme për zhvillimin e seancave gjyqësore përbën një shqetësim të përbashkët. Disa nga sallat e gjyimit janë me hapësirë të vogël që e vështirëson akomodimin e të gjitha palëve të pranishme në gjykim. Shpesh palët janë të vendosura shumë afër njëra-tjetrës, pa respektuar distancën minimale fizike që duhet të garantohet në një sallë gjyqësore, e cila sjell ndjesi pasigurie për viktimën.

Zyrat e gjyqtarëve, ku zhvillohen gjithashtu seanca për shkak të mungesës së sallave, janë tejet të vogla dhe nuk krijojnë kushte dinjitoze. Në këto ambiente, shpesh i pandehuri, viktimë dhe

përfaqësuesit e tyre qëndrojnë ngjitur njëri-tjetrit, duke krijuar një mjedis të papërshtatshëm për zhvillimin e një procesi penal ku duhet të garantohet ndarja dhe pavarësia e palëve. Madje në raste sporadike është vënë re situatë intimidimi jo lehtësisht e dukshëm të viktimës nga ana e të pandehurit, ku viktimë nuk ishte e lirshme/e sinqertë/e sigurt në përgjigjet që i kthente gjykatës për shkak të prezencës njaft të afërt të të pandehurit (*ishin të ulur në karriget ngjitur njëri-tjetrit*).

GjShPJP Fier, në një rast avokati i viktimës kërkoi kohë shtesë për përgatitjen e diskutimeve përfundimtare, por kërkesa nuk u pranua nga gjyqtari. Në një tjetër rast u evidentua mungesa e përfaqësimit me avokat për një viktimë të mitur, ku përfaqësimi nga prindi nuk e zëvendëson detyrimin ligjor për një përfaqësim profesional. Në gjykatën e Vlorës u pretendua se gjykata nuk ka dhënë kohën e nevojshme për sigurimin e provave nga arkiva e gjykatës (*vendime*).

P.sh. në një rast në Tiranë gjykata mori vendim për dënimin me burg të të pandehurit dhe konvertimin e këtij dënimi në shërbim prove. Pas përfundimit të seancës gjyqësore, palët u larguan dhe ndërsa zbrisnin shkallëve të gjykatës i dënuari/bashkëshorti kërcënoi viktimën/bashkëshorten: “*Shërbimin e provës do ta bësh ti!*”. Kjo deklaratë nënkupton se i dënuari e konsideron përgjegjëse viktimën për dënimin e tij penal dhe ka për qëllim ushtrimin e presionit dhe frikësimit të saj. Kjo sjellje vë në diskutim respektimin e kushteve të vendosura për zbatimin e shërbimit të provës, duke rrezikuar integritetin psikologjik dhe sigurinë e viktimës.

Për të garantuar zhvillimin e një procesi gjyqësor të drejtë, të paanshëm dhe në përputhje me standardet e sigurisë dhe dinjitetit për të gjitha palët, rekomandohet që gjykatat të marrin masa për përmirësimin e kushteve fizike në të cilat zhvillohen seancat gjyqësore. Sallat duhet të garantojnë distancë fizike ndërmjet të pandehurit dhe viktimës, veçanërisht në rastet që lidhen me DHF apo krime kundër integritetit fizik e moral. Ndonëse raste të izoluara, duhet shmangur mos respektimi i garancive procedurale.

Shërbimi Provës, policia, KVKDHF duhet të vlerësojnë me kujdes sjelljen e të pandehurit për zbatimin e kushteve të vendosura nga gjykata penale në dënimin alternativ, si dhe respektimin e masave mbrojtëse të urdhëruara nga gjykata civile në UMM/UM. Në rast shkelje të tyre të nisin menjëherë procedurat e parashikuara në ligj.

4.2 Respektimi i garancive procedurale gjatë pyetjes së viktimës

Në përgjithësi gjykatat janë përpjekur të respektojnë garancitë procedurale gjatë pyetjes së viktimës: *u ndihmua nga mbrojtësi ligjor; u asistua nga një psikolog apo punonjës social gjatë pyetjes; u shoqërua nga një person i besuar apo familjar në vendin e dëshmitarit; u pyet në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura pa praninë e publikut; u dëgjua apo pyet në distancë me mjete audiovizive ose videokonferencë; u lejua të refuzojë tu përgjigjet pyetjeve në lidhje me jetën private e cila qartësisht nuk ka lidhje me veprën penale; ishte e pozicionuar në distancë të përshtatshme me të akuzuarin në sallën e gjykimit*.

Gjyqtarët shpesh herë kanë treguar edhe ndjeshmëri njerëzore. Në GjShPJP Tiranë, viktimë e moshuar u pyet me kujdes dhe iu respektua e drejta për të refuzuar dëshminë. Gjykata tregoi fleksibilitet duke i lejuar të qëndrojnë ulur dhe të largohet pas dëshmisë për shkak të moshës dhe gjendjes shëndetësore.

Në GjShPJP Shkodër, në disa seanca viktimë nuk ka qenë e pranishme, megjithatë përfaqësimi i saj ligjor është siguruar nëpërmjet avokatëve të caktuar kryesisht. [Praktikë pozitive]

Në 1.61% të rasteve të monitoruara janë konstatuar situata në të cilat garancitë procedurale nuk janë respektuar gjatë pyetjes së viktimës, të cilat meritojnë përmendje të veçantë:

- Në GjShPJP Fier, një i mitur prezent në momentin e ushtrimit të dhunës ndaj viktimës është pyetur në prani të një psikologeje në ambientet e policisë, por nuk është trajtuar me statusin e viktimës në proces. Referuar nenit 10, pika 3/1, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, gjykata, kryesisht, në UMM/UM, mund të

parashikojë masa mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm kur është ushtruar DHF.

- Mungesa e sallave në të gjitha gjykatat ka sjellë raste të zhvillimit të seancave në zyrat e gjyqtarëve. Kjo ka ndikuar në mos sigurimin e kushteve optimale për pyetjen e viktimës dhe ruajtjen e neutralitetit të mjedisit gjyqësor.
- Në raste të tjera seanca u zhvillua në një sallë shumë të vogël, ku nuk ishte e mundur të ruhej distanca e sigurisë mes palëve.
- Në sallat e gjykimit është evidentuar se viktimat shpesh nuk kanë një vend të dedikuar në sallën e gjyqit, duke qëndruar në zonën e publikut.

Të dhënat tregojnë se në një pjesë të konsiderueshme të rasteve janë marrë masa për të respektuar garancitë procedurale. Megjithatë, ekzistojnë ende boshllëqe që lidhen me mungesën e mjediseve të përshtatshme për salla gjykimi për zhvillimin e seancave të cilat garantojnë distancim midis viktimës dhe dhunuesit. Rekomandohet që institucionet përkatëse të konsiderojnë forcimin e kapaciteteve infrastrukturore të gjykatave për të garantuar kushte dinjitoze për viktimat.

4.3 A ishte viktimja gjatë gjykimit nën masa mbrojtëse?

Mbrojtja e viktimave në kuadër të procedurave gjyqësore rregullohet përmes disa instrumenteve ligjorë: ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*, i ndryshuar; ligji nr. 10 173, datë 22.10.2009 *“Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”*, i ndryshuar; VKM për mbrojtjen e zakonshme të dëshmitarëve në një proces gjyqësor.

Nga të dhënat e mbledhura gjatë monitorimit të seancave gjyqësore rezultojnë se:

- 29.82% e viktimave kanë përfituar masa mbrojtëse në kuadër të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*, i ndryshuar;
- 11.08% kanë përfituar masa mbrojtjeje të zakonshme sipas VKM që siguron mbrojtje për dëshmitarët në një proces gjyqësor;
- Vetëm 0.53% kanë qenë subjekt i masave të veçanta të mbrojtjes sipas ligjit nr. 10 173, datë 22.10.2009 *“Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”*, i ndryshuar;
- Në 23.75% të rasteve, nuk është deklaruar ndonjë masë mbrojtëse për viktimën gjatë zhvillimit të gjykimit. Ky rezultat duhet interpretuar me kujdes, pasi mos referimi i masave mbrojtëse nuk nënkupton që viktimat nuk kanë pasur masa mbrojtëse. Është e mundur që viktimat të kenë marrë UMM/UM, por nuk është deklaruar në seancën e monitoruar.
- Në 34.56% të rasteve, viktimja nuk ka qenë nën ndonjë masë mbrojtjeje;
- Ndërkohë, në vetëm 0.26% të rasteve është deklaruar shprehimisht se viktimja ishte nën mbrojtje, por nuk është e qartë se në bazë të cilit nga ligjet është siguruar mbrojtja.

Nga studimi i masave mbrojtëse të UM që janë përmendur gjatë gjykimeve penale, na del se masat e parashikuara në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*, i ndryshuar, të listuara në nenin 10, më të përdorura nga gjykatat janë:

- Shkronja “a” (*Urdhërohet i padituri që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprë të dhunës në familje ndaj viktimës ose anëtarëve të familjes së saj.*)
- Shkronja “b” (*Urdhërohet i padituri që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë apo komunikojë me viktimën ose anëtarëve të familjes së saj, drejtpërdrejt apo tërthorazi.*)
- Shkronja “ç” (*Urdhërohet padituri që të mos i afrohet viktimës apo anëtarëve të familjes në një distancë të caktuar.*)

Masa më pak të përdorura nga neni 10, por të pranishme në disa vendime gjyqësore, janë:

- Shkronja “c”: Largimi i menjëhershëm i të paditurit nga banesa për një afat të caktuar, pa të drejtë rikthimi pa leje gjykatë.
- Shkronja “d”: Ndalesa për t’iu afruar banesës, vendit të punës/vendeve që frekuenton viktimë.
- Shkronja “ë”: Ndalesa për hyrjen dhe qëndrimin në banesën e përhershme ose të përkohshme të viktimës, pavarësisht pronësisë.
- Shkronja “e”: Kufizimi ose ndalimi i kontakteve me fëmijën; lejohet vetëm nëse nuk dëmton mirëqenien emocionale të tij.
- Shkronja “f”: Shoqërimi i të paditurit nga policia për të marrë sendet personale nga banesa e viktimës.
- Shkronja “k”: Urdhër për institucionet dhe shërbimet sociale që të ofrojnë shërbime mbështetëse për viktimën dhe të monitorojnë zbatimin e urdhrit të mbrojtjes.
- Shkronja “m”: Detyrimi i të paditurit të marrë pjesë në programe rehabilitimi psikosocial ose aftësimi prindëror. *Është parë në mënyrë të kufizuar në UM.*

Masat mbrojtëse “a”, “b” dhe “ç” janë aplikuar në shumicën dërrmuese të urdhrave të mbrojtjes në të gjitha gjykatat e monitoruara dhe konsiderohen masa bazë për garantimin e një mbrojtjeje fillestare dhe urgjente për viktimat e DHF. Megjithatë inkurajojmë përdorim më të gjerë të masave të tjera mbrojtëse në varësi të specifikave të çdo rasti.

4.4 Vlerësimi i përshtatshmërisë së masave mbrojtëse

Në 44.06% të çështjeve, rezulton se masat mbrojtëse të marra nga gjykata ishin në përputhje me nevojat e viktimës së DHF. Në këto raste, masat mbrojtëse kanë kontribuar në krijimin e një mjedisi më të sigurt dhe kanë shmangur përplasjet e mundshme të mëtejshme. Veçanërisht kur ndaj të pandehurit është vënë masë sigurie “*arrest me burg*” ose “*arrest shtëpie*” dhe ku është garantuar distancimi fizik nga viktimë, masat kanë qenë efektive në sigurimin e mbrojtjes fizike dhe psikologjike të tyre.

Megjithatë, në 5.80% të rasteve masat mbrojtëse të marra ose të pa marra nga gjykata nuk ishin në përputhje me nevojat e viktimës së DHF. Janë evidentuar disa situata shqetësuese, ku masat mbrojtëse nuk kanë qenë të mjaftueshme apo nuk janë marrë fare, pavarësisht evidencave për nevojën për mbrojtje më të posaçme dhe të vazhdueshme. Mungesa e masave mbrojtëse adekuate me rrethanat konkrete dhe nivelin e rrezikshmërisë që paraqiste autori i dhunës ekspozon viktimat ndaj rrezikut, veçanërisht kur dhunuesit janë persona me histori të përsëritur dhune, probleme të shëndetit mendor ose varësi të theksuara ndaj alkoolit apo lëndëve narkotike. Këtë e ilustruam me shembujt e mëposhtëm:

GjShPJP Fier, dhunuesi –person me histori të theksuar recidivizmi (*i dënuar tri herë për DHF ndaj të njëjtës viktimë, ish-bashkëshortes së tij, si dhe për shkatërrim prone me zjarr dhe shkelje të UM*) – rezulton gjithashtu me varësia ndaj alkoolit. Edhe pse aktualisht është duke vuajtur dënimin, për viktimën (76 vjeç) kërkohet strehim i sigurt. Rreziku për viktimën mbetet i lartë në momentin e përfundimit të dënimit të autorit dhe, rrjedhimisht, të pushimit të efektit të masave mbrojtëse të urdhrit ekzistues.

Në një rast tjetër, dhunuesi – një person me probleme të shëndetit mendor – ka ushtruar dhunë të përsëritur ndaj nënës së tij, duke shkelur urdhrin e mbrojtjes. Masat mbrojtëse të caktuara (*ndalimi i kontaktit, komunikimit dhe qëndrimin në banesën e përbashkët me një distancë prej 100m, si dhe ndalimi i çdo akti dhune apo kërcënimi ndaj viktimës*) rezultuan të pamjaftueshme për mbrojtjen efektive të saj. Këto masa u vlerësuan të papërshtatshme edhe në një rast të ngjashëm, por që autori nuk banonte në të njëjtën shtëpi me viktimën.

GjShPJP Elbasan, masat mbrojtëse rezultuan të pamjaftueshme për mbrojtjen e viktimës dhe tre fëmijëve të saj të mitur. Edhe pse gjykata ka urdhëruar largimin e dhunuesit nga banesa për

një periudhë 12-mujore, urdhri i mbrojtjes është shkelur dhe autori është arrestuar në flagrancë. Në një tjetër rast, masa e largimit të dhunuesit nga banesa ka rezultuar efektive dhe e përshtatshme për garantimin e sigurisë së viktimës.

GjShPJP Durrës, në një rast kompleks, dhuna është ushtruar nga të dy prindërit ndaj të miturit. Masa e sigurisë "arrest me burg" ndaj babait është konsideruar proporcionale me rrezikun e paraqitur dhe rolin e tij në kryerjen e veprës penale. Për nënën, e cila është lënë në gjendje të lirë, janë ndërmarrë përpjekje për përfshirjen në programe të detyrueshme të këshillimit psikologjik dhe ndërhyrjes prindërore, por ajo ka refuzuar pjesëmarrjen. Si pasojë, masa mbrojtëse është fokusuar vetëm në distancimin e fëmijës nga babai, ndërkohë që nuk disponohet informacion mbi monitorimin apo mbështetjen e mëtejshme të ofruar nga NJMF.

GjShPJP Tiranë, i pandehuri ka shkelur urdhrin e mbrojtjes. Kjo tregon nevojën për një përgjigje më të fortë institucionale dhe monitorim të zbatimit të vendimeve gjyqësore.

Në përfundim, megjithëse gjykatat në përgjithësi kanë zbatuar masa mbrojtëse të përshtatshme dhe në përputhje me nevojat e viktimave të DHF, mbetet e domosdoshme forcimi i mekanizmave të monitorimit dhe zbatimit të urdhrave të mbrojtjes, si dhe zgjerimi i përdorimit të masave shtesë në rastet me rrezik të lartë ose me specifika të ndërlikuara. Përmirësimi i reagimit institucional kërkon qasje të integruar ndërinstitutionale, forcim të kapaciteteve profesionale dhe garantimin e mbrojtjes efektive për çdo viktimitë të DHF.

4.5 Forma të dhunës të identifikuar gjatë gjykimit penal

Gjatë trajtimit gjyqësor të rasteve të monitoruara del në pah se forma më e shpeshtë e dhunës mbetet ajo fizike, e ndjekur nga dhuna psikologjike. Në terma statistikore, dhuna fizike përbën rreth 43.76% të rasteve të vëzhguara, ndërsa ajo psikologjike zë 27.48% të totalit.

Një përqindje e konsiderueshme i përket veprimeve të përsëritura të dhunës (12.47%), të cilat shpesh paraqesin një përshkallëzim të formave të dhunës dhe dëshmojnë mbi një cikël të vazhdueshëm abuziv, ku viktima gjendet në një situatë të vazhdueshme kërcënimi e frike. Ndër format e tjera të evidentuara janë: kanosje serioze për vrasje (3.59%); plagosje e kryer me dashje apo e rëndë (1.69%); përndjekje (2.33%) dhe ngacmime seksuale (0.42%). Shkaktim vetëvrasje, vepra të turpshme dhe dhunë ndaj fëmijëve – megjithëse raste të veçuara, këto paraqesin shqetësime serioze me ndikim të thellë social dhe psikologjik.


Në një numër të kufizuar rastesh u identifikua dhunë seksuale, rreth 0.63% të rasteve. Theksojmë, ky numër mund të mos përfaqësojë prevalencën reale të kësaj forme dhune, për shkak të vështirësive në denoncim dhe tabu shoqërore që e shoqërojnë këtë çështje.

Një faktor tjetër që ndikon negativisht në mos raportimin e rasteve të dhunës seksuale lidhet me mënyrën e trajtimit të këtyre çështjeve nga mediat. Raportimet me qasje josensitive ndaj viktimave, përmes publikimit të pamjeve filmike, detajeve identifikuese ose informacionit të hollësishëm mbi ngjarjet, mund të cenojnë dinjitetin dhe privatësinë e tyre.

Publikimi nga mediat i materialeve të tepërta vizuale, si në rastin e një shtetaseje italiane e cila ndodhej në Durrës për turizëm dhe fatkeqësisht u bë viktimitë e abuzimit seksual, mund të dekurajojë viktimat e tjera të dhunës seksuale nga paraqitja e denoncimeve pranë organeve përgjegjëse të rendit dhe drejtësisë.

U identifikuan edhe forma të tjera të ushtrimit të presionit dhe frikësimit mbi viktimat nëpërmjet teknologjisë, duke përdorur materiale komprometuese (video, foto intime) si mjet për shantazh dhe detyrim seksual. Gjithashtu, përndjekja ka marrë forma të sofistikuara, përmes mesazheve kërcënuese, telefonatave të përsëritura, ndjekjes në vende publike apo në rrjetet sociale. Në raste të tilla, ndonëse dhuna fizike mund të mungojë, efekti psikologjik mbi viktimitë është thellësisht tronditës dhe ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së saj.

Rastet e ushtrimit të dhunës psikologjike vazhdojnë të jenë ndër më të vështirat për t'u vlerësuar në mënyrë të plotë në proceset gjyqësore. Nuk është praktikë e gjykatave caktimi i një eksperti psikolog që të kryejë një vlerësim të specializuar për ndikimin e dhunës psikologjike tek viktimat.




Mungesa e këtij vlerësimi pengon identifikimin e plotë të pasojave emocionale dhe mendore që përjeton viktimat dhe, rrjedhimisht, ndikon në përcaktimin e një mase dënimi jo realisht proporcionale me dëmin e shkaktuar. Kjo situatë rrezikon nënvlerësimin e formave jo-fizike të dhunës, të cilat lënë pasojat të rënda dhe afatgjata. Rekomandohet përfshirja sistematike e ekspertizës psikologjike në procedurat penale që lidhen me dhunën psikologjike, me qëllim sigurimin e një mase ndëshkimi të drejtë e proporcionale me shkallën e dëmtimit të shkaktuar.

4.6 Marrëdhënia ndërmjet viktimës dhe autorit të dhunës

Të dhënat e grumbulluara nga monitorimi në të gjitha gjykatat evidentojnë se në pjesën dërrmuese të rasteve, dhuna është ushtruar nga persona të afërt të viktimës, me të cilët ekzistonte ose kishte ekzistuar një lidhje familjare, martesore apo bashkëjetese. Kjo konfirmon se dhuna ndodh kryesisht në hapësirën e brendshme të jetës familjare. Personi më i shpeshtë që ushtron dhunë është bashkëshorti, me një përqindje që arrin në 36.15% të rasteve të trajtuara. Kjo shifër tregon për një prevalencë të lartë të dhunës në kuadër të martesës.

Përveç bashkëshortit, grupi i dytë me përfaqësim gjithashtu të lartë është ai i gjinisë së afërt, ku përfshihen të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, nipër, mbesa, emta, ungjër.



Ky grup përfaqëson rreth 40.37% të rasteve, duke treguar një prezencë shqetësuese të dhunës brenda bërthamës familjare tradicionale, përtej marrëdhënieve bashkëshortore. Në këtë grup, shpeshherë dhuna mbart edhe elementë të ushtrimit të autoritetit tradicional, ku figura e burrit apo e një anëtarit më të vjetër përpriqet të imponojë sjellje apo kufizime mbi të rinjtë, veçanërisht mbi gratë dhe vajzat.

Bashkëjetuesi dhe ish-bashkëjetuesi janë identifikuar si autorë në një numër më të kufizuar rastesh (6.86% dhe 1.85% respektivisht), por mbeten aktorë të rëndësishëm në kontekstin e dhunës që ndodh jashtë lidhjes martesore, por në kushte të bashkëjetesës faktike. Ish-bashkëshortët përfaqësojnë rreth 4.49% të autorëve të identifikuar. Ky grup paraqet një kontekst të veçantë, ku shpeshherë dhuna ndodh pas zgjidhjes së martesës, shpesh si formë hakmarrjeje, kontrolli.

Në një numër të kufizuar rastesh 3.96%, autorët kanë qenë persona me të cilët viktimat kanë pasur një lidhje apo ish-lidhje intime. Në rastet ku autorët kanë qenë persona të lidhur përmes krushqisë së afërt, përfshirë vjehërrit, kunetërit apo anëtarët e tjerë të familjes së zgjeruar, është evidentuar një përqindje e ulët (3.96%). Raste të tjera sporadike, kryesisht lidhje emocionale online, përbëjnë një përqindje minimale (1.58%), por gjithsesi kërkojnë vëmendje për të adresuar boshllëqe të mundshme në mbrojtjen ligjore të viktimave. Këto gjetje shfaqin DHF dhe DHBGJ si një fenomen që nuk kufizohet vetëm në lidhjet martesore apo bashkëjetuese, por që shtrihet më gjerë në të gjithë spektrin e marrëdhënieve të afërsisë familjare dhe emocionale.

Në një pjesë të konsiderueshme të çështjeve, viktimat ka qenë bashkëshortja, duke u paraqitur në mënyrë të përsëritur si subjekti më i ekspozuar ndaj dhunës. Kjo gjetje shpalos se marrëdhënia bashkëshortore vazhdon të mbart rreziqe të theksuara për gratë, sidomos në mjedisë ku kontrolli dhe varësia ekonomike ndikojnë negativisht në balancën e raporteve njerëzore.

Gjithashtu, janë evidentuar raste të shumta ku viktimat kanë qenë nënat, vajzat, motrat, por edhe bashkëjetueset apo ish-partneret në marrëdhënie të formalizuara dhe joformalizuara. Kjo shumëllojshmëri informon për një shtrirje të gjerë të dhunës nëpër shtresat e ndryshme të strukturës familjare, ku nuk mungojnë edhe rastet e viktimave të gjinisë mashkullore, si djemtë, burrat, vëllezërit apo baballarët. Gjithashtu, janë vërejtur raste të përfshirjes së të afërmeve të zgjeruar si kunatë, vjehrra, kushërinj, xhaxhallarë.

Domethënës është fakti se janë konstatuar raste në të cilat palët kanë pasur njëkohësisht cilësinë e viktimës dhe të pandehurit. Për shembull dhuna është ushtruar në mënyrë reciproke ndërmjet vëllezërve, babait dhe djalit, bashkëshortëve, etj. Këto raste ilustron qartë natyrën ciklike dhe shpesh simetrike të dhunës brenda familjes, ku konfliktet mund të degjenerojnë në akte të ndërsjella agresioni, duke ndërlikuar edhe më tej procesin e vlerësimit gjyqësor dhe ofrimit të mbrojtjes së duhur.

Të dhënat e mësipërme konfirmojnë se dhuna në familje nuk është një ngjarje e izoluar ndërmjet bashkëshortëve, por përbën një dukuri me përmasa të gjera, që prek anëtarë të ndryshëm të familjes, përfshirë edhe ata që nuk ndodhen në marrëdhënie të drejtpërdrejta bashkëjetese. Madje ndodh brenda konteksteve ku pritet të ekzistojë siguri dhe mbështetje emocionale. E rëndësishme është të theksohet se në shumë raste viktimat janë gra, por edhe meshkuj, të rinj, të moshuar, dhe fëmijë, gjë që tregon se mbrojtja ligjore duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe e bazuar mbi realitetin e jetës familjare në të gjitha format e saj. Vetëm në këtë mënyrë mund të garantohet një drejtësi që jo vetëm ndëshkon, por edhe mbron në mënyrë efektive e njerëzore.

4.7 Profili i të pandehurve

Ky seksion i raportit fokusohet në karakteristikat demografike dhe gjyqësore të të pandehurve në veprat penale të DHF dhe DHBGJ.


a) Gjinia e të pandehurve



Në total, 95.60% e të pandehurve janë meshkuj, ndërsa vetëm 4.40% janë femra. Kjo gjetje tregon se DHF vijon të paraqitet si një fenomen me bazë kryesisht gjinore, ku ushtrimi i dhunës nga ana e burrave përbën një tipar të theksuar të rasteve të denoncuar dhe të ndjekura penalisht. Ky fakt konfirmohet edhe nga vjetari statistikor 2023 i publikuar nga Ministria e Drejtësisë⁴, sipas të cilit në të gjitha GjShPJP janë regjistruar gjithsej 1,938 viktima të DHF të gjinisë femërore dhe 515 viktima të gjinisë mashkullore. Këto të dhëna pasqyrojnë përmasat gjinore të fenomenit të DHF të trajtuar në sistemin gjyqësor gjatë periudhës së referuar.

b) Gjendja civile e të pandehurve

Rreth 54.34% e të pandehurve kanë qenë të martuar në momentin e kryerjes së veprës penale, ndërsa 25.14% rezultojnë beqarë. Të dhënat tregojnë gjithashtu se 10.98% kanë qenë të divorcuar, ndërsa një pjesë e vogël janë të ve ose pa të dhëna të qarta.



Kjo shpërndarje reflekton se dhuna në familje ndodh më së shumti në marrëdhënie martesore ose partnerësh bashkëjetues. Megjithatë, nuk përjashtohen format e dhunës në marrëdhënie të mëparshme apo të ndërprera (*siç është rasti i personave të divorcuar*), gjë që kërkon një vëmendje të shtuar të institucioneve në lidhje me dhunën post-divorc apo dhunën gjatë periudhës së ndarjes së një marrëdhënieje intime.

c) Gjendja gjyqësore e të pandehurve




Rreth 20.23% e të pandehurve kanë pasur precedentë penalë të mëparshëm, përfshirë edhe raste të përsëritura të DHF. Fatkeqësisht, nuk ka qenë e mundur të përcaktohet me saktësi përqindja e të pandehurve që kanë pasur më parë dënime penale lidhur me DHF dhe DHBGJ. Megjithatë, 69.94% e të pandehurve nuk kanë qenë të dënuar më parë, çka nënvizon se në pjesën më të madhe të rasteve bëhet fjalë për “autorë të rastit”.

⁴ <https://www.drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2025/02/Vjetari-Statistikor-2023.pdf>

Kjo gjetje sugjeron se, ndonëse DHF mund të përbëjë një sjellje të përsëritur, shpeshherë aktet e dhunës kryhen nga persona që nuk kanë pasur kontakte të mëparshme me sistemin penal. Kjo rrit domosdoshmërinë për ndërhyrje të hershme, edukim dhe ndërgjegjësim, përpara se dhuna të shndërrohet në një model të ripërsëritur sjelljeje.


d) Shtetësia e të pandehurve

Rreth 97.98% e të pandehurve janë shtetas shqiptarë. Vetëm në 3 raste të izoluar të pandehurit kanë qenë shtetas të huaj – njëri me shtetësi britanike (regjistruar në GjShPJP Vlorë), një me shtetësi kosovare dhe një me shtetësi nga Sri Lanka (regjistruar në GjShPJP Durrës).



Ky tregues pasqyron dominim të fenomenit të DHF brenda komunitetit vendas, por nuk përjashton nevojën për qasje të përshtatura për rastet që përfshijnë shtetas të huaj, të cilët mund të përballen me barriera shtesë në marrjen e drejtësisë dhe shërbimeve të mbrojtjes, sidomos në kushtet kur numri i emigrantëve në vend është në rritje.

e) Arsimi i të pandehurve




Shumica e të pandehurve, konkretisht 43.93%, rezultojnë me arsim 8-vjeçar. Një përqindje domethënëse përkatësisht 22.54% përbëhet nga persona me arsim të mesëm. Nga ana tjetër, 4.62% të të pandehurve janë me arsim të lartë. Rreth 6.36% janë me nivel të ulët arsimor, ndërsa 3.76% e të pandehurve janë pa arsim fare. Në 18.79% të çështjeve mungon informacioni mbi arsimin e të pandehurve. Nivelet e ulëta arsimore mund të ndikojnë negativisht në aftësinë e individëve për të menaxhuar emonicionet, konfliktet dhe për të adoptuar sjellje të pranueshme brenda marrëdhënieve ndërpersonale. Kjo shpërndarje mund të nënvizojë një korrelacion mes mungesës së edukimit dhe përfshirjes në akte të DHF dhe DHBGJ. *Megjithatë, kjo nuk duhet interpretuar në mënyrë lineare, pasi DHF dhe DHBGJ është një fenomen kompleks, me rrënjë të shumanshme, që përfshin faktorë socialë, kulturorë, ekonomikë dhe psikologjikë, e cila sipas studimeve mund të ushtrohet edhe nga personat me arsim të lartë por të ketë një raportim shumë të ulët.*

Në vrojtimin kombëtar të bërë nga INSTAT, dhuna është e pranishme pavarësisht nivelit arsimor e kulturor të dhunuesit apo të viktimës. Gratë e të gjitha niveleve arsimore kishin përjetuar

DHF. Meshkujt e të gjitha niveleve arsimore kryejnë akte të dhunës në familje ndaj bashkëshorteve dhe/ose partnereve të tyre intime.⁵

f) Moshë e të pandehurve

Rreth 28.61% e të pandehurve i përkasin grup moshës 30-39 vjeç, e ndjekur nga 23.41% në grup moshën 40-49 vjeç, dhe 18.21% në grup moshën 50-59 vjeç.



Këto të dhëna tregojnë se një pjesë e madhe e akteve të DHF dhe DHBGJ kryhen nga persona që ndodhen në moshë pune. Gjithashtu, nuk duhet neglizhuar prania e individëve të moshës së tretë në këtë kategori, me 5.49% të të pandehurve në grup moshën 60-69 vjeç dhe 2.89% në grup moshën 70-79 vjeç, çka hedh dritë mbi një dimension të veçantë të dhunës, shpesh të padukshme, që mund të përfshijë raste të dhunës mes partnerëve të moshuar apo dhunë ndaj anëtarëve të tjerë të familjes. Një përqindje më e vogël e të pandehurve janë nën moshën 18 vjeç (1.45%), e cila nënkupton se përfshirja e të miturve në raste të tilla është më e kufizuar, por sërish e pranishme. Në 8.96% të rasteve, mungon informacioni i saktë mbi moshën e të pandehurve.

g) Profili profesional dhe statusi ekonomik i të pandehurve

Të dhënat e grumbulluara tregojnë një shpërndarje të larmishme të të pandehurve për sa i takon profesionit apo aktivitetit të tyre ekonomik. Rreth 10.98% rezultojnë të jenë të papunë në momentin e kryerjes së veprës penale. Papunësia mund të përbëjë një faktor shtesë i cili rëndon situatën socio-ekonomike të individit dhe potencialisht ndikon në përkeqësimin e marrëdhënieve brenda familjes. Rreth 15.61% e të pandehurve rezultojnë të jenë punëtorë të ndryshëm, ndërsa 4.34% janë të punësuar në sektorin e ndërtimit.

Pensionistët përfaqësojnë një përqindje më të vogël të të pandehurve (1.73%), duke sjellë në vëmendje që DHF dhe DHBGJ, ndonëse më e shpeshtë në grup moshat aktive, mund të ndodhë edhe në moshë të tretë. Gjithashtu, janë identifikuar si të pandehur individë me status të emigrantit (2.31%), si dhe vetëpunësuar ose të angazhuar në sektorë të ndryshëm të punës private (2.02%). Më rrallë, gjenden edhe profesione të lidhura me fushën e shërbimeve apo të drejtësisë, si jurist, avokat, mësues, shofer, infermier, agjent pasurish të paluajtshme, etj., të cilat përbëjnë raste të izoluara me përqindje shumë të ulëta (në çdo rast 0.29%).

Edhe pse rrallë të denoncuar, prania e këtyre profesionistëve tregon se DHF mund të shfaqet edhe në mjedise të perceptuara si më të mbrojtura ose të lidhura me fushën e ligjit apo edukimit. Një vëmendje të veçantë kërkojnë rastet në të cilat të pandehurit janë identifikuar si persona me probleme të shëndetit mendor (0.87%) apo si invalidë (0.58%). Në 55.78% të çështjeve nuk ka të dhëna lidhur me profesionin e dhunuesit.

Nga analiza e nivelit arsimor dhe grup moshave të të pandehurve rezulton se DHF përfshin një spektër të gjerë individësh, por me një përqendrim të dukshëm në grupet që përfaqësojnë arsim të ulët dhe moshë të rritur.

⁵ Dhuna në Familje në Shqipëri Vrojtim Kombëtar me Bazë Popullatën, INSTAT, fq. 58.

<https://files.acquia.undp.org/public/migration/al/Domestic-Violence-in-Albania---National-Survey.pdf>



Ky profil nxit reflektim mbi nevojën për ndërhyrjeve parandaluese, veçanërisht në fushën e edukimit qytetar dhe zhvillimit të aftësive për menaxhimin e konflikteve. Në këtë kontekst, sugjerohet forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore, shërbimeve sociale dhe sistemit të drejtësisë për të planifikuar ndërhyrjen në edukimin qytetar të brezave mbi dhunën. Gjithashtu, përqindja relativisht e lartë e të papunëve mund të përbëjë një tregues të rëndësishëm për nevojën e forcimit të ndërhyrjeve sociale me programeve që adresojnë stresin ekonomik brenda familjes dhe papunësinë. Në këtë kuadër, rekomandohen ndërmarrja e politikave që synojnë uljen e shkallës së papunësisë.

4.8 Analizë mbi llojet e provave të administruara gjatë gjykimit

Ky nënkapitull i kushtohet llojeve të provave të administruara në proceset gjyqësore që lidhen me veprat penale të DHF dhe DHBGJ. Në mënyrë të përmblëdhur, shpërndarja e provave sipas përqindjes në të gjithë rastet e analizuar paraqitet si më poshtë: Akte të hetimeve paraprake sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar: 18.33%; Thëniet e viktimës si dëshmitare: 16.00%; Dëshmitarë të tjerë: 10.53%; Akte ekspertimi: 9.45%; Pyetja e të pandehurit: 12.69%; Dokumente (të ndryshme): 10.70%; Prova materiale: 8.13%; Procesverbale këqyrje, kontrolli, sekuestro: 7.96%; Procesverbale të përgjimeve telefonike apo ambientale: 1.58%; Pyetje e ekspertëve: 1.24%; Dokumente të tjera të lëshuara nga punonjësit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësive vendore: 0.58%; Dokumente nga OJF-të: 0.08%; Të tjera (të papërcaktuara): 2.73%. Vërehet se më të shpeshtat janë dokumentet e hetimit paraprak dhe dëshmitë e viktimës, ndërsa më rrallë janë përdorur dokumente që burojnë nga OJF-të apo nga shërbimet sociale.

Në disa raste janë marrë në cilësinë e provave dokumente të ndryshme: Dokumente mjekësore, vërtetim nga Kryeplaku i fshatit, epikrizë, të dhëna nga sistemet e policisë (p.sh. TIMS), fletë-dalje nga Spitali Psikiatrik Vlorë, vlerësimin mjekësor për caktimin e aftësisë së kufizuar, rekomandim psikiatri, kartela mjekësore nga mjekja e familjes, deklaratë noteriale që dhunuesi e viktimë kanë falur njëri tjetrin e kanë normalizuar marrëdhëniet, raport shërbimi nga policia për gjendjen e rëndë shëndetësore të viktimës që mungoi në gjykim, tabulate telefonike, raporte shërbimi nga policia etj.,

Përdorimi i aktit të ekspertimit psikologjik

Në disa raste kur dhuna është ushtruar në formën psikologjike (neni 130/a/1 KP), është vërejtur mungesë e provës ekspertizë psikologjike, qoftë në fazën hetimore, qoftë në gjykim. Kjo


mungesë sjell vështirësi për trupin gjykues në vlerësimin e thelluar të rrethanave faktike dhe ndikimit të ngjarjes tek viktimat dhe për pasojë përcaktimit proporcional të masës së dënimit. Mendimi i ekspertit psikolog merret vetëm në disa raste dhe jo si praktikë e zakonshme.

Po ashtu, janë evidentuar raste pozitive të dëgjimit të viktimës nga gjykata, të cilat kanë kërkuar administrimin e provave të reja si dëshmitarë apo regjistrime audio, që provojnë ngjarjen. Kërkesa këto të pranuar nga ana e gjykatës. [Praktikë pozitive]

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është mbrojtja ekonomike e viktimave në rastet kur për gjykimin e çështjes është kërkuar mendimi i ekspertit. Në mungesë të të dhënave të qarta nuk mund të arrijmë në një konkluzion në lidhje me këtë aspekt.

4.9 Ndryshimi i qëndrimit të viktimës gjatë procesit gjyqësor

Ky nënkapitull përqendrohet në shqyrtimin e qëndrimit të viktimës gjatë procesit gjyqësor, në çështjet që lidhen me DHF dhe DHBGJ. Gjatë monitorimeve të kryera në shtatë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, dhomat penale, është vënë re se një pjesë e konsiderueshme e viktimave kanë ndryshuar qëndrimin fillestar të shprehur në kallëzimin penal apo në deklaratimet hetimore.



Nga 379 viktimat të regjistruara në proceset penale të monitoruara në total, rezulton se në 30.34% të rasteve viktimat ka ndryshuar qëndrim gjatë gjykimit. Në 40.63% të rasteve qëndrimi i viktimës ka qenë i pandryshuar. Ndërsa në 29.02% të çështjeve nuk ka pasur të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar qëndrimin e viktimës, për shkak të mungesës së saj në seancën e monitorimit, mungesës së deklaratimeve gjatë seancave ose ngaqë çështja nuk është monitoruar në të gjitha seancat. Ndryshimet e qëndrimit të viktimës janë paraqitur në formë të ndryshme, ndër të cilat: *kërkesa për pushim të çështjes; kërkesave për dënime më të lehta; deklarata noteriale për falje dhe normalizim të marrëdhënieve; minimizim i aktit të dhunës gjatë dëshmisë në seancë; refuzim për të dëshmuar*. Kjo sjellje është vërejtur më shpesh në qarqet Tiranë, Berat dhe Elbasan, ndërsa ka qenë më e rrallë në Durrës dhe Shkodër.

Gjetjet e monitorimit konkludojnë se ndryshimi i qëndrimit të viktimës është rezultat i një kombinimi kompleks faktorësh, përfshirë:

- Lidhjet familjare, normalizimi i marrëdhënieve viktimë-pandehur dhe këmbëngulja për të mos ndarë familjen, rivendosja e bashkëjetesës për ruajtjen e kohezionit familjar apo mirëqenien e fëmijëve;
- Varësia ekonomike e viktimës ndaj dhunuesit, i cili në shumë raste është edhe kryefamiljari dhe personi i vetëm që siguron të ardhurat për jetesën e familjes;
- Dhembshuria e familjarëve, të cilët ndiejnë keqardhje për situatën e dhunuesit, sidomos në rastet kur ai ka probleme të shëndetit mendor;
- Presioni emocional nga familjarët, p.sh. ndaj nënës nga ndjenjat e fëmijëve të mitur, të cilët ndihen të prekur nga mungesa e babait dhe shfaqin kërkesën që ai të mos qëndrojë në burg;
- Stigmatizimi dhe presioni social, sidomos në komunitete të vogla ose kur viktimat nuk gëzojnë mbështetje të mjaftueshme institucionale.

Në të gjitha gjykatat e monitoruara vihet re kjo dukuri e përbashkët. Pavarësisht vendndodhjes, ky fenomen pasqyron tensionin e vazhdueshëm midis kërkesës për drejtësi dhe nevojës për mbijetesë apo stabilitet brenda familjes. Më poshtë prezantojmë disa shembuj ilustrues

të konstatuara nga vëzhgimet, të cilët janë të ngjashme në të gjitha gjykatat. Rastet dëshmojnë se viktimat kërkojnë mos dënimin e të pandehurit kryesisht për arsye të normalizimit të marrëdhënieve familjare dhe ruajtjes së kohezionit brenda familjes. P.sh., viktimat - bashkëshortja, vajza, motra, nëna shprehin se e kanë falur të pandehurin dhe dëshirojnë të rikthehen në bashkëjetesë, duke theksuar: *“E kam falur! Kemi normalizuar marrëdhëniet! Nuk dua të dënohet”* *“Kemi vendosur të marthohemi”*. Një motër theksoi se dhuna ishte rezultat i ngarkesës emocionale të vëllait pas vdekjes së babait. Këto deklarime pasqyrojnë përparësinë që viktimat i japin pajtimin dhe ruajtjes së lidhjeve familjare, pavarësisht veprës penale të kryer.

Në një tjetër rast, pas dhënies së dëshmisë në gjykatë, viktima paraqiti një deklaratë noteriale ku theksohej se marrëdhëniet me të pandehurin ishin normalizuar dhe se: *“nuk dëshiroj që ai të dënohet, por të kthehem si familje”*. Edhe pse kjo deklaratë u dorëzua nga mbrojtja, gjykata vendosi të mos e administrojë për shkak se dëshmia e viktimës ishte dhënë tashmë në mënyrë të drejtpërdrejtë përpara trupit gjykues, duke pasur fuqi të plotë provuese. Në një rast tjetër, një deklaratë e ngjashme është konsideruar e vlefshme nga gjykata.

Vërehet se shumë viktima ndryshojnë qëndrim për shkak të lidhjeve të forta familjare dhe emocionale, si dhe për të shmangur pasojat sociale që mund të vijnë nga dënimi i të afërmeve. Vjehrra deklaroi para gjykatës: *“Unë jam dhunuar, ndaj edhe kam bërë kallëzim në polici. Megjithatë, e kam falur të pandehurën pasi është nusja e djalit tim dhe është nëna e nipit tim. Jam dakord me prokurorin që të deklarohet fajtores, ndërsa dënimi mendoj që të jetë sa më i ulët.”* Ky citim përfaqëson qartë tensionin midis nevojës për drejtësi dhe dëshirës për ruajtjen e unitetit familjar. Në raste të tjera, prindërit e të pandehurve kanë deklaruar se *“e kemi falur djalin”*, duke kërkuar pushimin e çështjes, me arsyetimin se ai ka kaluar *“gjendje të vështirë emocionale, depresion dhe ankth”*, dhe se marrëdhëniet familjare janë aktualisht të qëndrueshme.

Në disa raste, falja e të pandehurit lidhet me gjendjen e tij shëndetësore. P.sh., viktima kishte depozituar një deklaratë noteriale duke theksuar se: *“kushëriri është me probleme të shëndetit mendor dhe se tashmë kemi rregulluar marrëdhëniet”*. Nëna e një të pandehuri kërkoj: *“Të kthehet djali në shtëpi”*, duke propozuar trajtim mjekësor në kushte shtëpie. Një tjetër nënë u shpreh: *“Djali është i vetmi person që kujdeset për mua”*, duke kërkuar lirimin e tij.

Qëndrimet e mësipërme vërtetojnë se shumë njoftime fillestare në polici nuk kishin për qëllim ndëshkimin e dhunuesit, por vetëm marrjen e masave parandaluese apo këshillimore, përfshirë trajtimin e detyruar të të pandehurve me varësi ndaj alkoolit e substancave narkotike apo atyre me prirje të dhunshme. Prindërit shpesh minimizojnë veprën e dhunës duke e lidhur atë me varësitë e të pandehurve, duke deklaruar se *“sjellja e djalit ishte pasojë e varësisë ndaj alkoolit”*.

Një ndër arsyet më të përsëritura të ndryshimit të qëndrimit të viktimave është varësia ekonomike nga i pandehuri dhe kushtet e vështira jetësore. Bashkëshortet, veçanërisht ato me fëmijë të vegjël, kërkojnë lirimin e bashkëshortëve për të siguruar mirëqenien e familjes. Një bashkëshorte deklaroi: *“Kërkoj të lirohet bashkëshorti për të mbajtur të bashkuar familjen, pasi jemi në gjendje të rënduar ekonomike, me dy vajza të mitura, pa ndihmë.”* Një tjetër theksoi se kishte kërkuar faljen e të pandehurit për shkak se *“gjendja ekonomike ishte e papërballueshme për të jetuar”*, duke qenë e vetme me dy fëmijë dhe me kredi të pashlyer. Një bashkëshorte e prekur rëndë emocionalisht, kërkoj faljen e bashkëshortit pasi gjendja e tyre ekonomike ishte ekstremisht e mjerueshme, si dhe kishin dy fëmijë me autizëm *“Bashkëshorti është personi i vetëm që punon në shtëpi”*.

Në një tjetër proces, viktima nuk pranoi të jepte më deklarime në gjykatë – *“i mituri nuk ka dashur të flasë më në gjykim”* – çka mund të nënkuptojë ose presion emocional ose hezitim për të vijuar me procedurat.

Në një rast tjetër, nëna dhe avokatja e një viktime të mitur deklaruan se ajo kërkonte që i pandehuri (babai) të dënohej me një masë sa më të lehtë, *pasi kjo do ta ndihmonte që ajo të kalonte gjendjen e vështirë psikologjike që po kalonte*, duke reflektuar ndjeshmëri të thellë emocionale.

Në procedime të ndërsjella, ku palët kanë ushtruar kallëzim ndaj njëra-tjetrës, është konstatuar paraqitja e deklaratave noteriale të pajtimit, ku palët kanë konfirmuar “*se janë pajtuar dhe e kanë falur njëri-tjetrin për konfliktin e lindur nga pronësia*”.

Në një rast të gjykuar nga Gjykata e Tiranës, viktima deklaroi gjatë seancës se “*e ka falur bashkëshortin dhe marrëdhëniet janë normalizuar*”. Megjithatë, nga vëzhgimi i sjelljes dhe rrethanave u krijua bindja se deklarata ishte dhënë me qëllim shmangien e pasojave ligjore për të pandehurin. Ky rast nënvizon nevojën për vlerësim të kujdesshëm të autenticitetit të deklaratimeve dhe vullnetin e lirë të shprehjes, duke marrë në konsideratë ndikimet e mundshme të presionit, varësisë ekonomike dhe kushteve të vështira sociale. Deklaratat të tilla pasqyrojnë qartë një realitet ku drejtësia përplasat me nevojën për mbijetesë apo ndjeshmëri familjare, duke nënvizuar rëndësinë e një mbështetjeje më të madhe institucionale për viktimat gjatë gjithë procesit gjyqësor.

Ndryshimi i qëndrimit të viktimës gjatë gjykimit ngre sfida serioze për sistemin e drejtësisë, veçanërisht në vlerësimin e saktë të provave dhe në marrjen e një vendimi të drejtë. Raste të tilla shpesh krijojnë pasiguri në procesin e vendimmarrjes, për shkak të mos koherencës në dëshmi që cenon besueshmërinë apo prej mungesës së provave të tjera mbështetëse. Kjo sjellje mund të ndikojë funksionin parandalues të ndjekjes penale për DHF dhe DHBGJ, duke i lënë të pandehurit pa përgjegjësi ligjore efektive dhe duke rrezikuar përsëritjen e dhunës. Ndryshimi i qëndrimit të viktimës gjatë procesit penal megjithëse shpesh rrjedh nga faktorë të ndjeshëm dhe të kuptueshëm, ai kërkon një trajtim të kujdesshëm institucional për të mos penguar efektivitetin e ligjit dhe për të garantuar mbrojtjen e vërtetë të viktimave. Sistemi gjyqësor ka nevojë për një balancë të kujdesshme ndërmjet ndjeshmërisë ndaj rrethanave familjare dhe nevojës për ndëshkim të drejtë e proporcional të veprimeve dhunuese.

V. VENDIMI I GJYKATËS

5.1 Vendimmarrja e gjykatës

Ky nënkapitull paraqet një pasqyrë të vendimmarrjes gjyqësore në çështjet penale të monitoruara. Në rreth 72.54% të rasteve të monitoruara gjykatat kanë vendosur deklarinin fajtor të të akuzuarit. Ndërkohë, në 1.16% të çështjeve gjykata ka vendosur deklarinin e pafajësisë së të pandehurit. Në 6.36% të rasteve është vendosur pushimi i çështjes penale, shpesh i shoqëruar me caktimin e një mase mjekësore të detyrueshme, si “*mjekim i detyruar ambulator*” ose “*mjekim i detyruar në një institucion mjekësor*”. Në një rast të vetëm (0.29%) është konstatuar një vendim për mospranimin e kërkesës për pushimin e çështjes dhe kthimin e akteve për vijimin e hetimeve.

Gjithashtu, në 1.16% të rasteve të monitoruara, ku vëzhgimi ka rastisur gjatë fazës së seancës paraprake, është vendosur dërgimi i çështjes për gjykim. Në lidhje me paditë civile të paraqitura brenda procedimeve penale nuk u evidentua vendimmarrje. Kjo mund të jetë një tregues i mungesës së një praktike të konsoliduar për ushtrimin e padisë civile në procese penale.


Për rreth 18.50% të çështjeve nuk mund të përcaktohet vendimi përfundimtar i gjykatës në mungesë informacionit të plotë, meqë nuk është monitoruar seanca e shpalljes së vendimit.

Bazuar në të dhënat e Vjetarit Statistikor 2023⁶, të publikuara nga MD, rezulton se gjatë vitit 2023 janë shqyrtuar një sërë çështjesh penale të lidhura me veprat penale të DHF dhe DHBGJ, sipas dispozitave përkatëse të KP.

Të dhënat paraqesin ecurinë dhe mënyrën e përfundimit të çështjeve sipas neneve përkatëse si më poshtë: Për veprën penale të DHF parashikuar nga neni 130/a pika 2, 3 dhe 4 të KP janë


⁶ <https://www.drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2025/02/Vjetari-Statistikor-2023.pdf>

dhënë 767 vendime fajësie, ndërsa 8 çështje kanë përfunduar me vendim pafajësie, 4 me pushim dhe 2 janë kthyer për plotësim të hetimeve.




Për sa i përket nenit 130/a pika 1 janë dhënë 144 vendime fajësie, ndërsa 7 vendime pafajësie dhe 2 çështje janë pushuar. Ndërkaq, për veprat penale që lidhen me cenimin e integritetit fizik apo shëndetësor, sipas neneve 100–108/a të KP janë dhënë gjithashtu vendime përkatëse, me një përqindje dominuese të vendimeve të fajësisë. Konkretisht, neni 108/a ka rezultuar me 25 vendime fajësie, 2 vendime pafajësie dhe 1 vendim pushimi, duke reflektuar trajtimin gjyqësor të rasteve të dhunës kundër grave. Për sa i përket nenit 100 janë dhënë 17 vendime fajësie; në lidhje me nenin 101 - 5 vendime fajësie; në lidhje me nenin 102 - 1 vendim pafajësie; në lidhje me nenin 102/a - 1 vendim fajësie; në lidhje me nenin 108 - 11 vendime fajësie dhe 1 vendim pafajësie. Këto të dhëna statistikore tregojnë se shumica dërrmuese e çështjeve të gjykuara në lidhje me veprat penale të DHF dhe DHBGJ janë përmbyllur me vendim fajësie, çka paraqet një tendencë pozitive në drejtim të ndëshkueshmërisë së dhunës.

a) Konfirmimi i akuzës së prokurorisë në vendimmarrjet e gjykatës



Monitorimi tregon se në 64.22% të çështjeve vendimi për deklarimin fajtor të të pandehurit ka qenë në përputhje të plotë me akuzën fillestare të paraqitur nga prokuroria. Megjithatë, në 12.54% të çështjeve vendimi i gjykatës nuk ka konfirmuar akuzën e prokurorisë. Gjithashtu, në 1.53% të çështjeve është konstatuar se gjatë seancës paraprake është bërë një ndryshim në akuzë. Në 21.71% të çështjeve mungon informacioni në momentin e monitorimit, duke mos lejuar një konkludim të saktë mbi përputhshmërinë ndërmjet akuzës së prokurorit dhe cilësimit juridik të veprës penale në vendimin përfundimtar. Në rastet e mos konfirmimit të akuzës, gjykata nuk ka pranuar kërkesën për pushimin e çështjes ose ka modifikuar cilësimin juridik të veprës penale nga neni 130/a/1 KP në nenin 130/a/4 KP (ose dispozita të tjera të këtij neni), duke reflektuar vlerësimin e saj për rrethanat specifike të secilit rast, ose ndryshe nga akuza e prokurorisë ka shpallur të pandehurin të pafajshëm.

b) Lloji dënimit në rastet e deklarimit fajtor të të pandehurit



Në 70.81% të çështjeve të monitoruara gjykatat kanë vendosur dënim me burgim për të pandehurit. Kjo shifër përbën pjesën më të madhe të vendimeve në rastet e deklarimit fajtor dhe përforcon bindjen se masat ndëshkuese të karakterit privues nga liria mbeten instrumenti më i përdorur nga gjykatat për të adresuar përgjegjësinë penale në këtë grup çështjesh.

Nga ana tjetër, janë konstatuar vetëm 11 raste ku është vendosur një masë mjekësore ose edukuese, që përbën 3.18% të totalit. Po kështu, nuk janë konstatuar raste të dënimit me gjobë. Ndërkohë, në 0.29% të çështjeve është vendosur përgjashtim nga dënimi. Për 25.14% të çështjeve të regjistruara nuk mund të përcaktohet lloji i dënimit, për arsye të ndryshme si: për shkak se procesi gjyqësor nuk kishte përfunduar brenda periudhës së monitorimit, kthimi i çështjes për vijim hetimesh ose mungesë e informacionit mbi ecurinë pas seancës paraprake.

c) Alternativat e dënimit me burgim

c.1 Periudha e sigurisë (Neni 65/a KP)

Ky seksion i raportit përqendrohet në pasqyrimin e praktikës gjyqësore në lidhje me zbatimin e nenit 65/a KP, i cili parashikon vendosjen e një periudhe sigurie në rastet e dënimeve me burgim. Në varësi të rrethanave të çështjes, gjykata mund të përcaktojë një periudhë kohore gjatë së cilës nuk mund të aplikohet instituti i lirimit me kusht, i parashikuar në nenin 64 KP.




Në 6.36% të rasteve të monitoruara gjykatat kanë vendosur periudhë sigurie. Në gjykatën e Tiranës është regjistruar një praktikë më e shpeshtë e zbatimit të nenit 65/a, me 21 vendime që kanë përfshirë përcaktimin e periudhës së sigurisë. Në gjykatat e tjera zbatimi rezulton të jetë sporadik ose inekzistent. Analiza tregon një shkallë të ulët të përdorimit të institutit të periudhës së sigurisë, pavarësisht ekzistencës së bazës ligjore për aplikimin e saj.

c.2 Zbatimi i dispozitave për pezullimin e ekzekutimit të vendimit penal me burgim dhe dënime alternative (Neni 59, 59/a dhe 63 KP)

Nga analiza e të dhënave rezulton se në 29.48% të dënimeve me burgim është vendosur pezullimi i ekzekutimit të burgimit dhe zëvendësimi i tij me dënime alternative: *vënie në provë* (neni 59 KP) – 28.3%, *qëndrim në shtëpi* (neni 59/a KP) – 0.4% dhe *detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik* (neni 63 KP) – 0.8%.

Në rast të dënimit me burgim a u aplikua pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim e vënia në provë, neni 59 i KP, qëndrimi në shtëpi, neni 59/a i KP, apo pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes



Në 42.49% të çështjeve nuk është aplikuar ndonjë formë dënimi alternativ, ndërkohë që për 28.03% të rasteve mungon informacioni mbi llojin e dënimit duke qenë se nuk është monitoruar faza e vendimmarrjes gjyqësore. Krahësuar me nenin 59 të Kodit Penal, vihet re se nenet 59/a dhe 63 KP janë përdorur shumë herë më pak nga gjykatat.

c.3 Vlerësimi i caktimit të detyrimeve për personat e dënuar të vendosur në prove (Neni 60 i Kodit Penal)

Ky seksion shqyrton nëse gjykatat, në rastet kur kanë aplikuar nenin 59 KP (vënie në provë), kanë përcaktuar njëkohësisht edhe detyrime shtesë gjatë periudhës së provës. Neni 60 KP parashikon mundësinë që gjykata, përveç pezullimit të dënimit, të caktojë për të dënuarin detyrime që synojnë mbikëqyrjen dhe rehabilitimin social të tij. Në 80.80% të rasteve kur është vendosur pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burg dhe vendosja në provë, gjykatat nuk kanë përcaktuar asnjë detyrim shtesë për të dënuarin për periudhën e provës. Gjykata ka urdhëruar mbajtjen e kontakteve me shërbimin e provës dhe mos kryerjen e një vepre tjetër penale.

Në ato raste kur janë vendosur detyrime, më të zakonshmet janë: ndalimi për të frekuentuar vende të caktuara (6.4%), ndalimi për të shoqëruar persona të caktuar (5.33%), detyrimi për të qëndruar në banesë në orare të përcaktuara (5.33%), detyrimi për t'iu nënshtruar mjekimit, rehabilitimit ose programeve të specializuara në institucione shëndetësore (2.13%).

Ndërkohë, nuk është hasur asnjë rast në të cilin të jetë caktuar detyrimi për të marrë arsimim apo formim profesional, për të shfrytëzuar të ardhurat apo pasurinë për përmbushjen e detyrimeve financiare, apo për të riparuar dëmin civil të shkaktuar nga vepra penale. Këto forma detyrimesh, megjithëse të parashikuara ligjërisht dhe të rëndësishme për aspektin ndëshkues e riedukues të dënimit, nuk rezultojnë të jenë aplikuar praktikisht nga gjykatat gjatë periudhës së monitorimit.

c.4 Zbatimi i dënimeve plotësuese nga gjykatat penale

Sipas nenit 30 të KP, gjykata, përveç dënimit kryesor, mund të vendosë edhe një dënim plotësues, kur kjo konsiderohet e nevojshme për arritjen e qëllimit të ndëshkimit penal. *Për personat që kanë kryer krime ose kundërvajtje penale, bashkë me dënimin kryesor, mund të jepen edhe një ose disa nga këto dënime plotësuese: ndalimi i së drejtës për të ushtruar funksione publike; konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale; ndalimi për të drejtuar automjete; heqja e dekoratave, titujve të nderit; heqja e së drejtës të ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie; heqja e së drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë; ndalimi për të qëndruar në një ose disa njësi administrative; nxjerrja jashtë territorit; detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor; humbja e përgjegjësisë prindërore.*

Të dhënat e grumbulluara nga monitorimi tregojnë se në 52.31% të rasteve nuk është vendosur ndonjë dënim plotësues. Pra, këto vendime nuk përfshijnë ndalim për të qëndruar në një ose disa njësi administrative, detyrim për publikimin e vendimit gjyqësor, apo humbjen e përgjegjësisë. Në 47.69% të rasteve nuk mund të identifikohet kjo e dhënë në mungesë të informacionit të plotë në fazën e monitorimit. Gjithsesi, duhet theksuar se aplikimi i dënimeve

plotësuese nuk është i detyrueshëm në çdo rast, mbetet në diskrecionin e gjykatës, e cila vlerëson domosdoshmërinë e tyre në raport me faktet e rrethanat konkrete të çështjes.

5.2 Arsyetimi i rrethanave të veprës penale dhe rrethanave rënduese të parashikuara në nenin 50 KP

Nga të dhënat e mbledhura rezulton se në rreth 49.85% të çështjeve të monitoruara, gjykatat kanë arsyetuar rrethanat e kryerjes së veprës penale, përfshirë dhe ato rënduese. Ndërkohë, në 27.22% të rasteve mungon një arsyetim i tillë në vendimin gjyqësor. Në 22.94% të çështjeve vlerësimi nuk ka qenë i mundur për shkak të mungesës së vendimit të zbardhur ose se procesi gjyqësor nuk kishte përfunduar në periudhën e monitorimit.

Më poshtë shikojmë cilat nga rrethanat janë argumentuar specifikisht në vendimet gjyqësore: Rrethana më shpesh e arsyetuar ishte ajo e përfitimit nga marrëdhëniet familjare, të bashkëjetesës apo mikpritjes (*neni 50/g i KP*), e cila u evidentua në 34.8% të rasteve. Ndërsa rrethana të tjera të rëndësishme, si ajo e ushtrimit të veprës ndaj personave në gjendje të pambrojtur (*neni 50/e*) apo gjatë/menjëherë pas dhënies së urdhrave të mbrojtjes në kuadër të dhunës në familje (*neni 50/e/1*), janë identifikuar në përqindje shumë më të ulëta – përkatësisht 4.39% dhe 3.51%. Rrethana të tjera me interes të veçantë për garantimin e mbrojtjes ndaj grupeve të cenueshme, si ajo e motivimit të veprës mbi baza gjinore, etnike, shëndetësore apo orientimi seksual (*neni 50/j i KP*) nuk u identifikuan në asnjë nga vendimet e monitoruara. Kryerja e veprës penale pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë (*neni 50/ç KP*) - 0.29%; Kryerja e veprës penale më shumë se një herë dhe në prani të fëmijëve të mitur (*neni 50/h KP*) - 1.75% dhe Kryerja e veprës e shtyrë nga motive të dobëta (*neni 50/a KP*) - 0.29% të rasteve.


Në disa observime të veçanta u vu re një ritëm i përshpejtuar në ecurinë e procesit gjyqësor, të zhvilluara shpesh përmes procedurës së gjykimit të shkurtuar. Në këto raste u evidentua një kalim i shpejtë nga faza e relativitetit në paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare, pa u ndalur në një analizë të thelluar të rrethanave faktike apo të rrethanave rënduese dhe gjendjen psiko-emocionale të viktimës të shkaktuar si pasojë e veprës penale.

Në një rast konkret në Gjykatën e Fierit, u konstatua se gjykata kishte reflektuar mbi rrethanat rënduese, si përsëritja e veprës në prani të fëmijëve, dhe kishte bërë një vlerësim mbi rrezikshmërinë e të pandehurit dhe rrethanat familjare. Megjithatë, në raste të tjera të së njëjtës gjykatë, vendimet përmbanin vetëm një përshkrim të shkurtër të provave dhe normës ligjore të zbatuar, pa një analizë të thelluar të rrethanave rënduese, në përputhje me nenin 50 KP. U identifikuan gjithashtu raste kur gjykata ishte mjaftuar me një konstatim të përgjithshëm se nuk ekzistonin rrethana rënduese, pa e shoqëruar këtë qëndrim me një arsyetim të hollësishëm.

Në këtë kuadër, vlerësohet e nevojshme nxitja e një praktike më të konsoliduar të arsyetimit të rrethanave rënduese në çështjet e DHF dhe DHBGJ, si dhe përdorimi i nenit 50 si një mjet për të reflektuar rrezikshmërinë reale të veprës dhe për të siguruar proporcionalitetin e masës së dënimit. Ky reflektim në këtë pjesë të raportit nisur nga të dhënat e kufizuara nuk synon të japë një vlerësim përfundimtar mbi praktikën gjyqësore, por të shërbejë si një nxitje për zhvillim të mëtejshëm të cilësisë së arsyetimit në vendimet gjyqësore.

5.3 Ushtrimi i të drejtës së ankimit ndaj vendimit të gjykatës

Të dhënat e përpunuara nga monitorimi i 327 çështjeve në shtatë gjykata të shkallës së parë tregojnë se në vetëm 1.83% të rasteve është ushtruar ankimi nga ana e të pandehurit, ndërkohë që në 41.28% të rasteve kjo e drejtë nuk është ushtruar. Për 56.88% të çështjeve nuk mund të përcaktohej statusi i ushtrimit të ankimit për shkak të mungesës së informacionit në momentin e monitorimit ose për shkak se gjykimi nuk kishte përfunduar në kohën e monitorimit.



Gjithashtu, në një numër të kufizuar rastesh është konstatuar se vendimet e marra i përkisnin fazës paraprake të procedimit (dërgimit të çështjes për gjyq), të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, nuk janë të ankimeshme.

5.4 Ndikimi i hartës së re gjyqësore në qasjen e viktimave të DHF dhe DHBGJ në drejtësi efektive

Në këtë pjesë të raportit, vlen të nënvizohet një çështje me rëndësi të veçantë që lidhet me ndikimin e hartës së re gjyqësore në aksesin e viktimave të DHF dhe DHBGJ në sistemin e drejtësisë. Bazuar në vendimin e KLGJ nr. 137, datë 28.03.2023⁷, më 30.04.2023 GJRGJ Krujë ka ndërprerë veprimtarinë dhe çështjet e saj janë transferuar për gjykim tek GjShPJP Tiranë. Bazuar në vendimin e KLGJ nr. 136, datë 28.03.2023⁸, më 30.04.2023 GJRGJ Pukë ka ndërprerë veprimtarinë dhe çështjet e saj janë transferuar për gjykim pranë GjShPJP Shkodër. Bazuar në vendimin e KLGJ nr. 130, datë 28.03.2023⁹, më 30.04.2023 GJRGJ Kavajë ka ndërprerë veprimtarinë dhe çështjet e saj janë transferuar për gjykim pranë GjShPJP Durrës. Bazuar në vendimin e KLGJ nr. 131, datë 28.03.2023¹⁰, më datë 30.04.2023 GJRGJ Lushnjë ka ndërprerë veprimtarinë dhe çështjet e saj janë transferuar për gjykim pranë GjShPJP Fier. Bazuar në vendimin e KLGJ nr. 505, datë 21.11.2022¹¹, Gjykatat e Apelit Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, ndërpresin veprimtarinë më datë 31.01.2023 dhe çështjet gjyqësore të tyre janë transferuar për gjykim pranë GjAJP Tiranë. Viktimat e DHF dhe DHBGJ të cilat kanë vendbanimin e tyre të përhershëm në Pukë, Krujë, Kavajë dhe Lushnjë duhet të udhëtojnë nga larg për të ndjekur proceset gjyqësore penale përkatësisht në GjShPJP Shkodër, Tiranë, Durrës dhe Fier. Ndërsa për gjykimet e shkallës së dytë, viktimat nga i gjithë vendi duhet të vijnë në GjAJP Tiranë.

Gjetjet nënvizojnë se zbatimi i hartës së re gjyqësore ka rritur distancat gjeografike dhe kostot për viktimat e DHF dhe DHBGJ, duke vështirësuar ndjekjen e vazhdueshme të proceseve gjyqësore dhe duke kontribuar në mos-raportimin të dhunës ose heqjen dorë nga ndjekja penale për arsye ekonomike dhe sociale. Një pjesë e konsiderueshme e viktimave ndodhen në pozita të

⁷ <https://klgj.al/media/xcznhnjp/vendim-nr-137-dat%C3%AB-28-03-2023-p%C3%ABr-fillimin-e-funksionimit-t%C3%AB-gjykat%C3%ABs-s%C3%AB-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-t%C3%AB-juridiksionit-t%C3%AB-p%C3%ABrgjithsh%C3%ABm-tiran%C3%AB.pdf>

⁸ <https://klgj.al/media/ctseq10o/vendim-nr-136-dat%C3%AB-28-03-2023-p%C3%ABr-fillimin-e-funksionimit-t%C3%AB-gjykat%C3%ABs-s%C3%AB-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-t%C3%AB-juridiksionit-t%C3%AB-p%C3%ABrgjithsh%C3%ABm-shkod%C3%ABr.pdf>

⁹ <https://klgj.al/media/duafl5aë/vendim-nr-130-dat%C3%AB-28-03-2023-p%C3%ABr-fillimin-e-funksionimit-t%C3%AB-gjykat%C3%ABs-s%C3%AB-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-t%C3%AB-juridiksionit-t%C3%AB-p%C3%ABrgjithsh%C3%ABm-durr%C3%ABs.pdf>

¹⁰ <https://klgj.al/media/lyëasso3/vendim-nr-131-dat%C3%AB-28-03-2023-p%C3%ABr-fillimin-e-funksionimit-t%C3%AB-gjykat%C3%ABs-s%C3%AB-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-t%C3%AB-juridiksionit-t%C3%AB-p%C3%ABrgjithsh%C3%ABm-fier.pdf>

¹¹ <https://klgj.al/media/sunffë4k/vendim-nr-505-dat%C3%AB-21-11-2022-p%C3%ABr-fillimin-e-funksionimit-t%C3%AB-gjykat%C3%ABs-s%C3%AB-apelit-t%C3%AB-juridiksionit-t%C3%AB-p%C3%ABrgjithsh%C3%ABm.pdf>

vështira sociale dhe ekonomike, dhe me përgjegjësi të drejtpërdrejta familjare, siç është kujdesi për fëmijët. Në këto kushte, kostot e transportit, papunësia apo mungesa e dikujt për kujdesin ndaj fëmijëve të mitur, si dhe koha e nevojshme për ndjekjen e proceseve gjyqësore në një qytet tjetër, largimi nga puna ditën e gjyqit e humbja e ditës së punës, përbëjnë barriera reale në përmbushjen e të drejtave të tyre procedurale. Këto vështirësi prekin në mënyrë të veçantë gratë që jetojnë në zona larg selive të gjykatave, ku shpeshherë mungojnë mjetet e transportit publik dhe mekanizmat mbështetës për orientimin e duhur.

Gjatë monitorimit pranë GjShPJP Fier dhe Durrës është evidentuar se viktimat, veçanërisht ato nga zona të largëta si Lushnja, Rrogozhina dhe Kavaja, përballen me vështirësi të mëdha për ndjekjen e proceseve gjyqësore për shkak të kostove të transportit, largësisë së vendbanimit dhe kohës së gjatë të pritjes në gjykatë. Këto pengesa ndikojnë negativisht në pjesëmarrjen e tyre në seanca, ndërsa mungesa e mbështetjes ndihet akoma më shumë kur viktima është i/e mitur.


Nga vëzhgimet del se në rastet kur vendimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar në GjAJP, ndjekja e procesit gjyqësor në apel nga ana e viktimave është bërë dukshëm më e vështirë. Sipas hartës së re gjyqësore funksionon vetëm një gjykatë apeli me seli në Tiranë, e cila ka krijuar distanca të jashtëzakonisht të largëta fizike nga vendbanimi i viktimave që jetojnë në qytete të tjera apo në zona rurale, duke sjellë kosto shtesë financiare të papërballueshme. Si rrjedhojë, në shumë raste, pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e viktimës në seancat gjyqësore të apelit është bërë e pamundur, për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe vështirësive të udhëtimit. Kjo situatë rëndohet edhe më shumë në rastin e viktimave që i përkasin grupeve vulnerabël të shoqërisë (*si p.sh. komuniteti rom dhe egjiptian, gratë kryefamiljare, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, viktimat e trafikimit, të pastrehët, personat në varfëri ekstreme etj*), që nuk mund të përballojnë shpenzimet për transport, akomodim apo shkëputja nga puna mund të jetë me pasojë pushimin nga puna. Madje, me raste, kur viktimat informohen për kohën e gjatë të pritjes për shqyrtimin e ankimit në apel, heqin dorë nga ndjekja e mëtejshme e procedurës.

Ky realitet e bën të nevojshme një vlerësim të vazhdueshëm të ndikimit të hartës së re gjyqësore mbi grupet vulnerabël, me qëllim ndërmarrjen e masave komplementare për të garantuar një akses të barabartë, të shpejtë dhe efektiv në drejtësi.

VI. PROCESI I RREGULLT

6.1 Vlerësimi i respektimit të afateve procedurale gjatë procesit gjyqësor


a) Respektimi i afatit për caktimin e seancës gjyqësore brenda 10 ditëve nga ardhja e çështjes për gjykim



Në këtë kuadër të monitorimit është analizuar respektimi i afatit ligjor për caktimin e seancës gjyqësore brenda 10 ditëve nga momenti i ardhjes së çështjes për gjykim. Sipas statistikave të përpunuara, në 30% të rasteve është konstatuar respektim i afatit procedural; në 34% të rasteve afati nuk është respektuar; ndërsa në 36% të rasteve nuk mund të përcaktohej ky afat për shkak të mungesës së informacionit. Mos respektimi i afatit 10-ditor për caktimin e seancës gjyqësore lidhet ngushtë me faktorë strukturore dhe operacional që kanë ndikuar në ecurinë e rregullt të çështjeve.


Në mënyrë ilustruese, në GjShPJP Fier, ku në periudhën e monitoruar ishin në funksion 8 nga 21 gjyqtarët e parashikuar në organikë, respektimi i afateve procedurale është vështirësuar si rezultat i një ngarkese të madhe mbi gjyqtarët në detyrë. Gjithashtu, në GjShPJP Durrës, janë konstatuar raste ku caktimi i seancave gjyqësore është shtyrë për shkak të rishortimeve të përsëritura.

b) Njoftimi palëve për datën e seancës gjyqësore të paktën 10 ditë para datës së caktuar për gjykim



Në 80.73% të rasteve të analizuara rezulton se palët janë njoftuar brenda afatit të përcaktuar prej të paktën 10 ditësh para datës së seancës. Vetëm në një rast (0.31%) në GjShPJP Fier është konstatuar shkelje e këtij afati, ndërsa në 18.96% të rasteve nuk mund të vlerësohej respektimi afatit për shkak të mungesës së të dhënave.

c) Afati maksimal 15 ditor i ndërprerjes së seancës, shtyrjes së saj për arsye të veçanta



Të dhënat e mbledhura gjatë monitorimit përshkruajnë se në 51.38% të çështjeve është respektuar afati maksimal prej 15 ditësh për shtyrjen e seancave, në 20.80% të çështjeve është tejkaluar ky afat, ndërsa në 27.83% të tyre mungonin të dhënat për vlerësimin e afatit.


Përjashtimisht, në GjShPJP Durrës vërehet një tendencë përmirësimi të respektimit të këtij afati si pasojë e ndryshimeve organizative të ndërmarra që nga tetori 2024. Ndarjen funksionale në dhomën civile dhe penale ka krijuar mundësi më të mira për menaxhimin e ngarkesës dhe për zhvillimin e seancave brenda afateve të parashikuara.

Gjetjet tregojnë se respektimi i afatit 15-ditor për shtyrjen e seancave mbetet një sfidë për një pjesë të gjykatave. Rritja e numrit të gjyqtarëve në funksion, si dhe forcimi i mekanizmave të planifikimit dhe menaxhimit të ngarkesës së punës në gjykata janë hapa të domosdoshëm për të garantuar një respektim të qëndrueshëm të këtij standardi procedural në të ardhmen.

d) Afati maksimal procedural 1 vjeçar për përfundimin e gjykimit të çështjes i përcaktuar si afat i arsyeshëm

Afati maksimal procedural 1 vjeçar për përfundimin e gjykimit të çështjes është përcaktuar si afat i arsyeshëm. Bazuar në të dhënat e mbledhura 63.91% të çështjeve janë përfunduar brenda

afatit 1 vjeçar; 5.81% të çështjeve kanë tejkaluar afatin maksimal; për 30.28% të çështjeve nuk ka informacion mbi kohëzgjatjen e procesit gjyqësor.



Ky rezultat paraqet një nivel relativisht të kënaqshëm për respektimin e afatit procedural, megjithatë, në disa gjykata janë evidentuar pengesa strukturore dhe organizative që kanë ndikuar në tejkalimin e këtij afati.

e) Marrja e vendimit menjëherë pas tërheqjes në dhomën e këshillimit nga gjykata dhe shpallja e tij në mënyrë të përmblodhur



Gjatë monitorimit u konstatua se në 67% të rasteve vendimi është marrë dhe shpallur menjëherë pas tërheqjes në dhomë këshillimi. Në 7% nuk është ndjekur kjo procedurë. Në këto raste vendimi është shpallur menjëherë pas përfundimit të konkluzioneve përfundimtare të palëve, pa u realizuar tërheqja e trupit gjykues në dhomë këshillimi. Gjyqtari ka qëndruar në sallën e gjykimit dhe ka shpallur vendimin pas një ndërprerjeje të shkurtër. Përgjithësisht kjo qasje është vërejtur edhe në rastet kur seanca gjyqësore është zhvilluar në zyrën e gjyqtarit.


Ndërkohë në 26% të rasteve mungonin të dhënat për vlerësim, për shkak të fazës së procesit në të cilin është kryer monitorimi.

Në GjShPJP Fier është vënë re në mënyrë të përsëritur që shpallja e vendimit nuk është bërë menjëherë pas tërheqjes në dhomën e këshillimit. Vendimi në disa raste është shtyrë për tu shpallur në një seancë të mëvonshme, pas një harku kohor që ka variuar nga 1 deri në 14 ditë.

Tërheqja në dhomë këshillimi përbën një moment të rëndësishëm të procesit gjyqësor, i cili i shërben jo vetëm ruajtjes së pavarësisë së trupit gjykues, por edhe krijimit të kushteve të nevojshme për një reflektim të qetë, të matur dhe të paanshëm përpara marrjes së vendimit. Respektimi i kësaj faze kontribuon ndjeshëm në forcimin e besimit të palëve në procesin gjyqësor dhe në sigurimin e një vendimmarrjeje të mbështetur në analizë të plotë të rrethanave dhe provave të çështjes. Në disa raste, është vërejtur se ky moment është anashkaluar.

f) Depozitimi vendimit të arsyetuar brenda 30 ditëve

Depozitimi i vendimit të arsyetuar brenda 30 ditëve nga shpallja e tij përbën një ndër detyrimet e trupit gjykues, pasi lidhet drejtpërdrejt me drejtën e palëve për t'u njohur me arsyetimin ligjor të vendimit dhe për të ushtruar në mënyrë efektive të drejtën e ankimit.



Monitorimi thekson se në vetëm 38.23% të çështjeve vendimi i arsyetuar është depozituar brenda afatit 30-ditor. Ndërkohë, në 24.16% të çështjeve është konstatuar tejkalim i këtij afati, ndërsa në 37.61% të rasteve nuk mund të vlerësohet respektimi i tij për shkak të mungesës së informacionit. Në të gjitha gjykatat vonesat në zbardhjen e vendimeve janë justifikuar kryesisht me ngarkesën e lartë të gjyqtarëve dhe me vakancat në strukturat gjyqësore, që sjellin një rritje të ndjeshme të volumit të çështjeve për gjyqtarët në funksion. Në GjShPJP Elbasan asnjë nga vendimet e monitoruara nuk janë depozituar brenda afatit 30-ditor, duke qenë institucioni me numrin më të lartë të vonesave në zbardhjen e vendimeve.

GjShPJP Tiranë ka numrin më të lartë të vendimeve të arsyetuara të depozituara brenda afatit 30-ditor, duke qenë gjykata me përmbushjen më të lartë të afatit procedural për zbardhjen e vendimeve. [Praktikë pozitive]

Në GjShPJP Durrës, ndonëse një pjesë e vendimeve të monitoruara rezultuan të depozituara me vonesë, vihet re një përmirësim i lehtë krahasuar me periudhat e mëparshme të raportimit. Kjo lidhet, ndër të tjera, me ndarjen strukturore të gjykatës në dhoma penale dhe civile, e cila ka ndikuar në shpërndarjen më të balancuar të ngarkesës së punës.

Duke pasur parasysh rëndësinë që ka afati 30-ditor, rekomandohet ndihma administrative dhe përforsimi i strukturave mbështetëse që mund të kontribuojnë në lehtësimin e ngarkesës së gjyqtarëve dhe rritjen e efektivitetit në përmbushjen e këtij detyrimi ligjor.

Analizë mbi faktorët ndikues në respektimin e afateve procedurale në tërësi në të gjitha gjykatat

Respektimi i afateve procedurale garanton gjykim të drejtë e në kohë dhe përbën tregues kyç të besueshmërisë në sistemin gjyqësor, përballë sfidave të tij organizative dhe strukturore. Gjatë vitit kalendarik 2024, gjykatat në të gjithë vendin kanë shqyrtuar dhe përfunduar 45,666 çështje penale, duke reflektuar një angazhim të vazhdueshëm institucional për përsheptimin e proceseve gjyqësore dhe përmirësimin e aksesit në drejtësi në terma kohorë. Statistikat tregojnë një përmirësim domethënës në kohën mesatare të zgjidhjes së çështjeve penale, ku: 92.4% e çështjeve janë përfunduar brenda një periudhe më të shkurtër se 6 muaj; 5.2% janë zgjidhur brenda 6 deri në 12 muaj; 2% janë përfunduar brenda një harku kohor 1 deri në 2 vjet; vetëm 0.4% e çështjeve kanë zgjatur më shumë se 2 vjet¹².

Pavarësisht progresit të arritur, monitorimi zbulon se ka disa faktorët që ndikojnë në mos respektimin e afateve procedurale, që lidhen jo me mungesë vullneti apo neglizhencë nga ana e gjykatave, por me rrethana të jashtme që kanë impaktuar drejtpërdrejt në ecurinë e proceseve gjyqësore. Në mënyrë të veçantë, është vërejtur se ngarkesa e lartë e punës, mungesa e burimeve të mjaftueshme njerëzore, transferimet dhe efektet e procesit të rivlerësimit kalimtar (vettingut) kanë qenë ndër shkaqet kryesore që kanë penguar respektimin e plotë të afateve procedurale.

Ngarkesa e lartë e gjyqtarëve vjen si rrjedhojë e numrit të lartë të çështjeve të regjistruara në emër të secilit gjyqtar, por edhe numrit të lartë të seancave që zhvillohen brenda ditës. Çështjet

¹² Raport vjetor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, viti 2024, fq. 119 <https://klgj.al/media/1bhpy5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>

me natyrë të ndërlikuar kërkojnë kohë për studimin e dosjes dhe hartimin e vendimeve të arsyetuara. Në këto kushte përmbushja e afateve procedurale bëhet gjithmonë e më e vështirë. Në disa prej gjykatave, si ajo e Fierit, Durrësit dhe Elbasanit, situata është ndërlikuar më tej për shkak të numrit të ulët të gjyqtarëve në detyrë, çka ka sjellë rritje të ndjeshme të ngarkesës për trupat gjyqësore ekzistuese, për pasojë ka sjellë mos respektim të afateve procedurale.

Gjithashtu, procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përmes ndërprerjes së seancave, ri-shortimet e çështjeve në mënyrë të përsëritur, ka shkaktuar vonesa në përfundimin e proceseve gjyqësore. Po ashtu edhe transferimet.

Një faktor tjetër që vijon të ndikojë negativisht në treguesit e eficiencës së sistemit gjyqësor është numri i ulët i gjyqtarëve. Plotësimi i pozicioneve të lira në përputhje me strukturat organizative të gjykatave, veçanërisht në gjykatat me ngarkesë të lartë dhe intensitet të shtuar të çështjeve, është thelbësor për përmirësimin e kapaciteteve funksionale të sistemit dhe uljen e ngarkesës për gjyqtarët aktualë. Sipas të dhënave të raportuara nga KLGJ në raportin vjetor për vitin 2024, numri i vakancave në sistem aktualisht është 136¹³ gjyqtarë. Këto mungesa përbëjnë një pengesë serioze për garantimin e një drejtësie efikase dhe në kohë. Situata në gjykatat e monitoruar gjatë vitit 2024, paraqitet¹⁴ si më poshtë:

- GjShPJP Berat ka funksionuar me 6 gjyqtarë efektivë nga 8 të parashikuar në strukturë, që përbën 75% të kapacitetit.
- GjShPJP Durrës ka funksionuar me 16 gjyqtarë efektivë nga 23 të parashikuar në strukturë, që përbën 69.57% të kapacitetit të saj.
- GjShPJP Elbasan ka funksionuar me 13 gjyqtarë efektivë nga 18 të miratuar në strukturë, që përbën 72.22% e kapacitetit.
- GjShPJP Fier ka funksionuar me 17 gjyqtarë efektivë nga 21 të parashikuar në strukturë, që përbën 80.95% të kapacitetit.
- GjShPJP Shkodër ka funksionuar me 10 gjyqtarë efektivë nga 15 të parashikuar në strukturë, që përbën 66.67% të kapacitetit.
- GjShPJP Tiranë ka funksionuar me 55 gjyqtarë, nga 80 të miratuar në strukturën organizative, që përbën 68.75% të kapacitetit të saj.
- GjShPJP Vlorë ka funksionuar me 12 gjyqtarë nga 16 të parashikuar në strukturë, që përbën 75% e kapacitetit të saj.

Ngarkesa mesatare e punës në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm ka qenë rreth 750 çështje për gjyqtar gjatë vitit 2024. Ndërsa sipas gjykatave, gjatë vitit 2024, ngarkesa mesatare e punës në GjShPJP Beratit është rreth 961.2 çështje për gjyqtar; në GjShPJP Durrësit - 991.5 çështje për gjyqtar; në GjShPJP Elbasanit - 1001.4 çështje për gjyqtar; në GjShPJP Fierit - 674.5 çështje për gjyqtar; në gjykatën GjShPJP - 722.7 çështje për gjyqtar; në GjShPJP Tiranës - 1005.9 çështje për gjyqtar; në gjykatën e Vlorës - 603.9 çështje për gjyqtar¹⁵. Këto të dhëna evidentojnë një situatë të vazhdueshme të nënkapacitetit funksional në shumicën e gjykatave, mbingarkesës së gjyqtarëve, duke theksuar nevojën për përsheptimin e procesit të emërimeve të gjyqtarëve aktivë në detyrë, në përputhje me strukturën organizative të gjykatave.

¹³ Raport vjetor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, viti 2024, fq. 109 <https://klgj.al/media/1bhpy5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>

¹⁴ Raport vjetor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, viti 2024, fq. 109 <https://klgj.al/media/1bhpy5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>

¹⁵ Raport vjetor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, viti 2024, fq. 113 <https://klgj.al/media/1bhpy5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>

Të dhënat e vitit 2024 dëshmojnë për një trend pozitiv në drejtim të përmirësimit të performancës së gjykatave, veçanërisht në kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve. Prania e një niveli të lartë të backlog-ut në fund të vitit kërkon rritjen e numrit të stafit mbështetës, forcimin e kapaciteteve logjistike e dixhitale me qëllim administrimin më efikas të çështjeve gjyqësore dhe garantimin e një drejtësie të aksesueshme e të arsyeshme në kohë për të gjithë qytetarët.

6.2 Shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore

Nga analizimi i të dhënave të monitorimit, rezulton se: 31% e seancave u zhvilluan pa u shtyrë; 50.13% e seancave janë shtyrë, ndërsa në 18.87% të rasteve nuk ka të dhëna mbi këtë aspekt. Ndër rastet e shtyrjeve, 16.44% përfaqësojnë seancat ku arsyet nuk janë përcaktuar qartë.

Shkaqet që kanë ndikuar më së shumti në shtyrjen e seancave gjyqësore, lidhen kryesisht me: nevojën për kohë shtesë për përgatitjen me shkrim të diskutimeve përfundimtare nga ana e prokurorëve, avokatëve dhe përfaqësuesve ligjorë (8.36%), për shkak të shpalljes së vendimit (3.50%), prej mungesës së prokurorit (2.96%), prej mungesës ose mos njoftimit të të pandehurit (2.70%), dhe prej mungesës së viktimës si pasojë e mos njoftimit të saj në mënyrë të rregullt (2.70%). Përveç këtyre rasteve më të shpeshta, shtyrjet janë diktuar edhe nga një sërë faktorësh të tjerë, të cilët janë të pasqyruar në detaje në këtë grafik.



Në dy raste të veçuara është konstatuar se, pas paraqitjes së pretendës nga ana e prokurorisë për “*dënimin me burgim të të pandehurit dhe konvertimin e këtij dënimi në një dënim alternativ, konkretisht “punë në dobi të publikut”, në përputhje me parashikimet e nenit 63 të KP*”, mbrojtja ka kërkuar shtyrjen e seancës. Kjo pasi aplikimi i këtij dënimi alternativ kërkon pëlqimin e

shprehur personalisht nga i pandehuri, çka e bën të domosdoshme praninë e tij fizike në sallën e gjyqit për dhënien e këtij pëlqimi përpara gjykatës.

Mungesa në seanca e avokatëve të të pandehurve është evidentuar në 1.08% të çështjeve, ndërsa ajo e prokurorëve në 2.96%. Në një rast, mungesa e prokurorit është arsyetuar me angazhime institucionale për shkak të pjesëmarrjes në zgjedhjet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Megjithatë, në disa raste të tjera, mungesa e përsëritur e përfaqësuesit të akuzës nuk është shoqëruar me justifikim zyrtar nga organi i prokurorisë. Në një rast konkret pranë Gjykatës së Tiranës, i pandehuri i është drejtuar gjykatës me kërkesë për t'i kërkuar zyrtarisht prokurorisë shpjegime lidhur me mungesat e përsëritura të prokurorit në seanca të njëpasnjëshme.


Rreth 8.36% e shtyrjeve të seancave lidhen me kërkesat për kohë shtesë për përgatitjen me shkrim të diskutimeve përfundimtare, si nga prokuroria ashtu edhe nga mbrojtja. Në disa raste, shtyrja është kërkuar nga prokuroria për të përgatitur kërkesën me shkrim për ndryshimin e akuzës. Arsye të tjera për shtyrjen e seancave përfshijnë: shtyrjen për shpalljen e vendimit (3.50%), mos formimi/ndryshimet në përbërjen e trupës gjyquese, heqjen dorë të gjyqtarit nga shqyrtimi për konflikt interesi, arsye shëndetësore, ndarjen e çështjes për bashkëpandehurit në mungesë, kthimin e aktit për plotësime nga prokuroria, mungesën e të pandehurit - për shkak të pamundësisë për transport nga IEVP, mos gjetjen e të pandehurit apo mosparaqitjen në Institutin e Mjekësisë Ligjore. Po ashtu, janë evidentuar shtyrje për shkak të kërkesave për administrimin e provave të reja, thirrjen/mungesës së ekspertëve, kërkesave të ekspertit për kohë shtesë për përgatitjen e aktit të ekspertimit, si dhe për shkak të kërkesave të avokatëve për njohje me dosjen apo për caktimin e një avokati kryesisht nga gjykata apo prej mospajtimit të të pandehurit me avokatin kryesisht.

Mungesa e dëshmitarëve në seancë mbetet një problem i përsëritur. Në këto raste, gjykatat kanë lëshuar urdhra për shoqërimin e detyrueshëm të dëshmitarëve, ndërsa kur mungesa është justifikuar me arsye shëndetësore, policia është urdhëruar të verifikojë gjendjen përmes kanaleve zyrtare. Gjithashtu, është vënë re se hasen vështirësi në njoftimin e viktimave në adresën e regjistruar në aktet procedurale. Në fletëthirrje shfaqen shënime si “i larguar”, “adresë e pasaktë” ose “nuk gjendet”, çka shkakton vonesa në procesin gjyqësor. Kjo situatë nënvizon nevojën për saktësimin e adresave, me qëllim garantimin e njoftimit të rregullt të viktimave.

Rezultatet e monitorimit tregojnë se, ndonëse një pjesë e shtyrjeve janë të justifikuara dhe në përputhje me standardet e një procesi të rregullt ligjor, ato mbeten një faktor që kontribuon ndjeshëm në vonesa të përsëritura dhe në zvarritje sistematike të procedimeve gjyqësore.

6.3 Kohëzgjatja e procedimeve gjyqësore

Kohëzgjatja e procedimeve gjyqësore nga seanca e parë deri në shpalljen e vendimit



Sipas të dhënave të përpunuara, 29.05% e çështjeve janë përmbyllur që në seancën e parë gjyqësore. Më tej vërehet se: në 2.75% e çështjeve vendimi është shpallur brenda 2–10 ditësh nga

seanca e parë; në 7.34% brenda 11–28 ditësh, dhe 5.81% kanë kërkuar një periudhë prej 1 muaji. Në total, rreth 15.9% e çështjeve janë përmbyllur brenda një muaji kalendarik, duke krijuar një segment tjetër pozitiv të trajtimit të çështjeve në kohë të shkurtër.

Në rastet kur proceset kanë zgjatur më tej, përqindjet tregojnë një përhapje më të gjerë, por brenda kufijve që konsiderohen të arsyeshëm në praktikën gjyqësore: në 3.98% të çështjeve vendimi është shpallur rreth 1.5 muaj pas seancës së parë, në 3.06% në 2 muaj, dhe 2.75% në 4 muaj. Këto të dhëna dëshmojnë për një prani të rëndësishme të çështjeve që përmbyllen në një periudhë midis 1 deri në 4 muaj. Pavarësisht performancës së mirë në një pjesë të çështjeve, identifikohen gjithashtu raste që zgjaten në mënyrë të ndjeshme:


- Rreth 8.6% e çështjeve kanë zgjatur më shumë se 4 muaj, përfshirë periudha prej 5 deri në 8 muaj (me përqindje nga 0.61% deri në 2.14% për secilën kategori).
- Ka raste të izoluar që janë përmbyllur pas 10, 12, 13, 15 muajsh, si dhe raste që kanë zgjatur 1.5 deri në 2 vjet, megjithëse përqindja e këtyre mbetet e ulët (0.31%–0.61%).

Ndërsa për 32.42% të çështjeve të monitoruara, nuk ka pasur të dhëna mbi kohëzgjatjen e procesit nga seanca e parë deri në shpalljen e vendimit.

Të dhënat e paraqitura tregojnë se një pjesë e mirë e çështjeve përmbyllen brenda afateve të arsyeshme, çka flet për tregues pozitiv të sistemit në menaxhimin e çështjeve. Megjithatë, ekzistenca e një përqindjeje jo të vogël të rasteve me zgjatje shqetësuese që sinjalizojnë për nevojën e vazhdueshme për përmirësim në terma kohorë të gjykimit dhe për forcim të mekanizmave të raportimit dhe kontrollit të brendshëm.

Në kuadër të monitorimit, janë ndërmarrë përpjekje për të vlerësuar kohën që ka kaluar ndërmjet momentit të marrjes së vendimit nga gjyqtari i seancës paraprake (*apo edhe nga data e depozitimit të vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake*) dhe momentit të zhvillimit të seancës së parë gjyqësore për shqyrtimin e çështjes në themel. Megjithatë, për shkak të kufizimeve në marrjen e informacionit, në një numër të konsiderueshëm rastesh nuk ka qenë e mundur të sigurohen të dhëna të plota kohore për fazën e seancës paraprake në raport me momentin e fillimit të gjykimit në themel. Kjo është ndikuar nga fakti se disa çështje janë ndjekur vetëm gjatë një ose disa seancave, të cilat kanë përkuar me faza të ndryshme të procesit gjyqësor, përfshirë ato ku janë paraqitur konkluzionet përfundimtare ose është shpallur vendimi. Gjithashtu, duke qenë se dosjet gjyqësore nuk kanë qenë të aksesueshme për monitoruesit, është vështirësuar sigurimi i informacionit të plotë mbi ecurinë e proceseve. Si rrjedhojë, raporti nuk përfshin të dhëna të plota mbi kohëzgjatjen ndërmjet fazave të ndryshme të procesit gjyqësor.

6.4 Pretendime të palëve mbi kohën për të paraqitur kërkesa procedurale



Nga të dhënat rezulton se në rreth 7.65% të rasteve të monitoruara janë shënuar pretendime të tilla nga ana e palëve. Në 77.06% të çështjeve nuk janë regjistruar pretendime mbi kohën për të paraqitur kërkesa procedurale, ndërsa për 15.29% të rasteve mungon informacioni për këtë pikë.

Në GjShPJP Fier pretendimet për kohë të pamjaftueshme lidheshin me kërkesa për shtyrje të seancave për të përgatitur diskutimet përfundimtare në formë të shkruar, për të siguruar praninë

e të pandehurit në seancë, për paraqitjen e provave materiale apo dëshmitarëve, si dhe për t'u njohur në mënyrë të plotë me përmbajtjen e dosjes gjyqësore.

Ndërkohë në GjShPJP Vlorë ka pasur pretendime se gjykata nuk ka lënë kohën e mjaftueshme për viktimën për të siguruar prova (*nxjerrja e vendimeve nga arkiva e gjykatës kërkon kohë*), apo në disa raste gjykimi i shkurtuar ka qenë në kundërshtim me interesat e viktimës, e cila në raste të tilla nuk mund të kërkojë marrjen e provave të tjera në gjykim për shkak se çështja zgjidhet në gjendjen që janë aktet.

Ndërkohë, në një rast të regjistruar pranë GjShPJP Tiranë, i pandehuri ka paraqitur një kërkesë ndaj gjykatës për të komunikuar me organin e prokurorisë, në lidhje me mungesën e vazhdueshme të prokurorit në disa seanca gjyqësore, mungesë e cila kishte çuar në shtyrjen e përsëritur të seancave pa një justifikim të dokumentuar. Kjo rrethanë është konsideruar nga i pandehuri si pengesë në realizimin e të drejtës së tij për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

6.5 Vlerësimi i paanshmërisë së gjyqtarëve gjatë gjykimit të çështjeve penale

Gjatë monitorimit në 7 gjykata e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, vlerësimi mbi paanshmërinë e gjyqtarëve është gjendur shumë pozitiv. Në 95.11% të rasteve gjyqtarët janë perceptuar si të paanshëm, të pavarur, duke demonstruar sjellje profesionale, integritet dhe respekt të vazhdueshëm ndaj të gjitha palëve në procesin penal. Ndërsa në 4.89% të rasteve nuk mund të bëhej një vlerësim në mungesë të kushteve për konkluzion të qartë nga ana e monitorueseve.

Gjyqtarët janë treguar korrektë, të kujdesshëm në zbatimin e procedurave gjyqësore apo garantimin e të drejtës së fjalës për të gjithë pjesëmarrësit në proces, si dhe siguruan një trajtim dinjitoz e të barabartë të palëve, pa shfaqur tendenca paragjyqëse apo favorizuese. Gjyqtarët kanë respektuar dispozitat e KP, KPrP, KDPM dhe Kodit të Etikës Gjyqësore, duke garantuar që procedura të zhvillohej në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme. Vendimmarrja është bazuar në provat, faktet dhe rrethanat e çështjes. Gjyqtarët kanë siguruar që secila prej palëve të kishte mundësinë dhe kohën e mjaftueshme për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur argumentet dhe provat përkatëse. Është vlerësuar gjithashtu se gjyqtarët kanë lejuar rregullisht përfaqësuesin ligjor apo mbrojtësin ligjor të viktimës të shprehë qëndrimet dhe kërkesat në përputhje me ligjin.

Në disa raste kur ekzistonte rreziku i konfliktit të interesit, gjyqtarët kanë ndërmarrë vetë iniciativën për të hequr dorë nga gjykimi i çështjes duke treguar një përgjegjshmëri të lartë profesionale, në përputhje me standardet e drejtësisë së paanshme. Në veçanti, viktimat e mitura janë trajtuar me një vëmendje të shtuar. Gjatë këtyre seancave, gjyqtarët kanë siguruar praninë e psikologëve dhe kanë marrë masa për të krijuar kushte komode e sa më të ndjeshme nga pikëpamja emocionale dhe gjinore, duke dëshmuar një qasje të kujdesshme ndaj nevojave të veçanta të këtyre kategorive të cënueshme. Ata kanë demonstruar objektivitetin në vlerësimin e provave, kujdes në drejtimin e pyetjeve, duke marrë parasysh jo vetëm natyrën e komplikuar të çështjes, por edhe gjendjen psikologjike e emocionale të palëve, raportet ndërmjet tyre dhe parandalimin e viktimizimit të përsëritur dhe ri viktimizimit të viktimave të krimit dhe pakësimin e ndikimit traumatizues të pjesëmarrjes së tyre në procesin penal.

VII. ETIKA E GJYQTARIT DHE SOLEMNITETI I GJYKIMIT

7.1 Respektimi i etikës gjyqësore dhe solemnitetit në gjykim


Në 93.58% të çështjeve u konstatua se gjykimi u zhvillua në përputhje me rregullat e solemnitetit dhe normat e etikës gjyqësore. Nuk u evidentua asnjë rast ku këto standarde të ishin shkelur. Në 6.42% të rasteve nuk mund të bëhej një vlerësim për shkak të mungesës së kushteve për konkluzion të qartë nga ana e monitorueseve. Gjyqtarët ruajtën komunikim të qetë, korrekt dhe profesional me të gjitha palët e përfshira në proces. Ata menaxhuan me kujdes dinamikën e sallës

së gjyqit, ndërhyjnë vetëm kur ishte e nevojshme për të ruajtur rendin dhe për të siguruar një zhvillim të qetë dhe të balancuar të procesit gjyqësor. Gjyqtarët kanë dëgjuar me vëmendje prezantimin e fakteve dhe arsyesimit ligjor të paraqitur nga palët dhe mbrojtësit e tyre. Disa seanca janë zhvilluar në salla gjykimi dhe disa të tjera në zyrat e gjyqtarëve për shkak të mungesës së sallave ose si rezultat i planifikimit paraprak. Megjithatë, edhe në këto kushte, është vënë re ruajtja e toneve profesionale dhe respektimi i rregullave bazë të solemnitetit gjyqësor.

Në përfundim, meriton të theksohet se sjellja dhe qasja e gjyqtarëve ndaj etikës institucionale, solemnitetit të gjykimit dhe barazisë procedurale të palëve ka qenë në përputhje me standardet më të mira të drejtësisë dhe me pritshmëritë që parashikon legjislacioni shqiptar dhe instrumentet ndërkombëtare për një proces të rregullt dhe të paanshëm. [Praktikë pozitive]

7.2 Respektimi i orarit të fillimit të seancës gjyqësore

Respektimi i orarit të fillimit të seancave gjyqësore ndikon drejtpërdrejt në perceptimin publik për profesionalizmin e gjykatave dhe përdorimin racional të kohës së palëve të përfshira në proces. Monitorimi evidentoi se në një pjesë të konsiderueshme të rasteve orari i fillimit të seancës gjyqësore nuk është respektuar. Rreth 52.60% e seancave gjyqësore kanë filluar në orarin e parashikuar. Ndërkohë, në 41.90% të rasteve është konstatuar një fillim i vonuar i seancës gjyqësore. Për 5.50% të seancave të monitoruara nuk ka informacion për orarin e saktë të fillimit.



Ky rezultat zbulon një prani ende të ndjeshme të praktikës së vonesave, e cila meriton vëmendje të posaçme për të identifikuar faktorët që e nxisin dhe për të përmirësuar më tej standardin e zhvillimit të seancave gjyqësore. Nga vëzhgimet në terren është vënë re një prirje e përhapur drejt fillimit me vonesë të seancave gjyqësore, ku vonesat kanë variuar nga 6 minuta deri mbi 2 orë. Ky fenomen vjen si rezultat i një sërë faktorësh, ndër të cilët përmenden:

- Zgjatja përtej parashikimit e seancave të mëparshme, duke ndikuar zinxhir në kalendarin e ditës së një gjyqtari ose trupe gjykuese;
- Angazhimi i prokurorëve në seanca të tjera që kanë zgjatur përtej orarit të parashikuar, çka e detyron trupin gjykues të presë prokurorin për fillimin e seancës;
- Mungesa e sallave të lira për zhvillimin paralel të proceseve, çka e detyron trupin gjykues dhe palët të presin lirimin e ambienteve për fillimin e seancave;
- Mbingarkesa e trupit gjykues me seanca dhe angazhimi paralel në seanca të tjera, shpesh përtej kapaciteteve optimale;
- Kalendarizimi i seancave nuk pasqyron kohëzgjatjen reale të proceseve. Seancat planifikohen nga gjyqtarët çdo 10 apo 15 apo 30 minuta, ndërkohë që kohëzgjatja e një seance mund të variojë nga 5 minuta deri në 60 minuta apo më gjatë;
- Pritja e palëve për të përfunduar procedurat e kontrollit në sektorin e sigurisë e për të hyrë në ambientet e brendshme të gjykatës (sallë gjykimi apo zyrën e gjyqtarit).

Në gjykatat e monitoruara, proceset zhvillohen në një numër të kufizuar sallash, të cilat shpesh janë të zëna për shkak të mbingarkesës së kalendarit gjyqësor. Këto salla gjykimi janë të pamjaftueshme për numrin e gjyqtarëve të gjykatës dhe numrin e lartë të seancave që zhvillohen

brenda së njëjtës ditë dhe paralelisht në të njëjtin orar. Rrjedhimisht, palët e përfshira në proces janë të detyruar të presin për kohë të gjatë, e të papërcaktuar. Në rastet kur një seancë e mëparshme zgjat tej parashikimit – veçanërisht në çështje me shumë të pandehur apo komplekse – zhvillimi i çështjeve të tjera të planifikuara për të njëjtën ditë e për të njëjtin trup gjykues shtyhet në kohë, duke sjellë pritje të gjata për palët në korridore apo në hollin e gjykatës. Palët shpesh mbeten të paqartë mbi kohën reale të nisjes së gjykimit.

Zakonisht gjykata në fillim të procesit gjyqësor informon palët prezent për arsyet e vonesës në gjykim. Në disa raste është konstatuar mungesë e komunikimit në lidhje me arsyet e vonesës së seancës gjyqësore. Kjo praktikë vihet re kryesisht kur seancat zhvillohen në zyrën e gjyqtarit. Vonesat në fillimin e seancës gjyqësore ndikojnë ndjeshëm në përvojën e përdoruesve të sistemit të drejtësisë. Pritjet e zgjatura në këmbë, pa kushte minimale komoditeti, shpesh pa informim të qartë, shkaktojnë stres, lodhje dhe pakënaqësi tek palët në proces. Për viktimat që vijnë nga zona larg bashkisë ku ndodhet gjykata, situata vështirësohet më shumë.

Ambientet e pritjes në gjykata janë të mbipopulluara, nuk sigurojnë vende të mjaftueshme për ulje, dhe gjykata nuk ofron informacion të qartë mbi statusin e seancave sa i përket kohës së fillimit. Në mënyrë të veçantë, pranë GjShPJP Tiranë, është vërejtur një praktikë ku një pjesë e madhe e karrigeve në holl mbahen të rezervuara vetëm prej avokatëve kryesisht, të cilët pengojnë uljen e qytetarëve.

Përvojë pozitive e konstatuar në GjShPJP Tiranë, në rastet kur palët në proces e kanë pasur të vështirë ngjithjen në katet e sipërme të gjykatës ku ndodhej zyra e gjyqtarit për arsye shëndetësore, gjyqtari e ka zhvilluar seancën në katin e parë në njërin nga sallat e gjykimit që është liruar më shpejt. [Praktikë pozitive]

Shpesh, palët janë detyruar të presin për një kohë të gjatë, pa marrë informacion zyrtar mbi statusin e seancës (*p.sh. kur seancat janë me vonesë, shtyrë ose kur mungon gjyqtari përgjegjës*). Punonjësit e sigurisë dhe të sekretarisë së gjykatës, që në praktikë përbëjnë pikën e parë të kontaktit me publikun sapo futesh në ambientet e gjykatës, nuk janë të pajisur gjithmonë me informacion për të gjitha gjykimet që do të zhvillohen brenda ditës në mënyrë që të ofrojnë udhëzime të sakta për qytetarët. Nuk është i instaluar në ambientet e pritjes së publikut një sistem informues elektronik që të tregojë statusin e seancave (*në zhvillim, vonesa në orar, shtyrë në një datë tjetër, të përfunduara*). Në mungesë të këtij sistemi, palët mbeten pa informacion dhe përballen me vështirësi në orientim. Ka pasur raste kur seancat janë shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtarit, por palët kanë vijuar të presin në gjykatë për minuta të tëra për zhvillimin e seancës për të cilën janë thirrur, pa ndonjë njoftim paraprak zyrtar të afishuar apo të komunikuar verbalisht nga stafi.

Gjetjet e monitorimit dëshmojnë se, pavarësisht përpjekjeve të gjykatave për të menaxhuar kalendaret gjyqësorë dhe burimet e kufizuara, vonesat mbeten një dukuri e shpeshtë dhe ndikojnë negativisht në përvojën e përdoruesve të drejtësisë. Këto problematika kërkojnë ndërmarrjen e masave konkrete në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës fizike, organizimit të brendshëm dhe transparencës së komunikimit me qytetarët në rast vonesash.

7.3 Respektimi i/e viktimës dhe avokatit/es së tij/saj nga gjyqtari/ja

7.3.1 Qëndrimi i gjykatave ndaj viktimave

Një prej elementëve të monitorimit ka qenë vlerësimi i mënyrës së trajtimit të viktimës gjatë procesit penal. Në të gjitha rastet kur viktimat ka qenë prezente gjatë gjykimit, në seancat gjyqësore të monitoruara u evidentua një qasje profesionale, e ndjeshme dhe e respektueshme ndaj viktimës. Gjyqtarët treguan kujdes të veçantë në komunikimin me viktimën duke përdorur një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme, si dhe në sigurimin e kushteve të përshtatshme në sallën e gjyqit. Brenda kufizimeve që imponon infrastruktura fizike e gjykatës, janë marrë masa për të vendosur viktimën në një distancë të përshtatshme nga i pandehuri, me qëllim shmangien e kontaktit dhe

ndjesisë së pasigurisë gjatë zhvillimit të seancës. Viktimave iu dha hapësira e nevojshme për të shprehur qëndrimet e tyre. Në rastet kur viktimat përjetonte vështirësi emocionale, u tregua ndjeshmëri dhe u respektua e drejta për të mos dhënë deklaratime. Po ashtu, është siguruar mbështetja nga persona të besuar apo profesionistë të fushës psiko-sociale gjatë seancave. Gjykatat u përpoqën në shumicën e rasteve t'i jepnin viktimës informacion të qartë mbi të drejtat që u njihen gjatë procesit penal. Përfaqësuesit ligjorë të viktimave kanë pasur mundësi për të paraqitur pretendimet, kërkesat dhe përfundimet në emër të tyre.

Gjatë tryezës së përbashkët të organizuar nga QNL për ndarjen e gjetjeve paraprake të monitorimit, me pjesëmarrjen e profesionistëve të ligjit, përfaqësuesja e një organizate që punon për mbrojtjen e të drejtave të grave rome nënvizoi se shumë prej tyre hasin pengesa në kuptimin dhe ndjekjen e procedurave ligjore, për shkak të njohurive të kufizuara në gjuhën shqipe – *në të shkruar, në lexim dhe në të folur* – duke qenë se komunikimi i tyre i përditshëm bëhet në gjuhën e komunitetit rom. Në mungesë të mbrojtësit ligjor, këto vështirësi manifestohen në të gjitha hallkat e sistemit, përfshirë procedurat pranë policisë, prokurorisë e gjykatave. Në këtë kontekst, prej kësaj organizate u theksua nevoja për të siguruar një person ndihmës që mund të vijë nga organizatat rome të shoqërisë civile (*njohës/e i/e gjuhës rome*), i/e cili/a mund të lehtësojë komunikimin ndërmjet vajzave/grave të komunitetit rom viktimat të DHF dhe DHBGJ dhe institucioneve të drejtësisë. Një lehtësues komunikimi do të ndihmonte që këto gra të kuptojnë qartë zhvillimet procedurale, të njohin të drejtat e tyre dhe të marrin pjesë në mënyrë të informuar në proceset që i prekin drejtpërdrejt. Ky propozim synon të kontribuojë në rritjen e aksesit real në drejtësi dhe në respektimin e të drejtave procedurale për një ndër grupet më të marginalizuara në shoqëri.

Gjatë monitorimeve të kryera në shtatë gjykata të vendit është konstatuar një numër shumë i kufizuar rastesh ku viktimat e DHF dhe DHBGJ i përkisnin komunitetit rom – zakonisht një deri në tre raste për gjykatë – çka nuk lejon nxjerrjen e konkluzioneve të plota mbi nevojën për lehtësim gjuhësor. Megjithatë, në rastet e evidentuara, gjykatat kanë trajtuar viktimat në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, duke treguar në disa raste edhe kujdes të shtuar për të adresuar nevojat e tyre. Nuk janë konstatuar vështirësi në komunikim, por rekomandohet vijimi i monitorimeve për të siguruar një vlerësim më të thelluar e të dedikuar mbi qasjen e këtij komuniteti në sistemin e drejtësisë në aspektin gjuhësor.

Gjetjet e këtij monitorimi pasqyrojnë praktikat gjyqësore në trajtimin e viktimës gjatë procesit penal, duke evidentuar një tendencë pozitive drejt respektimit të standardeve të një gjykimi të ndjeshëm dhe gjithëpërfshirës. Është e rëndësishme të theksohet se në rastet e monitoruara, viktimat janë trajtuar në mënyrë të barabartë me palët e tjera, pa bërë dallime ose trajtime të pabarabarta që lidhen me karakteristikat personale apo shoqërore. Konkretisht, nuk janë evidentuar raste të diskriminimit në bazë të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, shtetësisë, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore apo shoqërore, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, karakteristikave të seksit, statusit HIV/AIDS, shtatzënisë, përkatësisë apo përgjegjësisë prindërore, moshës, statusit familjar ose martesor, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, pamjes së jashtme, aftësisë së kufizuar apo çdo karakteristike tjetër personale. Kjo qasje gjithëpërfshirëse dhe jo-diskriminuese meriton vlerësim për kontributin në krijimin e një sistemi drejtësie të ndjeshëm dhe të barabartë për të gjitha palët në proces. [Praktikë pozitive]

7.3.2 Qëndrimi i gjykatave ndaj avokatëve të viktimave


Në të gjitha rastet e monitoruara ku viktimat kanë qenë të përfaqësuara nga një avokat, është vërejtur një përfshirje aktive e mbrojtësit ligjor në të gjitha fazat e shqyrtimit gjyqësor. Gjykatat kanë mundur pjesëmarrjen efektive të përfaqësuesve të viktimës përmes ushtrimit të

të drejtave për të paraqitur kërkesa procedurale, për të bërë pyetje, si dhe për të kontribuar në administrimin e provave dhe në diskutimet përfundimtare.

Në një rast në GjShPJP Tiranë, gjykata refuzoi njohjen formale të avokatit si përfaqësues ligjor të viktimës në mungesë të një prokure përfaqësimi, në përputhje me kërkesat e KPrP. Pavarësisht këtij kufizimi formal, gjykata lejoi prezencën fizike dhe pjesëmarrjen joformale të avokatit në diskutimet në seancë, duke ndjekur një qasje që synonte ruajtjen e të drejtës thelbësore të viktimës për të marrë mbështetje ligjore gjatë procesit penal. Ky qëndrim dëshmon një vullnet për të mos ndërtuar barriera të panevojshme në ushtrimin e të drejtave nga viktimat, duke kombinuar rregullsinë procedurale me ndjeshmërinë në trajtimin e viktimave. [Praktikë pozitive]

Të dhënat e monitorimit tregojnë një përmirësim domethënës në drejtim të përfshirjes së avokatëve të viktimës dhe respektimit të rolit të tyre në procesin penal. Pjesëmarrja e avokatit të viktimës duhet të trajtohet si një standard i pandashëm i procesit të rregullt ligjor, jo vetëm për të garantuar mbrojtjen e të drejtave individuale, por edhe për sigurimin e barazisë së palëve dhe për të përforcuar besimin e viktimave në sistemin e drejtësisë penale.

7.4 Kohëzgjatja e seancës gjyqësore



Për çështjet për të cilat u siguruan të dhëna të plota, shohim se kohëzgjatja e seancave gjyqësore ka variuar sipas natyrës dhe kompleksitetit të çështjeve të trajtuara. Të dhënat pasqyrojnë se 25.64% e seancave kanë zgjatur deri në 10 minuta, ndërsa rreth 9.52% janë mbyllur brenda intervalit 11–15 minuta. Kjo fashë mund të pasqyrojë trajtimin e çështjeve të thjeshta, seanca ku janë ndërmarrë veprime procedurale formale ose shtyrje për arsye të ndryshme. Nga ana tjetër, rreth 19.41% e proceseve janë zhvilluar brenda intervalit 56–60 minuta, e cila mund të tregojë një angazhim më të thelluar në shqyrtimin e provave, dëgjimin e palëve, dëshmitarëve dhe diskutimin e kërkesave të paraqitura në sallën e gjyqit. Gjithashtu, rreth 13.19% përfshijnë seanca me kohëzgjatje 16-30 minuta, 10.62% nga 31 deri në 40 minuta, ndërsa raste më të rralla janë regjistruar seanca me zgjatje mbi 60 minuta – për shembull, vetëm 0.37% e seancave zgjatën midis 65–70 minutash.

Ky grafik reflekton fleksibilitetin kohor që një proces penal ka për t’iu përshtatur kërkesave specifike të çdo çështjeje. Të dhënat mbi kohëzgjatjen e seancave shërbejnë si bazë për të kuptuar ngarkesën e gjyqtarëve me seanca gjyqësore të gjata në kohë, si dhe për analizë më të hollësishme mbi menaxhimin e ngarkesës dhe përmirësimin e efikasitetit të sistemit të drejtësisë.

7.5 Njoftimi i përfundimit të procesit gjyqësor

Shpalljes së dispozitivit të vendimit përbën një ndër momentet më të rëndësishme në funksion të transparencës dhe aksesit në drejtësi. Monitorimi nënvizon se në 79.51% të rasteve dispozitivi i vendimit gjyqësor është shpallur në seancë publike, në prani të palëve, dhe është

publikuar në faqen zyrtare të gjykatës gjykata.gov.al, në rubrikën përkatëse të secilës çështje “vendimi përfundimtar”. Kjo praktikë përputhet me kërkesat e nenit 384 të KPrP, i cili parashikon që shpallja e dispozitivit të vendimit të kryhet në seancë gjyqësore nga kryetari ose një anëtar i trupit gjykues. Nga ana tjetër, në 20.49% të rasteve nuk mund të verifikohet nëse dispozitivi i vendimit është shpallur për shkak se seanca e shpalljes së vendimit nuk është monitoruar.

VIII. REFERIMI NË STANDARDET NDËRKOMBËTARE

8.1 Referimi i standardeve dhe akteve ndërkombëtare nga palët në gjykimin penal

Monitorimi përshkruan se në një rast në GjShPJP Durrës është bërë referim në një normë ndërkombëtare nga ana e palëve.

Në 18 raste është referuar jurisprudenca e GJEDNJ nga palët në proces, konkretisht në GjShPJP Elbasanit janë realizuar numri më i madh të referimeve (13 raste), Durrës (3 raste) dhe Vlorë (2 raste).

Nga ana tjetër, nuk është konstatuar asnjë referim nga palët në proces në të drejtën e Bashkimit Evropian (*siç janë Direktivat e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, Vendimet Kuadër, etj.*), apo në raportet e organizatave ndërkombëtare: CEDAW, GREVIO dhe UPR për Shqipërinë. Nga kjo gjetje vërehet një mosnjohje ose neglizhencë ndaj mekanizmave ndërkombëtarë mbikëqyrës, të cilët raportojnë në mënyrë periodike mbi zbatimin e konventave ndërkombëtare nga ana e Shqipërisë.

Në 4 raste është bërë referim nga palët në proces në Konventën e Stambollit (*Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*), konkretisht në GjShPJP Elbasanit (3 raste) dhe Beratit (1 rast).

Gjetjet e mësipërme evidentojnë një përdorim të kufizuar të standardeve dhe akteve ndërkombëtare nga palët në gjykimet penale. Mungesa e referimeve në gjykata si Tirana, Fieri dhe Shkodra tregon një nevojë të qartë për forcimin e kapaciteteve të palëve në proces në këtë drejtim. Kjo përfshin jo vetëm rritjen e njohurive por edhe zhvillimin e aftësive praktike për integrimin e e tyre në argumentimin juridik dhe në aktet procedurale.

Përjashtim pozitiv, si rasti i Gjykatës së Elbasanit, tregon se aplikimi i standardeve ndërkombëtare varet ndjeshëm nga niveli i ndërgjegjësimit dhe angazhimit të aktorëve në proces. [Praktikë pozitive]

8.2 Referimi i standardeve apo akteve ndërkombëtare nga gjykata në vendimin përfundimtar

Normat ndërkombëtare janë referuar në 13 vendime, kryesisht në Gjykatën e Elbasanit (6 referime), Fierit (6 referime) dhe Vlorës (1 referim).

Jurisprudenca e GJEDNJ është referuar në 39 vendime, kryesisht në Gjykatën e Elbasanit (25 raste), Fierit (7), Beratit (4) dhe Durrësit (3).

E drejta e BE është referuar në 29 vendime, kryesisht në Gjykatën e Elbasanit (22 raste), Durrësit (4 raste), Fierit (2 raste) dhe Tiranës (1 rast). Në këtë të fundit u citua edhe një rekomandim i Këshillit të Evropës për mbipopullimin e burgjeve, si burim orientues ndërkombëtar.

Raportet e organizatave ndërkombëtare janë cituar vetëm një herë nga Gjykata e Fierit, duke treguar përdorim minimal të këtij burimi, me gjithë rëndësinë e tij për analizën faktike dhe politikat penale.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës është referuar në 37 vendime, kryesisht në Gjykatën e Elbasanit (29 raste), Beratit (5 raste), Fierit (1 rast), Shkodrës (1 rast) dhe Durrësit (1 rast).

KEDNJ është përmendur në 16 vendime, kryesisht nga Gjykata e Fierit (8 raste), Beratit (7 raste) dhe Elbasanit (1 rast). Përdorimi mbetet i ulët, pavarësisht rëndësisë së saj.

Konventa e Stambollit (*Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*) është cituar në 39 vendime, kryesisht nga Gjykata e Elbasanit (29 raste), Fierit (8 raste) dhe Beratit (2 raste).

CEDAW (Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave), e cila përbën një nga instrumentet themelore të së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e grave dhe promovimin e barazisë gjinore, fatkeqësisht nuk është referuar asnjëherë. Kjo mungesë nënkupton se parimet dhe standardet që lidhen me barazinë gjinore nuk janë ende të integruara në mënyrë sistematike në arsyetimin dhe vendimmarrjen gjyqësore, veçanërisht në çështjet që trajtojnë dhunën ndaj grave. Kjo situatë nënvizon nevojën për rritje të ndërgjegjësimit dhe formim të thelluar profesional për gjyqtarët lidhur me përdorimin e CEDAW si një burim ligjor i detyrueshëm dhe i rëndësishëm për mbrojtjen efektive të të drejtave të grave.

Vendimet e GJEDNJ: “*Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë*” referuar nga Gjykata Berat, si dhe “*Van Mechelen dhe të tjerë kundër Vendeve të Ulëta*”, “*Berham kundër Shqipërisë*”, “*Caka kundër Shqipërisë*”, dhe “*Khaidov kundër Rusisë*” - nga Gjykatat e Fierit, Elbasanit dhe Durrësit.

Nga të dhënat del në pah se Gjykata e Elbasanit ka numrin më të lartë të referimeve të akteve e standardeve ndërkombëtare në vendimet përfundimtare, ndjekur nga Gjykata e Fierit. Në të gjitha gjykatat bie në sy tendenca tek magjistratët e rinj për të referuar standardet dhe aktet ndërkombëtare në arsyetimin ligjor të vendimit gjyqësor. Kjo praktikë e përdorimit të burimeve ndërkombëtare në arsyetimin gjyqësor duhet inkurajuar dhe zgjeruar më tej në të gjitha juridiksionet. [Praktikë pozitive]

Ndërkohë, disa juridiksione si Tirana, Shkodra dhe Vlora shfaqin mungesë të referimit të burimeve ndërkombëtare në vendimet gjyqësore.

Me Programin Tematik 3-vjeçar për formimin vazhdues 2024–2027¹⁶ Shkolla e Magjistraturës ka parashikuar një program për të forcuar kapacitetet e aktorëve të sistemit të drejtësisë në trajtimin e çështjeve që lidhen me DHF dhe DHBGJ. Moduli i posaçëm “*Dhuna me bazë gjinore*” përfshin trajnim të thelluar mbi standardet ndërkombëtare dhe detyrimet që burojnë nga aktet kryesore si Konventa e Stambollit, Rekomandimet e GREVIO dhe CEDAW, si dhe praktika e GJEDNJ. Në program janë përfshirë edhe temat e lidhura me aksesin në drejtësi për gratë, shmangien e stereotipeve gjinore dhe rrethanat cilësuese që lidhen me to. Vëmendje i kushtohet gjithashtu dimensionit bashkëkohor të dhunës, që përfshin dhunën dixhitale dhe krimet e urrejtjes, duke reflektuar zhvillimet më të fundit në legjislacionin e BE-së dhe në rekomandimet ndërkombëtare. Ky modul duket premtues në drejtim të forcimit të kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për të nxitur një qasje më të ndjeshme dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të dhunës me bazë gjinore.

Gjyqtarët shqiptarë në përgjithësi referohen kryesisht në KP dhe KPrP gjatë arsyetimit të vendimeve të tyre. Megjithatë, vetëm disa vendime përmbajnë referenca ndaj konventave të ratifikuara nga shteti shqiptar dhe kjo nuk përbën një praktikë të unifikuar. Për të përmirësuar këtë situatë, është e nevojshme të zhvillohen më shumë trajnime për gjyqtarët, me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre në integrimin sistematik të standardeve dhe akteve ndërkombëtare në arsyetimin juridik, si dhe për të forcuar ndërgjegjësimin gjyqësor për përdorimin e tyre si burim interpretimi ligjor.

¹⁶ Shkolla e Magjistraturës, Programi tematik 3-vjeçar 2024-2027, Programi i Formimit Vazhdues, Modul XIII “Dhuna me bazë gjinore”, fq. 15-16. <https://www.magjistratura.edu.al/sq/programi-i-trajnimeve>

IX. REKOMANDIME

Në vijim të monitorimit të zhvilluar pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe në bazë të gjetjeve të dala në këtë raport, paraqiten më poshtë disa rekomandime që synojnë të kontribuojnë në rritjen e efektivitetit institucional të gjykatave, garantimin e të drejtave të viktimave të DHF dhe DHBGJ në procesin penal, si dhe përmirësimin e përgjithshëm të qasjes në drejtësi për këtë kategori të cenueshme.

Këto rekomandime kanë për qëllim të ndihmojnë institucionet përgjegjëse për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave, në lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës, në adresimin më të plotë të problematikave të evidentuara gjatë monitorimit dhe në forcimin e praktikave gjyqësore në përputhje me standardet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare.

➤ Monitorimi i zbatimit të urdhrave të mbrojtjes dhe masave mbrojtëse për viktimat e DHF dhe DHBGJ

1. Forcimi i koordinimit ndërinstitutional për parandalimin dhe trajtimin e DHF dhe DHBGJ, si dhe për reduktimin e përsëritjes së saj pas ndërmarrjes së masave mbrojtëse, përmes një qasjeje të unifikuar midis organeve të drejtësisë, strukturave të rendit dhe shërbimeve sociale në nivel vendor.
2. Forcimi i zbatimit të ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” përmes mbikëqyrjes më rigoroze të urdhrave të mbrojtjes dhe vendimeve gjyqësore, si dhe përmirësimit të bashkëpunimit ndërinstitutional ndërmjet gjykatave, prokurorisë, policisë dhe shërbimeve sociale, me qëllim sigurimin e mbrojtjes efektive të viktimave dhe parandalimin e shkeljeve të urdhrave të mbrojtjes.
3. Rekomandohet që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me NJVV-të, të kryejë monitorim periodik të funksionimit dhe efektivitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit në të gjithë vendin. Përmirësimi i funksionimit të MKR në nivel vendor duhet të shoqërohet me mbledhje të rregullta të të dhënave mbi menaxhimin e rasteve të DHF dhe DHBGJ, me fokus të veçantë tek rastet me rrezik të lartë për përsëritje të dhunës, me qëllim fuqizimin e përgjigjes institucionale dhe rritjen e efektivitetit të MKR në mbrojtje të viktimave.
4. Rekomandohet që të gjitha NJVV-të të përmbushin detyrimin ligjor për emërimin e një punonjësi me kohë të plotë, në një pozicion të qëndrueshëm dhe të dedikuar për funksionin e Koordinatorit/es Vendor/e kundër Dhunës në Familje. KVVDHF i/e dedikuar është thelbësor për funksionimin efektiv të mekanizmit të referimit dhe garantimin e një reagimi të koordinuar dhe të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje. Gjithashtu, do të mundësojë monitorim më efikas të zbatimit të vendimeve për lëshimin UMM/UM.
5. Rritja e kapaciteteve të strukturave vendore në ndërtimin e rrjeteve referuese efikase, në monitorimin e zbatimit të UMM/UM, si dhe në identifikimin e rasteve me rrezik shkeljeje të UM/UMM, përmes trajnimeve të specializuara dhe shtimit të burimeve njerëzore.
6. Sugjerohet krijimi dhe shtrirja në të gjitha qarqet e vendit e programeve rehabilituese për dhunuesit, në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit dhe praktikat e mira ndërkombëtare.

➤ Respektimi i të drejtave të viktimës në hetim dhe gjykim

1. Zbatimin nga organi i prokurorisë të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm për asistimin dhe garantimin e të drejtave të viktimave lidhur me njoftimin e letrës së të drejtave viktimës së veprës penale, informimin mbi gjendjen e procedimit, si dhe njohjen me aktet dhe provat kur kjo gjë kërkohet nga viktimat ose mbrojtësi ligjor.
2. Përdorimi i gjuhës së thjeshtë, të kuptueshme e të ngadaltë nga gjykata gjatë dhënies së informacionit, veçanërisht kur viktimat nuk përfaqësohet me avokat ose kur ka vështirësi në të kuptuarin e procedurave ligjore.
3. Unifikimi i praktikës gjyqësore mbi njoftimin e letrës së të drejtave të viktimës, në përputhje me nenin 58/2 të KPrP. Rekomandohet mbajtja e procesverbalit të njoftimit për të drejtat e viktimës si praktikë detyruese nga gjykata.
4. Zgjerimi i monitorimit edhe në fazën e hetimit paraprak për të siguruar një vlerësim gjithëpërfshirës të respektimit të të drejtave të viktimës. Në mënyrë të veçantë, rekomandohet vlerësimi i praktikës së njoftimit të letrës së të drejtave të viktimës nga ana e prokurorit.
5. Njoftimi i viktimës për lirim nga burgu të dhunuesit.

➤ **Përdorimi i padisë civile në procesin penal**

1. Forcimi i kapaciteteve të institucioneve të drejtësisë për të siguruar që viktimat të informohen plotësisht për të drejtat e tyre në proceset penale, përfshirë edhe të drejtën për të kërkuar kompensim civil.
2. Zbatimi efektiv i skemës së mbrojtësve ligjorë falas për viktimat, duke garantuar asistencë në ngritjen e padisë civile në procesin penal.

➤ **Njoftimi i viktimës për zhvillimin e gjykimit penal**

1. Është e nevojshme që institucionet përgjegjëse për administrimin e regjistrit të adresave të shtetasve shqiptarë të angazhohen në rishikimin e sistemit ekzistues dhe në përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave të kontaktit e vendbanimeve të qytetarëve. Një sistem funksional adresash do të lehtësonte procesin e njoftimit gjyqësor, do të minimizonte vonesat dhe do të garantonte përfshirje më efektive të viktimës në procesin penal.

➤ **Aplikimi i mbrojtjes ligjore falas për viktimat e veprës penale**

1. Rekomandohet që DNJF të kryejë mbledhje dhe monitorim periodik të të dhënave të detajuara mbi çështjet penale dhe civile të lidhura me DHF dhe DHBGJ, për të cilat viktimat kanë përfituar avokat falas. Kjo do të mundësojë një vlerësim të efektivitetit të skemës së ndihmës juridike të garantuar nga shteti, evidentimin e sfidave me të cilat përballen viktimat dhe ndërmarrjen e masave konkrete për të garantuar përfitimin real të mbrojtjes ligjore dhe përmirësimin e politikave ndërinstitucionale në mbështetje të tyre.
2. Rekomandohet rritja e nivelit të informimit dhe ndërgjegjësimit të viktimave të veprave penale të DHF dhe DHBGJ mbi të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike falas, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Në këtë kuadër, sugjerohet hartimi dhe shpërndarja e materialeve informuese në një gjuhë të thjeshtë, të kuptueshme dhe të përshtatur për nevojat e viktimave, të vendosura pranë sporteleve të prokurorive dhe gjykatave, në

mënyrë që t'u vihen në dispozicion viktimave në momentin që paraqiten për të kërkuar informacion mbi çështjen e tyre

3. Rekomandohet forcimi i mekanizmave të bashkëpunimit dhe referimit ndërinstytucional midis gjykatave, prokurorive dhe DNJF, me qëllim orientimin e qartë të viktimave drejt përfitimit të ndihmës juridike falas. Megjithëse ndihma juridike falas është e disponueshme, praktika tregon se mungesa e informacionit dhe e orientimit adekuat nga ana e organeve proceduese mbetet një pengesë reale për aksesin e viktimave në këtë shërbim.

➤ **Shërbimet mbështetëse për viktimat e veprës penale**

1. Rekomandohet hartimi dhe shpërndarja e një liste të përditësuar të kontakteve të pikave fokale të institucioneve, duke përfshirë gjykatat, prokuroritë, policinë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, OJF-të të angazhuara në mbrojtjen e viktimave të DHF dhe DHBGJ, si dhe çdo aktor tjetër institucional me rol në mbështetjen e tyre. Një listë e tillë do të shërbente si mjet orientues për organet proceduese — veçanërisht gjykatat, prokuroritë dhe policinë — duke lehtësuar procesin e referimit të rasteve drejt strukturave përkatëse mbështetëse dhe duke përmirësuar qasjen e viktimave në ndihmën e nevojshme, sipas nevojave specifike psiko-sociale, ligjore ose të strehimit emergjent, etj.
2. Rekomandohet që lista e kontakteve të strukturave që ofrojnë mbështetje për viktimat e dhunës të shpërndahet në rrugë zyrtare ndërmjet aktorëve kyç të përfshirë në trajtimin e rasteve. Kjo do të forconte bashkëpunimin ndërinstytucional dhe do të krijonte një mekanizëm gjithëpërfshirës dhe të koordinuar për referimin dhe mbrojtjen e viktimave. Një qarkullim i tillë garanton që asnjë hallkë e zinxhirit institucional të mos mbetet jashtë procesit të ndërveprimit dhe të përgjegjësisë për sigurimin e mbrojtjes efektive. Edhe pse këto shërbime janë të disponueshme, mungesa e informimit dhe orientimit adekuat nga organet proceduese kufizon realisht përfitimin e viktimave prej tyre.
3. Mbetet thelbësore që organet proceduese të respektojnë dhe zbatojnë në mënyrë sistematike detyrimin ligjor për informimin e viktimave mbi mundësitë e aksesit në shërbimet mbështetëse. Informimi duhet të bëhet në gjuhë të kuptueshme dhe të shoqërohet me materiale të qarta, duke garantuar që viktima të jetë e pajisur me informacion të plotë mbi vendndodhjen dhe funksionimin e strukturave mbështetëse.
4. Rekomandohet zgjerimi i gamës së shërbimeve mbështetëse të specializuara për trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave DHF dhe DHBGJ në të gjitha qarqet, duke përfshirë edhe krijimin e shërbimeve të reja për grupet ende të pambuluara që fuqizojnë viktimen gjatë gjithë procesit penal. Gjithashtu, sugjerohet monitorimi periodik i efektivitetit të këtyre shërbimeve nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore me qëllim përmirësimin e reagimit institucional ndaj rasteve të dhunës.

➤ **Infrastruktura e gjykatave**

1. Rekomandohet përmirësimi i infrastrukturës në ambientet e gjykatave për krijimin e kushteve për ruajtjen e distancës së nevojshme fizike ndërmjet të pandehurit dhe viktimës, veçanërisht në rastet me natyrë sensitive ose me ngarkesë të lartë emocionale.

2. Rekomandohet vlerësimi i mundësive për zgjerim të kapaciteteve infrastrukturore e logjistike të gjykatave duke shtuar sallat e gjykimit, veçanërisht në gjykatat me ngarkesë të lartë të çështjeve.
3. Rekomandohet përmirësimi i kushteve të pritjes në ambientet e gjykatës, përmes shtimit të vendeve ulëse dhe krijimit të një hapësire pritjeje të strukturuar për palët, duke respektuar standardet e dinjitetit dhe aksesit për të gjithë qytetarët.

➤ **Provat gjatë gjykimit penal**

1. Rekomandohet përdorimi i ekspertizës psiko-sociale dhe psikologjike gjatë hetimeve dhe gjykimit për të kuptuar ndikimin e dhunës psikologjike tek viktimat e DHF dhe DHBGJ.
2. Sugjerohet trajnimi i vazhdueshëm të gjyqtarëve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore mbi vlerësimin e kujdesshëm dhe mënyrat e identifikimit të rasteve kur ndryshimi i qëndrimi i viktimës mund të jetë rezultat i presionit psikologjik, varësisë ekonomike apo ndikimeve të tjera të jashtme. Në këtë kuadër, rekomandohet përfshirja sistematike e ekspertëve psiko-socialë në procesin e vlerësimit kur viktima ndryshon deklaratimet gjatë fazave të ndryshme të procedurës, me qëllim ndriçimin e plotë të rrethanave që mund të ndikojnë në autenticitetin dhe qëndrueshmërinë e dëshmisë së saj.
3. Rekomandohet zbatimi i standardeve uniforme për administrimin e provave, veçanërisht mbi trajtimin e deklaratave noteriale të dorëzuara nga viktima si provë, kur ajo zbut ose tërhiqet nga qëndrimet fillestare. Këto dokumente duhet të vlerësohen me kujdes, në kontekstin e plotë të rrethanave, për të ruajtur vlerën provuese të deklaratimeve të dhëna dhe për të garantuar që funksioni parandalues i drejtësisë penale të ruhet, duke shmangur rrezikun e mosndëshkueshmërisë së dhunës në familje.
4. Është e rëndësishme që gjatë procesit gjyqësor të merren në konsideratë ndikimet që lidhjet familjare, gjendja ekonomike apo nevojat e kujdesit ndaj fëmijëve mund të kenë në sjelljen e viktimës. Çdo vendimmarrje gjyqësore duhet të synojë të reflektojë një balancë ndërmjet interesit të drejtësisë, mbrojtjes së viktimës dhe parandalimit të përsëritjes së dhunës në të ardhmen.

➤ **Përmirësimi performancës së gjykatave dhe garantimi i respektimit të afateve procedurale**

1. Rekomandohet rritja e numrit të gjyqtarëve efektivë në detyrë, në përputhje me strukturat organizative dhe ngarkesën aktuale të çdo gjykate. Kjo masë është e domosdoshme për përballimin e ngarkesës së lartë dhe për përmirësimin e treguesve të eficiencës në sistemin gjyqësor, sidomos në gjykatat me ngarkesë të lartë.
2. Thellimi i procesit të digjitalizimit të shërbimeve gjyqësore do të lehtësojë aksesin e qytetarëve, do të përmirësojë menaxhimin e çështjeve dhe do të reduktojë ndjeshëm kohën e përpunimit nga ana e stafit të gjykatës dhe ruajtjes së dokumentacionit gjyqësor.
3. Sugjerohet zbatimi i afateve standarde minimale kohore për gjykimin e çështjeve, me qëllim rritjen e efikasitetit të gjykatave dhe përmirësimin e kohës mesatare të trajtimit të çështjeve, veçanërisht atyre me natyrë sensitive, si çështjet që lidhen me DHF dhe DHBGJ. Paralelisht, rekomandohet monitorim sistematik i brendshëm nga Kryetarët e Gjykatave

dhe KLGJ të respektimit të këtyre afateve dhe identifikimin e rasteve me rrezik për tejkalim të tyre.

4. Zbatimin e vendimit nr. 242, datë 29.04.2025 të KLGJ “*Mbi krijimin e njësisë së shërbimit ligjor pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, gjykatave administrative të shkallës së parë dhe gjykatës së posaçme të shkallës së parë për korrupsionin dhe krimin e organizuar*”. Ngritjen dhe funksionimin sa më parë të Njësisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, e cila do të ndihmojë gjyqtarët në reduktimin dhe përballimin e ngarkesës.
5. Performanca e gjyqësorit në respektimin e afateve mund të përmirësohet edhe nëpërmjet rritjes së kapaciteteve mbështetëse të gjyqtarëve me sekretarë gjyqësorë/staf mbështetës jo gjyqtar për delegimin e detyrave të caktuara në lidhje me çështje të thjeshta nga gjyqtari te stafi i gjykatës, e cila do të ndikonte në një menaxhim më efektiv të ngarkesës gjyqësore.
6. Rekomandohet që organet e prokurorisë të ndërmarrin masa për garantimin e pjesëmarrjes së rregullt të përfaqësuesve të akuzës në seancat gjyqësore, në mënyrë që të shmanget shtyrja e seancave dhe zvarritja e proceseve gjyqësore për shkak të mungesës së tyre. Kjo kërkon përmirësim të koordinimit të brendshëm dhe të mekanizmave të përgjegjshmërisë institucionale.
7. Forcimi i standardeve të efikasitetit gjyqësor: Rekomandohet që gjykatat të vijojnë të nxisin përmbylljen e çështjeve brenda një afati të arsyeshëm, duke balancuar të drejtën për një proces të drejtë me nevojën për një gjykim pa zvarritje.

➤ **Përmirësimi i përvojës së qytetarëve dhe digjitalizimi shërbimeve gjyqësore**

1. Rekomandohet që gjykatat të kryejnë monitorim periodik mbi respektimin e orarit të fillimit të seancave gjyqësore, si dhe të raportojnë rastet e vonesave. Qëllimi i këtij monitorimi është identifikimi dhe analizimi i shkaqeve të vonesave, si dhe përmirësimin e efikasitetit të proceseve gjyqësore.
2. Rekomandohet instalimi i një ekrani elektronik në ambientet e pritjes së publiku në gjykatë që pasqyron në kohë reale statusin e seancave gjyqësore: *kohën e nisjes, vonesat, shtyrjet apo mungesën e gjyqtarit, arsyet e vonesave ose shtyrjeve, sallën në të cilën do të zhvillohet gjykimi*. Në mungesë të këtij sistemi, të përdoren forma alternative të njoftimit të menjëhershëm përmes email-it apo sms në pikat e kontaktit të deklaruara nga palët. Ky sistem do të lehtësonte ndjeshëm orientimin e qytetarëve dhe do të kontribuonte në rritjen e transparencës mbi zhvillimin e çështjeve.
3. Rishikimi i menaxhimit të sallave ekzistuese, me qëllim optimizimin e përdorimit të tyre dhe planifikimin më racional të çështjeve.

➤ **Barrierat gjuhësore që hasin viktimat e komunitetit rom**

1. Për të garantuar qasje efektive dhe të barabartë në drejtësi për gratë dhe vajzat e komunitetit rom, rekomandohet që institucionet e drejtësisë – përfshirë policinë, prokurorinë dhe gjykatat – të sigurojnë ndihmës komunikimi gjatë procedurave gjyqësore për viktimat që hasin vështirësi në komunikim, në bashkëpunim me organizatat përfaqësuese të komunitetit rom. Gjithashtu, rekomandohet zhvillimi i një monitorimi të dedikuar për

identifikimin dhe adresimin e barrierave gjuhësore që kufizojnë qasjen e këtij komuniteti në drejtësi, me qëllim garantimin e aksesit të barabartë dhe efektiv në proceset gjyqësore.

➤ **Harta gjyqësore**

1. Harta e re gjyqësore ka sjellë ndikime të ndjeshme në aksesin në drejtësi për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Këto vështirësi prekin në mënyrë të veçantë gratë që jetojnë në zona larg selive të gjykatave, ku shpeshherë mungon infrastruktura, transporti publik dhe aksesimi i informacionit apo shërbimeve mbështetëse për orientim ligjor dhe institucional. Kjo situatë e bën të domosdoshëm një vlerësim të vazhdueshëm të ndikimit të hartës së re gjyqësore mbi grupet vulnerabël, me qëllim ndërmarrjen e masave komplementare që garantojnë akses të barabartë, të shpejtë dhe efektiv në drejtësi.

➤ **Referimi i standardeve dhe akteve ndërkombëtare në praktikën gjyqësore**

1. Rekomandohet që Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Shkolla e Magjistraturës të organizojnë trajnime të vazhdueshme dhe të specializuara për avokatët, prokurorët dhe gjyqtarët, me fokus njohjen dhe përdorimin praktik të jurisprudencës së GJEDNJ, të së drejtës së BE-së, standardeve ndërkombëtare dhe raporteve të organizmave ndërkombëtarë mbi DHF dhe DHBGJ, përfshirë instrumente si CEDAW, KEDNJ dhe Konventa e Stambollit. Këto trajnime synojnë jo vetëm rritjen e njohurive, por edhe integrimin e këtyre standardeve në procesin e arsyetimit dhe vendimmarrjes gjyqësore, duke përforcuar cilësinë e vendimeve penale që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të viktimave dhe paraqitjen e akuzës nga organi i prokurorisë.

X. BIBLIOGRAFIA

Konventa dhe akte të tjera ndërkombëtare

- Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

Ligje dhe akte nënligjore

- Ligj nr. 37/2017 Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur
- Ligj nr. 7895, datë 27.1.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar
- Ligj nr. 7905, datë 21.3.1995 Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar
- Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar
- Ligj nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
- Ligji nr. 9052, datë 17.4.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Protokollin shtesë të “Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”
- Vendim i KLGJ nr. 171, datë 22.04.2021 “Për miratimin e Kodit të Etikës Gjyqësore”
<https://klgj.al/media/cp3h334p/vendim-nr-171-dat-%C3%AF-22-04-2021-p-%C3%AF-miratimin-e-g%C3%A7-kodi-i-etik-%C3%AFs-gjyq-%C3%AFsoreg%C3%A7-postuar-m-30-04-2021.pdf>
- Vendimin e KLGJ nr. 137, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.
<https://klgj.al/media/xcznhnjp/vendim-nr-137-dat%C3%AB-28-03-2023-p%C3%ABr-fillimin-e-funksionimit-t%C3%AB-gjykat%C3%ABs-s%C3%AB-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-t%C3%AB-juridiksionit-t%C3%AB-p%C3%ABrgjithsh%C3%ABm-tiran%C3%AB.pdf>
- Vendimin e KLGJ nr. 136, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër”.
<https://klgj.al/media/ctseq10o/vendim-nr-136-dat%C3%AB-28-03-2023-p%C3%ABr-fillimin-e-funksionimit-t%C3%AB-gjykat%C3%ABs-s%C3%AB-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-t%C3%AB-juridiksionit-t%C3%AB-p%C3%ABrgjithsh%C3%ABm-shkod%C3%ABr.pdf>
- Vendimin e KLGJ nr. 130, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.
<https://klgj.al/media/duafl5aë/vendim-nr-130-dat%C3%AB-28-03-2023-p%C3%ABr-fillimin-e-funksionimit-t%C3%AB-gjykat%C3%ABs-s%C3%AB-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-t%C3%AB-juridiksionit-t%C3%AB-p%C3%ABrgjithsh%C3%ABm-durr%C3%ABs.pdf>
- Vendimin e KLGJ nr. 131, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”.
<https://klgj.al/media/1yëasso3/vendim-nr-131-dat%C3%AB-28-03-2023-p%C3%ABr-fillimin-e-funksionimit-t%C3%AB-gjykat%C3%ABs-s%C3%AB-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-t%C3%AB-juridiksionit-t%C3%AB-p%C3%ABrgjithsh%C3%ABm-fier.pdf>
- Vendimin e KLGJ nr. 505, datë 21.11.2022 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”. <https://klgj.al/media/sunffë4k/vendim-nr-505-dat%C3%AB-21-11-2022-p%C3%ABr-fillimin-e-funksionimit-t%C3%AB->

[gjykat%C3%ABs-s%C3%AB-apelit-t%C3%AB-juridiksionit-t%C3%AB-p%C3%ABrgjithsh%C3%ABm.pdf](#)

Strategji, programe

- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe plani i saj i veprimt
- Plan i Strategjik i Këshillit të Lartë Gjyqësor për Sistemin Gjyqësor të Republikës së Shqipërisë 2022-2024 https://klgj.al/media/rv0pkk2i/plani-strategjik-final_2022-2024.pdf
- Vendim i KLGJ nr. 251, datë 09.05.2024 “Për miratimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata” <https://klgj.al/media/4hfdmq1b/vendim-nr-251-dat%C3%AB-09-05-2024-p%C3%ABr-miratimin-e-strategjis%C3%AB-p%C3%ABr-uljen-e-numrit-t%C3%AB-%C3%A7%C3%ABshtjeve-t%C3%AB-prapambetura-n%C3%AB-gjykata.pdf>
- Shkolla e Magjistraturës, Programi tematik 3-vjeçar 2024-2027, Programi i Formimit Vazhdues, Modul XIII “Dhuna me bazë gjinore”

Udhëzime

- Udhëzim i përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm nr. 08, datë 15.11.2021 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitar”
- Udhëzim i përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm nr. 17, datë 23.12.2020 “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje, dhe dhunës me bazë urrejtje”
- Udhëzim i Prokurorit të Përgjithshëm nr. 03, datë 25.11.2013 “Për hetimin e veprave penale ku i mituri përfshihet si i pandehur, person nën hetim, i dëmtuar dhe/ose dëshmitar”
- Udhëzim i përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm nr. 05, datë 26.10.2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”

Raporte

- Raport vjetor mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor, viti 2024 <https://klgj.al/media/1bhpy5gv/raport-mbi-gjendjen-e-sistemit-gjyqesor-dhe-veprimtarine-e-keshillit-te-larte-gjyqesor.pdf>
- Analizë statistikore e DNJF për ndihmën juridike të garantuar nga shteti për periudhën janar – qershor 2025 <https://ndihmajuridike.gov.al/ep-content/uploads/2025/07/06.-Analiza-Statistikore-Qershor-2025.pdf>
- Vjetari Statistikor 2023, Ministria e Drejtësisë <https://www.drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2025/02/Vjetari-Statistikor-2023.pdf>